

BIBLIOTEKA

E

844-2

L 14

SHTELT

GJIROKASTER

**TEODOR
LAÇO**

komedi

**Një
nuse
për Stasin**

**Shi
në plazh**

891.183-2

SH-2

L19

Teodor
Laço

KOMEDI

NJË
NUSE
PËR STASIN

SHI
NË PLAZH

36152

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NJË
NUSE
PER STASIN

komedi



(Në dy pjesë,
me një prolog
dhe një epilog)

PERSONAZHET

STASI	— llogaritar, afër të dyzetave
NËNA	— eëma e Stasit, e moshuar
KRISA	— e motra, afër dyzet e pesë vjeç
TUSHKA	— i shoqi, rrëth të pesëdhjetave
MARIANA	— vajza e tyre, mësuese në fshat
SOFOJA	— mbles rrëth të pesëdhjetave
RISTOJA	— fshatar, po i asaj moshe
SULLA	— e shoqja
KLODI	— e bija, njëzet vjeç
KUSHËRIRI	— i Ristos
ARIANI	— mësues, i dashuri i Marianës
SHPRESA	— fqinjë e Stasit
ELMAZI	— nëndrejtë i ndërmarrjes

Disa vajza e djem fshati, një shofer etj.

Ngjarjet ndodhin në ditët tona, në qytet dhe në fshat.

*(Variant i ripunuar i komedisë me të njëjtin titull vënë
në skenë nga Teatri Popullor në vitin 1971).*

THEATR

PJESA E PARE

ëmblaçub ës i tjetri zotitugejti
TANSHOJA e NGRIS e DITËS së
PROLOG qëll usqë e tashub tjetri dritë së
suntierjebosaq ës i disti i podoju

IKA PA
AKIZ
AISIK
KALI

Eradastenë: Rrugicë para shtëpisë së Stasit. **Duket verandu, shkallët dhe porta e shtëpisë.** Stasi kthehet nga puna. Eshtë i veshur sipas modës së viteve të shkuara, me kostum blu me vija, xhaketë dopiolet të ngushtë në bel, dhe pantallona të gjerë. Flokët i kanë rënë mbi ballë, mban kasketë; mëngoret prej basme të zezë, që i mban në zyrë; i ka harruar pa hequr. Nga ana tjeter vjen Shpreza, vajgë e zakonshme rreth të tridhjetave, e veshur mirë. Bën sikur nuk e vë re Stasin.

STASI — Shpreza! Mirëmbërëma!

SHIPRESA — Ah, mirëmbërëma. Më falni se nuk e kisha mendjen.

STASI — S'ka gjë. (Pauzë. Shikon mëngoret, dhe fsheh duart prapa) Unë, ja drejt e nga puna. Kishim mbylljen e bilancit. Shifra, pasqyra, kuadrimë... Faktikisht, llogaria është pus pa shëj. Njihundi. Faktikisht dëhe mund të hutohet njëriu. Ju po qeshni?

- SHPRESA — Jo, ç'ne?
- STASI — Seriozisht? (*Heq mëngoret.*) Të qe lidonjë tjetër, mund të tallej. Kurse ju... jeni e mirë, e mirë në kulm. (*Hutohet prapë.*) Dëshash të them, jeni një shqipë e mirë. Po ju, nga shkolla? Ndonjë këshill pedagogjik?
- SHPRESA — Ishat në teatër.
- STASI — (Që duket se do të bisedojë.) Interesant! Ka kohë që s'kam vajtur në teatër. Jo puna, jo televizori... Po ç'lante?
- SHPRESA — Një komedi, Natën e...
- STASI — Si titullchej?
- SHPRESA — Një nuse për... Stasin...
- STASI — O! Me gjithë mend e keni?
- SHPRESA — Është një përputhje e rastit e emrit Stas, kuptohet.
- STASI — E, e. Çudi, çfarë u pjell mendja këtyre letrarëve! Të vjedhin emrin dhe pastaj botës i shkon mendja tek ty. Se mendja, faktikisht, atë punë ka, të bredhë andej këtej. Po ama kush ka haber nga letërsia...
- SHPRESA — E kupton që këtu kemi të bëjmë me personazhe e jo me persona konkretë.
- STASI — Po ju... ju sikur m'i vidhn! mendimet nga koka! Si i thonë kësaj? Përputhje e tipit apo...
- SHPRESA — Nuk e di, mundet.
(Në vërandë ka dalë Krisa. I shikon dhe merr një pozë kercënuese, me duart në ije.)
- STASI — Mamaja më pyeti për ju. Ajo ka qenë goxha e sëmurë. Si nuk erdhi të më shohë njëherë kjo vajzë, tha. Jemi edhe komshinj!
- SHPRESA — I thuaj të më falë. Desha të vij, por

çdo mbasdite aty ishte motra juaj.

STASI — Ju gratë jeni të tmerrshme. Një fjalë dëgjoni dhe e bëni çështje tragjike.

SHPRESA — Ishin të rënda për mua ato fjalë, Stas. (*Stasi ul kokën*) Po s'ka gjë, zëre se i kam harruar.

(*Stasi vëren shenjat e motrës nga veranda.*)

STASI — Ndonjëherë tjetër do të kemi rast... se son-te nxitoj. Kemi ca miq, ja, edhe motra ka dale në verandë.

SHPRESA — (*Pa e parë Krisën.*) Bobo! Rrezik të bjerë ndonjë rrufe!

STASI — Rrufe?

SHPRESA — E de, nuk e shikon si u vrenjt?

STASI — Ah, këto figurat letrare! Gjithnjë më kanë ngatërruar. (*Me zë të lartë.*) Natën, e mirë! Na urdhëroni!

TABLOJA E PARË

Veranda dhe dhoma e ndenjes në shtëpinë e Stasit. Muret janë lyer me vizatime lulesh. Një komplet i ri kolktukësh, një divan i stilit të vjetër, një komo me pasqyrë dhe televizori në një tryezë të posaçme. Në dhomë është Tushka, kunati i Stasit, i shëndoshë e disi komik në pamje dhe nëna plakë e Stasit. Në shkallët

e verandës Krisa ujit lulet. Është grua afër
të pesëdhjetave, autoritare, me gjeste të pre-
ra. Ia ka zënë kalimin Stasit.

KRISA — Hë? Ç'thoshte ajo bizbiqja?

STASI — (Që nuk e bën veten.) Kush?

KRISA — Ajo, komshija de! Shpresa!

STASI — Hiç! Rastësish u takuam, ajo kishte që-
në në teatër.

KRISA — U! Në teatër! Sonte, e shtunë mbrëma,
njerëzia mblidhen në shtëpi e lajnë kokën,
ajo po tralala!

STASI — Leri këto, motër. (E mënjanon nga rruga.)

KRISA — Jo po fol! Grua nikoqire i thua ti kësaj?
(Hyjnë brenda.)

TUSHKA — Po ku je, o kunat, se na thave sytë?
(E puth me zhurmë.) Kam dy orë që po të
pres. E dëgjon si më bëjnë zorrët? Giu-viu,
si violi.

STASI — Mamaja po fle?

KRISA — Dremiste deri tani.

TUSHKA — I ka pleqëria këto. (Te divani.) Vje-
hrrë! Zgjohu se na erdhi Staska. (Nëna ngri-
het.)

STASI — Si u ngryse, mama?

NËNA — Si gjarpri nën gur! Ngryset vetëm si qyq-
ja tërë kjo ditë e gjatë sa një muaj, o bir?

STASI — Po ja, ishte Krisa, Tushka...

KRISA — Ne sapo erdhëm. (Stasi është ulur.) Pse
nuk vesh pizhamat brenda. Pantallonat të
janë bërë zhubra-zhubra. Kush do të t'i he-
kurosë, apo pret nga mamaja?

STASI — Thashë, meqë kemi mysafirë, sikur s'ka lezet me pizhame!

KRISA — Në s'jemi mysafirë, jemi një familje.

NËNA — Ashtu jemi, biro!

TUSHKA — Ore Stas, ore djall! (*Ulët.*) Ku e ke fshehur atë rakinë e manit?

STASI — U mbarua. Po kam ca liker në frigorifer.

TUSHKA — Liker! Jo po thuaj më mirë kam ca çaj kinez! Rakia e manit, sado kudo, tjetër gjë është...

KRISA — Veri, kapakun këtij muhabeti se s'kemi hallin e rakisë tanë.

TUSHKA — Jo po të kam llafin! Sado kudo, muhabeti ecën në mirë në tryezë. Trink-trink ia bëjnë gbatat, trink-trink edhe zemrat. Kuptohet njeriu.

KRISA — Stasi nuk pi, nuk është i gotës e i qejfave si ti.

TUSHKA — Më vjen keq! As pas rakisë, as pas duhanit, pas femrave jo që jo, dihet me kohë. Kjo, që thua ti, s'është hic fare burrërore.

KRISA — T'i merrni pleshtat Stasit ju, nuk i vini as në majë të thoit, e di tërë qyteti.

STASI — Lëre tanë, c'na bën komplimente...

KRISA — Jo po thuaj, ka burrë nikoqir e punëtor si ti? Shtëpinë e bëre si të re, e mobilove me kolktukë, me faqemuri, me q'lim me rrötë...

STASI — (*I bezdisur*) E, e...

KRISA — Televizorin, frigoriferin, makinen larëse...

TUSHKA — C'e do kur; s'mban një pikë raki a një kremvic a...

- KRISA — Mbylle, Tushkë! Ohu, ku e kemi hallin ne
e ku e ke ti.
- STASI — Ku do tē dalësh, Krisë? S'kuptojoj fare.
- TUSHKA — Do ta kuptosh, po hë. Gratë, sado kudo,
e kanë zakon tē ta sjellin rrrotull e rrrotull,
rrrotull e rrrotull...
- KRISA — Tani, ç'të mungon akoma, vëlla i mo-
trës?
- STASI — Ç'më mungon?
- TUSHKA — Një nuse! (*Krisa e shikon me qortim.*)
E po hë, se na plase!
- STASI — Ohu, prapë me atë avaz ju?
- KRISA — (*Pas një pauze, me seriozitet tē madh.*)
Stas, vëlla i motrës, ti je i zgjuar, i mirë.
Kush eshtë si ti? A nuk e shikon se si u kë-
rrus më dysh mamaja nga punët e shtëpisë?
- NENA — Nga meraku, çupë, nga meraku mië shu-
më.
- TUSHKA — Domosdo, sa tē plak meraku asgjë
tjetër. E kam provuar vetë.
- KRISA — Epo mbylle, Tushkë!
- TUSHKA — Jo po që tē kam llafin.
- KRISA — Mbylle se ti s'merr vesh nga këto gjëra.
E Stas? Fol!
- STASI — Edhe më vjen keq, si kujtoni ju?
- KRISA — Po atëherë pse nuk martohesh që t'ia
gëzosh prehrin nënës me një djalë?
- NENA — Eh, plagë e kishte i ziu yt atë! Të rroj
deri në dasmë tē Stasit e tē përkëdhel një
nip me emrin tim që tē na hapë oxhakun...
- KRISA — Plagë e kishte...

STASI — Do të martohem edhe unë ndonjë ditë se s'mbeti laraskë pa bisht.

TUSHKA — Ohu, prit gomar të mbijë bar o! E di si thotë një llaf? Deri në tridhjetë vjet djali martohet vetë, pastaj duhet të mblidhet fshati që ta martojë.

KRISA — Vitet po të shkojnë, flokët të janë rralluar nga studimet..

TUSHKA — Edhe fuqia, forca them, sado kudo po të shikon kot së koti.

KRISA — (*Tushkës*) Pusho! (*Stasit*) E dimë që në moshën tënde njeriu zgjedh shumë, po ti s'je i shikretë, na ke neve!

STASI — Motër, nuk është nevoja të më thoni ato gjëra që i kam dëgjuar njëqind herë...

Pauzë

TUSHKA — Thashë unë! Në moshën e tij, duhet mbledhur fshati! Ç'fshat more! Gjithë republika, thuaj.

KRISA — (*Gati e përlotur.*) Mos u sëkëlldis, mama, ja më ke mua. Se Stasi qënka zemërgur. Nuk të lemë ne. Apo jo, Tushkë?

TUSHKA — (*Po ashtu*) Nuk të lemë, jo!

STASI — Prapë e bërë çështjen tragjike, motër!

KRISA — E, e, ashtu i bën motra gjérat, tragjike.

STASI — Unë... nuk thashë se s'dua të martohem.

Reagime të gëzuara

TUSHKA — Rrofsh, Stas!- Të lumtë ajo gojë. (*E përqafon*)

STASI — Dale, se më mbyte! Ju gjithnjë më keqkuptoni. Unë dua ta njoh mirë atë që do të

marr, si është, ç'karakter ka e më the të thashë. Se, faktikisht, unë do ta marr.

KRISA — (E gëzuar) Ta njohësh, pos! Atë duam edhe ne. Se, kush nuk të merr ty? Llogaritar i parë në një ndërmarrje të madhe, me shtëpi e me katandi. Do të gjejmë një nuse si do vetë zoti, të mirë për ty dhe për mamanë.

NËNA — Të jetë e mirë për të se për mua, vate vapa me gushtin.

TUSHKA — Larg qoftë, ti je e fortë, vjehërr, gurigë fare je, dëgjomë mua.

NËNA — Ku është ajo ditë e bardhë ta shoh shtëpinë me nuse, pa le të vdes pastaj.

TUSHKA — Po vjen dita, vjehërr, Staska e dha llafin, ska si luan tani se edhe ne i kemi marrë masat.

STASI — Ç'masa?

TUSHKA — Hë, qerratuc, të qeshi buza. Apo kush u martua dhe s'u gëzua more! Ku ma gjen të martohesha edhe njëherë!

KRISA — O perëndi! Do të më futë në dhë të gjallë ky njeri! Nuk i durohet pa këputur ndonjë kërcu!

TUSHKA — (I nxehur) Ohu, ti ta bën shpirtin komar! Mos bëjë një shaka njeriu.

KRISA — Këto s'janë shakara!

STASI — Kur ju dëgjoj që bëni kështu gér-mér si macet, e di si më vjen? Të mos martohem kurrë.

Pauzë. Hutim i Tushkës e Krisës.

TUSHKA — Po dale se... sado kudo, ne nga dashuria e kemi.

KRISA — Nga dashunia pomaiga sei Ndryshe do tē
jetē fatisyt! ob ūnū mālakatka ar ūnū
STASI — Ro! dale, s'mund tē flisni mē hapur? KIRIA
TUSHKA — Tani u'sta themi, apri do deri mēt tetē e
— ētis gjysmëbem ét ejtis mëbni ūnū ūnū ūnū
STASI — C' do tē ndodhë më tete e gjysmë? q
TUSHKA — Budimë ne. Krisë, mos ta thuaj, é!
STASI — G'janë egjithë këto shakara në kurrizin/
tim?

TUSHKA — Pësi, shakara! Selju pandehni që! Tushka,
shka s'eshtë serioz Karagjoz eshtë Tushka,
— është jut, eribë e është që është — KUNA
STASI — Ja! deri jebv është el se është om ūnū
TUSHKA — Po! do ta shpëshë kush, jam unë dhësat
është dua! i është që është që është që
STASI — Presim atëherë sa tē hapet derashë tē
hyjë nusja e Stasit!

TUSHKA — E, nusja pës xhanëm, sesato tē shuara T
mëse, gjanë këput fig e ha, nipo duro, duro se
edhe dy minuta mbetën — O — STASI — C'mesha

STASI — (S'kutur qvazhdor h'je) Moliolog tē b'rend-
shëm.) Ju e bëni tragjike. Pse, s'mëndoq unë
— po spëri mëmarrë? Pohayku dhet në ç'hjeri bijë? Ja T
ta zuri uderën mëmarrë rëvrike e më huqe dhe
e kërkon belanës me qiri? Faktikisht... unë ve KUNA
is tëtë rëgind një thöshë përinjëren, po s'di bësi?
mëdusta prisniat "po" është vlonj iz ih mësuar e që

NENA — Thuaje tē keqen nëna, thuaje! KUNA
TUSHKA — Prift, s'ka xajtura ora.
NENA — O si më mermet mendja nga gëzimi! Sikur
do tē më bjerë tē fikët.

TUSHKA — Duro deri në tetë e gjysmë!
KRISA — (Tushkës) Budalla! Cila është ajo vajzë
Stas? Thuaje, ndoshta është për të qenë dhe i
japim fund.

STASI — Është... është Shpresa.
Gjallëria shuhet. Krisa plaset në karrige, nëna
s'ka asnjë shprehje, Tushka buzëqesh sikur
s'ka dëgjuar asgjë.

KRISA — E dija unë! Ka hedhur rrjetën dhe të ka
zënë si ai peshku budalla! Po, po mos kundër-
shto, ashtu është. O, janë shumë të zonjat ato
në sojin e tyre për të prishur mendjet e bu-
rrave. A nuk u nda e motra prej burrit të parë
dhë mori një tjetër?

NËNA — S'kemi dëgjuar fjalë të keqë për të, Krisë!
KRISA — Pusho mama! Do të zihem edhe më ty! Me
tërë botën do të zihem! Tërë derrat një feckë
kanë. Kjo s'bëhet kurren e kurres! Vajzë e
mbetur mama, tridhjetë e ca vjeç. Turp nga
bota! (Nxiton) Pastaj farefisi, familja, vetë e
the, Stas, që të jetë e ndershme!

STASI — (Proteston) Kush tha se Shpresa nuk është
e ndershme?

KRISA — Obobo, të ka helminuar nepërka! Ku e ke
helmin, xhan i motrës, ta thith me gojën time
pa le të helmohem une!

STASI — Mjaft! Nga urrejtja, po flisni marrëzira.

KRISA — O vëlla! Po pse të katandisesh ti që s'më
ke asnjë te ligë, te marrësh një vajzë që
quhet si e mbetur? Pse s'flet edhe ti Tush-
kë? Përfkur e ke atëi gojë?

TUSHKA — Për në tetë e gjysmë!

KRISA — Budalla! S'e shikon që ora kaloi?
TUSHKA — Le të kalojë!

KRISA — (Gati duke qarë.) Stas, xhan i motrës,
mos e bëj këtë se do të prishemi për jetën
e jetës.

STASI — Mbaj gjakftohtësinë, motër. Në di gjë,
thuaje, pa mua s'më helmon dot asnjë fe-
mër, le të jetë maikar edhe Brixhid Bardoja!

KRISA — (E përqafon) Na rrofsh sa malet!

Trokitje

TUSHKA (Kërcen) Erdhi! Për atë bukë, erdhi!
(*Hap derën e hyn bashkë me Sofon, burrë
në moshën e Tushkës, i veshur me kujdes,
i pashëm.*)

SOFOJA — Mirë se ju gjej, o të dashur! Mirë se
ju gjeta, gaz paçi gjithnjë!

NËNA — Mirë se na erdhe, o djalë!

SOFOJA — (I puth dorën) Si m'a ke shëndetin,
mëmëzë? Nga jashtë, mirë më dukesh, si
bukë me qiqra!

NËNA — Të keqen e kam përbrenda.

SOFOJA — Nxirre jashtë të keqen e brendshme,
mëmëzë, nxirre! Po ju, zonja e Tushkës, mi-
rë? O! Ky është kunati juaj, Tushkë? Po ne
njihem me të, njihem! Në atë ndërmarrje
punoni akoma?

KRISA — Tani është llogaritar i parë!

SOFOJA — I parë! Alamet detyre!

STASI — (Që deri tani e ka parë disi me ironi So-
fon.) Edhe unë ju njoh, ju shihja shpesh nga
pazari i gjësë së gjallë.

SOFOJA — Nuk çuditem, mua më njohin me kuçkë e me maçkë.

TUSHKA — Ou, kur shitej gjëja e gjallë, Sofoja qe ustai i shqerrave. Asnjeri nuk dinte t'i zgjidhte si ai! Sado kudo!

SOFOJA — E, e, gjëra të vogla të jetës, ato. Njeriu duhet ta vërtitë jetën. (*Krisa sjell pijet.*) Ja gëzuarshi, qofshi si juva do zemra, pa halle e pa derte.

Psherëtima të nënës, Kristës, Tushkës.

NËNA — Të bëftë mirë, o bir, pa sa për halle e derte, mos e pyet!

SOFOJA — E ç'halle mund të ketë kjo shtëpi e lumtur. Gjithë qyteti e di ç'njeri i drejtë e i zoti është Stasi! E çmojnë, e nderojnë...

TUSHKA — Ashtu, sado kudo, po pa shikoje drejt e në sy! Jo po shikoje mirë, se ti e ke syrin pishë, ka apo s'ka ndonjë hall ky kunati im? (*Sofoja e vëren, Stasi ul kokën.*) Mos u mërit Stas, Sofon e kemi mik!

SOFOJA — Më ndjeni, Stas, jam njeri pa teklif. Bëj ndonjë shaka, po zemrën e kam të qëruar. Do t'ju jap një këshillë! Nxirre jashtë të keqen e brendshme!

STASI — E kush tha se unë pasqam halle e bregga?

SOFOJO — Kunati juaj.

STASI — S'është e vërtetë.

SOFOJA — Ashtu qoftë. (*Pauzë*) A keni qënë ndonjëherë kaps? (*Qeshje*) Jo, mos qeshni, e kam seriozisht.

STASI — Byesni Tushkën, njerëzit të shëndoshë vuajnë më shumë.
TUSHKA — Vuaj, nuk e bëj thasha.
SOFOJA — Sëkëldi, të madhe ka i zi u njeri kur bëhet kaps, apouj? Ja, ashtu është edhe kur e një hall dhe e mbani të kyçur në atë qilat. Të gjithë shpirtit Hapjanit qilarin mikut, nxirret sq ni brengët dhe do ta shikoni po nuk u lehtësuat.

TUSHKA — M'a more nga goja, këtë desha të.

SOFOJA — Ma qajnë hallin shumë njerëz. Katingjarije më të madhe se martesa? S'ka. Ja, edhe së përpjekim me sa mundemi t'u ëmbëlsoj i së shqetës i begarëve.

TUSHKA — O, ja! Ëmbëlti, Sofo, i ëmbël si mjaljtjet e tij! E thonë të gjithët që jeta e jetë!

STASI — Ja do zanati i mblesit, o! Dva është!
SOFOJA — A! Njoh i bërzer i ashtrenjtë, muklështë! Në asnjë mënyrë, jo! Është vërtë një ndërhyrje miqësore, sa i bëhet për injohjen! Ky, ta zëmë, muklëtë-hyni në (sy) -pët asnjë vajzë mëga ato që nje, mirë, i pë do të shtesë martdhesht! Amat se muklëshkohet i jetë si korbi.

E ja, atëherë unë t'i marr për dore dhe, si -nënd ajoll bleta, të që shpirtet u marrësh! Erë llulëvë dhe ta ëmbëlsoj jetën në jetë të jetëve...

TUSHKA — Të lumtë! Sikuri m'more t'ë gjithë nga goja mua.

KRISA — Llaf me konak, me një barrë mendje!
SOFOJA — Është mençuriaje të qejtërvësurtësia e mbledhur pikë-pikë.

TUSHKA — Ajo është, urtësia. Sado kudo, ka fë
bëjë shumë.

KRISA — E dëgjon, o Stas?

STASI — (Që duket se nuk i bën përshtypje.) E
çfarë?

KRISA — Ah, svëlla! Të paska helmuar nepërka
vërteti! Mjerë ne!

SOFOJA — Nuk e di q'ju ka ngjarë dhe as që dua
në punët e botës. E doni ndihmën e mikut,
mirë! nuk e doni, natën e mirë! (Ngrihet)

NËNA — C'është ajo fjalë? Urdhëroni kafen!

KRISA — (Stasit, mënjanë) Turp! Ti nuk fyje as-
një mizë, Stas! C'po bën?

STASI — Nuk i thashë gjë.

KRISA — Tioia ke nevojën, jo ai.

STASI — As unë.

TUSHKA — Stas, ç'të kushton, o derëbardhë, hidhi
një sy asaj që do gjejë Sofoja. More në dac
hidhi njësy edhe një dorë, po hë!

KRISA — Copë po bëhem për ty, Stas!

TUSHKA — Kjo mblesëri është tërë lezet! Nuk ndien
një si gudulisje? Po të më mblesëronin mua...

KRISA — Tushkë! — Me ty, me ty!

KRISA — Njeriu nuk martohet vetëm për vete. A e
merr ti një që s'e duam ne? Jo, nuk e bën se
s'e ke atë zemër!

TUSHKA — Nuk e ka!

KRISA — Se si mund të martohet ndryshe njeriu,
o Stas?

STASI — Po... ka edhe dashuri de...

KRISA — Nepérka...

SOFOJA — Byrazer, ti paske ca mendime që të shpojnë si gjemba. Shkuli, more, shkuli dhe bëj si të gjithë. Të dua pa do të të tregoj ca sekrete që nuk i di asnjeri. Doktor Xhuvi nuk e njihte fare gruan që mori, ia gjeta unë. Po inxhinier Dhimosteni, po Xhevua që punon në komitetin ekzekutiv, si u martuan thua ti? Sa qenë të rindja, dashuruan nga një e dy a tre çupa pastaj, kur u erdhi mosha e marte-sës, i vunë gishtin kokës se u duhej nuse për shtëpi, u duhej çupë ku nuk kanë futur hundët zagarët! Ja kështu krijohet familja!

TUSHKA — Ah, ja këto i kam pasur në kokë gjithnjë. Ë t'ia them sot Stasit, t'ia them nesër, po nuk i lidhja dot. I lidhe ti, gojëflori.

KRISA — Vajzë për shtëpi, jo për theatro e bulavarde!

SOFOJA — Ç'thua byrazer? T'i përvishemi?

KRISA — S'ka ç'të thotë, do të pranojë! Shiko, Stas, si i ndritën sytë mamasë! Dhjetë vjet do t'i shtosh.

TUSHKA — Pesëmbëdhjetë.

KRISA — Ne, Sofo, na duhet një nuse e urtë, e re, jo më shumë se njëzet e tre vjet.

TUSHKA — Ua gjen ai si t'ju pëlqejë! Edhe by-thën e djallit njeh ai!

KRISA — Prano, Stas!

NËNA — Prano, o bir!

TUSHKA — Prano, o derëbardhë, sado kudo ç'do pësosh? Sikur do të të hajë ajo!

KRISA — Stas! Thuaj po!

NËNA — Thuaj, të keqen nëna.

STASI — (*I topitur*) Në fund të fundit... pse jo?

TUSHKA — Urraa! Rroftë Stasi! Thërrisni more,
«rroftë nusja e Stasit!»

Urime e përqafime entuziaste

TABLOJA E DYTË

*Një pijetore dhe disa tryeza jashtë saj.
Stasi dhe Tushka, janë ulur. Në gjestet e tyre ndihet padurimi i pritjes.*

STASI — Ç'njeri edhe ky Sofoja! Kaloi gjysmë ore
dhe nuk po duket.

TUSHKA — Duro! Qëkur vendose të fejohesh, je
bërë zevzék si ai mëzi kur e lëshojnë në li-
vadh.

STASI — Léri këto fjalë banale.

TUSHKA — I lashë. Sot eja për drekë nga ne.
Kam qingj të pjekur.

STASI — Ehu, ku dihet se ç'ndodh deri në drekë!

Pauzë

TUSHKA — Ja ku po vjen, e sheh?

SOFOJA — (*Përshëndet me zhurmë, ulet.*) Mirë-
mëngjez! Si u mban shëndeti, o byrazerë?
Nga jashtë, si bulkë me qiqra dukeni!

STASI — Ne kemi kohë që po të presim.

TUSHKA — I rashë tri herë rrrotull pazarit duke të kerkuar. U rraskapita!

SOFOJA — Ecja ty të bën mirë, e thonë edhe mje-kët. Njerëzit e trashë, në daçin të shpëtojnë nga dambllaja, duhet të ecin shumë më këm-bë.

TUSHKA — Një plakë, më ka këshilluar uthullën.

SOFOJA — Në asnje mënyrë! Uthulla të grin zo-rrët e barkut.

STASI — Për... këto do të bisedojmë?

SOFOJA — Shih, shih! Ku ne e ku ai! Kamarier i dashur, tri raki dopio se na u tha fytë.

STASI — Unë s'pi kurre raki.

SOFOJA — Harrova! Doni hallvë susami?

STASI — Një birë po, mundet.

SOFOJA — Ti je shenjtor e shkuar shenjtorëve.

STASI — Mos n'a ingatërho me bëperëndira e m'më shenjtorë, të lutem shumë!

SOFOJA — Erdhi mi habeti ashtu.

STASI — Pse n'a le takim më këtë kafene?

SOFOJA — (Bën sikur nuk ia vë veshin) Kamer-eri ka sjellë pijet.) O burra, it'i bëperplasim e njëherë. (Solemn) Për fatin t'end - të bërdhë, Stas!

STASI — (I bëfasuar) Për fatin tim? Ç'domethënë kjo? Nuk ju kuptoj!

SOFOJA — Avash-avash bëhet shelegu dash. Gë-zimi i madh 'eshtë si kjo rakkia. S'mund ta ke-dhësh me një frymë se të djeg fytin pastaj.

TUSHKA — Të porositim nija gjashtë biftekë të skarës, se na mori uria. Edhe birë. Rakkia s'qenka gjë.

SOFOJA — Porositi, do ta djegim se dita e sotme
është me nishan.

STASI — (*I paduruar*) Me nishan?

SOFOJA — Avash, avash! Mos u rrëmbe, gëzimi
i madh duhet pirë si ilaci, me pikatore.

STASI — Pra...

SOFOJA — Pra, sot, o Stas, do të ndodhin për ty
ca ngjarje të shënuara. Se, duhet ta dish,
burri i vërtetë dy gëzime ka: kur fejohet
dhe kur ndahet nga gruaja.

TUSHKA — Thuaje edhe një herë se më preke
telat e zemrës.

STASI — Parimisht, unë jam kundër.

SOFOJA — E di, ti nuk ke nevojë për atë gëzimin
e dytë. Mjaft e ke vetëm të parin.

TUSHKA — Nxirre tani. Sofo, mos luaj me kuna-
tin tim si ajo macja me miun. Unë nuk të le-
joj!

SOFOJA — Atëherë, le ta pimë gëzimin me fund,
sic do ta pimë edhe këtë gotë raki!

STASI — Pra?

SOFOJA — Pra, i dashur Staskë, kjo kockë grisi
dy palë këpucë për të gjetur një thëllëzë që
do të ëmbëlsojë tridhjetë e nëntë vjetët e
tua prej begari të djegur, të zhuritur, të
përvëluar si bari për vesën dhe më në fund...
e gjeti thëllëzen.

STASI — Ku?

SOFOJA — Dalëngadalë, e thamë! Gëzimin me pi-
katore.

TUSHKA — Na fryve kokën me këto dëngla. Do
t'ia nxjerrësh kokën llafit apo si e ka punën?

SOFOJA — Do t'ia nxjerr, do t'ia nxjerr, po s'ë-shtë aq kollaj se thëllëzën e kérkuam pér një kohë të gjatë, siç është dhe ajo kënga: (*Këndon ulët*) «Lulet kérkojnë vesën/ Dhe unë ty të kérkoj!

TUSHKA — U teprua! Po m'i skuqni nervat në skarë, ta dini!

STASI — Mos u nxeh, o kunat!

TUSHKA — Jo po, sado kudo, ka kufi durimi.

SOFOJA — Po i bie shikurt. (*Ngrihet*) Stas, i dashur, miku yt Sofija e gjeti më në fund limanin ku do të qëndrojë varka jote e lodhur nga dallgët e jetës.

TUSHKA — C'janë këto limane more?

SOFOJA — (*Që nuk ia vë veshin.*) Dhe ku thoni ju? Po ku gjetikë, o të dashur, veçse atje ku era rrit thëllëza të papërdhosura nga këto modernizma qytetare?

STASI — Ku?

SOFOJA — Në një fshat rrëzë malit, në Lajthizë.

TUSHKA — (*I befasuar*) Në fshat? Stasi ynë të martohet në fshat?

STASI — C'domethënë fshat?

SOFOJA — Fshat domethënë ay që ka ara dhe bagnëti dhe gomerë... (*Si i nxehur*) Ohu, qenkeni ca qytetarë të mylkur ju që...

TUSHKA — Na paske... menderosur.

SOFOJA — Qenkeni ca syleshë që s'merrni erë fare nga bota, as që e dini se si jetojnë dhe çngritje të lartë kanë ato fshatra të Devoilit. Ka të ngjarë të jenë më të ngritur se sa ju! Ahu!

TUSHKA — E pamundur, s'ka mundësi.

STASI — (*I menduar.*) Faktikisht... kryesorja është njeriu.

SOFOJA — Engjëllushkë! Urtësia vetë, që të mos tē shohë kurrë drejt e në sy si këto bisht-dredhurat e qytetit.

TUSHKA — Dale, dale! Në atë fshat kam vajzën mësuese unë dhe të dhënët biografike do t'i marr komplet.

SOFOJA — (*Që nuk ia var Tushkës.*) Që mos ia ndiesh zërin kurrë, që ta kesh mendjen të fjetur edhe sikur ta lesh në mes të njëzet burrave sevdallinj si po Tushka.

TUSHKA — Më duket e dyshimtë. Shumë larg na degdise.

STASI — Mos e bëj tragjike!

SOFOJA — Njëzet pranvera, me gërshteta të gjata, një shenjë e sigurt e virgjërisë kjo.

STASI — Interesant. Po më tej?

SOFOJA — E bardhë... e bardhë si kulloshtër qumështi. Edhe emrin e ka të bukur! Klaudeta.

STASI — Dhe pranoi të fejohet me mua kështu... pa më parë fare?

SOFOJA — Po unë përse jam? Le të takoheni familjet më parë, kurse ju të dy takoheni ditën e shkëmbimit të nishaneve.

TUSHKA — Sado kudo, mua më duket e dyshimtë.

SOFOJA — Qenke tuhaf! Unë të dija burrë me mend, po ti paske qenë ters në... në prapanicë.

STASI — Po më tej?

SOFOJA — Të atin. Risto i thonë, e kam mik të vjetër. Ama, sa e pashë çupën e tij, thashë

me vete! «Ja një nuse për Stasin»

TUSHKA — Sado kudo, sikur të mos qenkej në fshat, do të qe më mirë.

STASI — Kryesorja është njeriu. Nuk e ka keq Sofoja për këto qytetaret. S'të fle mendja as gjëkundi. Faktikisht, e kanë qejfin si e si të vishen me të ngushta që t'u duken vithet e ku ta di unë ç'tjetër...

SOFOJA — Bravo! Ja kjo është një vërejtje tamam prej llogaritari.

TUSHKA — Kaq kishim?

SOFOJA — Po ta shohim edhe nga një anë tjetër, me këtë fejesë Stasi nderohet shumë. Do të thonë të gjithë: «Ja Stasi, njeriu që baret me çapin e kohës, po sjell një nuse nga fshati! Poshtë paragjykimet, vjetërsirat, kalbësirat, dallimet fshat-qytet!» — tha Stasi.

STASI — Unë... s'kam thënë asgjë.

SOFOJA — Ti s'kë thënë, po kjo s'prish punë, se fjala kështu do të përhapet. Nuk ka rëndësi se c'thua ti, rëndësi ka se c'thonë të tjerët për ty.

STASI — Faktikisht... nganjëherë ti ke ca mendime të çuditshme.

SOFOJA — Është urtësia popullore kjo. Ti mund ta nxjerrësh gjoksin përpara që nesër, se kjo fejesë është e mbaruar. Kur i hyj punës unë, e bëj me goditje të përqendruar.

STASI — (I tronditur) Jo... jo kaq shpejt. Nuk jemi parë fare.

SOFOJA — Gjë e madhe! Do të shiheni kur të këmbeni nishanet, e thamë.

STASI — Unë... sepse kam një dyshim. Pse të pranonte aq shpejt? Mos i kanë dalë fjalë?

SOFOJA — (Bën sikur nxehet.) Gjithua ashtu, më t'u thaftë gjuha, t'u thaftë! (Bën të ngrihet.) Do të heq dorë nga ty. Ika! Mos më kërkon më kurrrë!

STASI — Më fal, po martohem unë me të e jo ti!

SOFOJA — (Ulet) Po të mos thoshe «më fal», do të dëgji se më hipën narvat. G'fjalë t'i jenë hapur, or tyryfyl? Cila cupë fshati nuk do të martohet në qytet që të shpëtojë nga punët e rënda të bujqësisë? E di si thonë: «Më mirë burrin sa një këndez dhe në qytet se sa luan dhe në fshat.»

STASI — Unë s'jam këndez de!

SOFOJA — Nuk e kam për ty. Ti je si luan dhe s'dukesh as tridhjetë vjet.

STASI — Vërtet? Më janë rralluar fare flokët ama!

SOFOJA — Punë e madhe! Se mos do të martohet me tullén tënde! Ajo martohet më bulevardet dhe i thotë lamtumirë kazmës.

STASI — Parimisht, nuk jam dëkord më këtë mendim.

SOFOJA — Foli, more Tushkë!

TUSHKA — Derisa e thotë Sofoja, nuk e luan as topi.

SOFOJA — Tani përgatituni se do të takoheni.

STASI — (I tregimitur) Gjare? E bëtmerishme! G'janë këto të papritura?

TUSHKA — Më blidh fiqirin, Sofo! Nuk jemi përgatituar për takime, em është qëndrim.

STASI — Më duket se s'jam edhe i paqethur.

SOFOJA — Mos u skuq ashtu, do të takohemi vetëm me babanë e vajzës.

TUSHKA — Hë... se na ngriu gjaku! Gjeje vjehrrin e Stasit dhe sille, kështu, t'ia shtrojmë njëherë!

SOFOJA — (*Ngrihet*) Ja, sikur e kam sjellë! (*Del. kamarieri mbledh pjatat.*)

STASI — Llogarinë, ju lutem.

TUSHKA — Prit se ke për të gostitur edhe vjehrrin.

STASI — Harrova!

TUSHKA — Si të duket kjo punë?

STASI — S'di! Na daltë për mbarë!

TUSHKA — Sofoja ka martuar dhjetëra çifte.

STASI — E di.

TUSHKA — Krisa thotë se shkojnë njëqind herë më mirë se ata që martohen me dashuri.

STASI — Mundet. (*Pauzë*) Pse s'flet?

TUSHKA — C'të të them? A, po! Sot do të vish për drekë te unë. Kam mish qingji dhe byrek.

STASI — Më the njëherë.

TUSHKA — Si ia tha emrin asaj çupës Sofoja? Klla.. Klla.. Kllau..

STASI — Kllaudeta.

TUSHKA — Kllaudeta! More, kur kanë zënë të vënë emra modernë dhe fshatarët, hë?

STASI — Po sikur t'i shkurtoja pak flokët derisa të vijnë?

TUSHKA — Shkurtoi, vetëm thuaji berberit të të qethë mirë që të mos të humbasë prezantabiliteti i kokës! (*Stasi del. Në skajin tjetër*

hyn Sofoja e Ristoja, një fshatar në moshë të mesme.)

SOFOJA — Ja, tek ajo tryeza në qoshe.

RISTOJA — Ai trashaluqi?

SOFOJA — A, jo ai është kunati, Stasi duhet të jetë diku rrrotull. Eja.

RISTOJA — Të thashë, dua t'i shoh të gjitha me sy, ç'shtëpi e ç'katandi ka. Nuk e kam çupën shqerrë që ta nxjerr në pazar. Ja kështu!

SOFOJA — Shumë e drejtë

RISTOJA — Se edhe gjendja ekonomike duhet, apo jo?

SOFOJA — Ajo është e para.

RISTOJA — Ja kështu! Vetëm, pak me marifet, që të mos e marrin vesh se vizitën në shtëpi e bëj me qëllim.

SOFOJA — Ma lerë mua në dorë. A nuk të pata thënë që do t'i gjej çupës një burrë në qytet që të pëlcasë fshati nga zilia?

RISTOJA — Më the.

SOFOJA — E, mjaft na përrallise se mos e djallo-sësh fare këtë fejesë që mezi e mpleksa. Më the se çupën e ke të bukur, nukë?

RISTOJA — Hë... ashtu thonë.

SOFOJA — Këtu të dua! Au, sa femra i vërtite-shin Stasit! Kush nuk e merrte. Djalë i vetëm, shtëpi të re, ekonomist...

RISTOJA — Ekonomiqar, ë?

SOFOJA — E, e edhe ekonomiqar, domethënë i kursyer është por nga zanati është ekonomist. (*Stasi hyn nga ana tjetër dhe ulet.*) Ja, ai është.

RISTOJA — Duke t'palk i moshuar, flokërenë.

SOFOJA — Tridhjetë e një. Fllokët si kanë rënë nga studimet. Ka shkollë tjetë, s'është gdhë si ne të dy. Ç'të mbajë më parë koka e shkollës? — ALOTOR

RISTOJA — Do të ketë edhe ndonjë thinjë!

SOFOJA — Qudi me ty! Kë parë gomar të thinjur? Nëqesh Të gjithë murashë janë Pastaj, që do edhe një dhëndër qumështor që s'di të fshijë as qurrit? Eja tani, (Afrohen) Ja, o të dashurit e mi, po ju njoftoje, Riston nga Lajthizai!

STASI — (Duke u përshtendetur.) Gëzohemi... gëzo-

hem shumë. — Mëq o shërbim oja! — ALOTOR

TUSHKA — Tushkë! Dhimitraqi më quajnë.

RISTOJA — Njatjetani, njatjetami. (Ulén. Pauzë.)

SOFOJA — (Stasit, ulët) Hë, c'më rrësi hui gardhi?

Pyete vjehrfin se çfarë dëshiron të pije?

STASI — (Automatisht) C'do të pini, shoku Risto?

RISTOJA — Një pa bojë! — ALOTOR

STASI — Si pa bojë?

SOFOJA — Ah, more xhan, more shpirt i kulluar i Sofos! Pa bojë, domethënë raki! (Kamerierit)

Dopio!

RISTOJA — (Stasit) Po zotrote?

SOFOJA — Ku pi Stasi, mor byrazer! Nuk e vë në gojë rakinë e duhanin. Janë helme ato, thotë.

TUSHKA — Po të pinte poshtë e lart, nuk e bën te dot shtëpinë të re ky!

RISTOJA — E mbaruat shtëpinë?

STASI — Faktikisht, unë rrëgullova shtëpinë e vjetër që kishim nga babai.

SOFOJA — Po zëre se e bëre të re ama!

RISTOJA — Sali të kushtoi?

SOFOJA — Do t'i ketë kushtuar një treqind mijë me vjetrat.

RISTOJA — Oh! Ti qënke shkundur fare.

SOFOJA — Mos i qaj hallin kalorësit, Risto. Ku ka rrjedhur do itë pikoje. (*Vjen kamerieri*) Epo, të dashur miq, lej të ngremë kupat për këtë krushqi, u lidhtë fort dhe qoftë e pazgji-dhur kurrë.

RISTOJA — Mos u rrëmbe, Sofo. Mua zemra ma do dhesvajzat nuk më kthen fjalën po prapë them, këto punë nuk bëhen tak falk. Ja kështu.

STASI — (*I hutiar*). Si?

RISTOJA — S'bëhen kështu këto fejesa, duhen hapur sahanët më parë.

STASI — Si?

RISTOJA — Gjykojeni vetë, jemi kooperativë malore, s'kam kushedi ç'pajë për çupën. Ja kështu.

TUSHKA — Nuk do ta martoni vetëm me një këmishë de!

STASI — (*Ristos*) Faktikisht, unë jam me ju. Paja është mbeturinë e vjetër. Nuk dual pajë.

TUSHKA — Me këmishë?

RISTOJA — Rinia di vetë se ç'bën, këtjetër mendje, ajo. Ja kështu.

STASI — (*Që ka marrë zemër*). Unë jam kundër

dasmave të mëdha e me bujë. Thjeshtësi, sa më shumë thjeshtësi.

TUSHKA — Sado kudo, nuk do të pyesim ty! Ti do të jesh vrima e fundit e kavallit. Qilarxhi do të jem vetë dhe në dasmë do ta djegim që të çuditet mëhallë. Jot ëmë ka taksur të marrë dy palë saze, një palë brenda, një palë në oborr.

RISTOJA — Ju, në daç digjeni në daç piqeni po unë jam me Stasin. U iku koha salltaneteve e harxheve. Vjen taksia, nga një gotë për urim, fut çupën brenda dhe hajt... udhë e mbarë në punë të saj.

SOFOJA — Sa gëzohem që i lidhët telat kaq shpejt me njëri-tjetrin! Si vëllezër e shkuar vëllezërve!

TUSHKA — E gjetën gjuhën, pos!

SOFOJA — Hajde me ç'fis lidhe krushqi, o Risto! Djalë i vetëm, soj i zgjedhur! Pale kunati, Tushka! Alamet burri, e njeh gjithë qyteti.

RISTOJA — Më bëhet qejfi shumë.

SOFOJA — Po shtëpia e tij? Pallat! Le që ç'them dhe unë? Ti do ta shohësh me sytë e tua që sot.

RISTOJA — Si kështu?

SOFOJA — Stasi m'u lut ta nderoni me një vizitë. Apo jo, Stas?

STASI — Po, po... me një vizitë.

TUSHKA — Drekkën do ta hamë nga unë, kam qengj dhe byrek.

RISTOJA — Nuk besoj të kem dhe aq kohë...

TUSHKA — Ju ftojmë me zemër të bardhë ta dini!

RISTOJA — Mos vonohem pa! Se njeriu kur bie pas të pirit...

SOFOJA — Punë e madhe! Pse e ka shtëpinë Stasi?

RISTOJA — Atëherë, nuk po jua prish.

SOFOJA — Shkojmë, byrazerë. Dhe mbajeni mend këtë të dielë, sidomos ti, Stas! Sot e lidhë fatin me një nyjë të pazgjidhshme dhe hyre në sërën e burrave. Kamerier! Llogarinë e Stasit, ju lutem!

TABLOJA E TRETË

Dhoma e pritjes në shtëpinë e Stasit. Bien në sy disa ndryshime që e zbukurojnë. Fajesa është vendosur. Nëna dhe Stasi, pastaj Mariana dhe të tjerët. Nëna punon triko në kolktuk. Stasi provon të vendosë një pjatë të vjetër të piktuuar në mur. Hyn në dhomën tjetër. Dëgjohet zhurma e thyerjes.

STASI — (Duke hyrë) Ta hajë dreqi, ta hajë!

NËNA — C'u bë ashtu, Stas?

STASI — Ja, m'u thye pjata.

NËNA — Mos u sëkëlldis se mbarësi është, po hë!

STASI — Më vjen inat me veten më shumë. Sesi jam bërë kështu.

NËNA — Si?

STASI — Ja, më ngulet mendja në ndonjë vend dhe pastaj shastisem fare.

NËNA — E ke mendjen te nusja, prandaj.

STASI — Po jo moj nënë, ç'nuse! Ne pesë minuta mezi u pamë me të!

NËNA — Hë, se i di nëna këto halle, i di.

STASI — (I mërzitur) Ahu!. (Hyn në dhomën tjetër.)

Hyn Mariana. Në shkallë, kujtohet për diçka, lidh një shami mbi vetulla, merr pamjen e një vajze fshatare të turpshme. Troket disa herë. Del nëna.

NËNA — Urdhëro!

MARIANA — Mirë se ju gjeta nënë. Kjo është shtëpia e Stasit?

NËNA — Kjo të keqen, kjo, po eja brenda.

MARIANA — S'kam nge se më presin shoqet? Po sikur të dilte një çikë?

NËNA — Po cila je ti që e kërkon?

MARIANA — Unë, ja, nga fshati, nga Lajthiza, i thuaj.

Nëna hyn brenda.

NËNA — (E alarmuar) Stas! Stas!

STASI — Ç'është, mama?

NËNA — Aty te shkallët... një çupë...

STASI — Një çupë?

NËNA — Ehë!

STASI — Po ç'kërkon?

NËNA — Ty! Nga fshati, nga Lajthiza, thotë.

STASI — (I trondit) Bobo! Kush të jetë? Kush të jetë?

NËNA — Mos është... ajo?

STASI — Ajo? Jo, nuk besoj. Ndonjë shoqe e saj, kushedi. Po ç'kérkon pa? Mbaje pak me fjalë sa të vishem, pastaj fute brenda.

NËNA — Po nuk do!

STASI — Fute me zor, hyrë thuaji se kështu i kemi zakonet.

Nëna del në verandë. Pantomimë e hesh-tur. Stasi vë kravatë, shikohet në pasqyrë, ulet këmbë mbi këmbë në kolltuk, merr një libër. Duket i hutuar, komik.

NËNA — Stasi... ja, erdhi çupa.

STASI — Urdhéroni! (*Çohet, Mariana heq shaminë*)
Ama, ti qenke?

MARIANA — Unë, e tëra. Si je, gjyshe? (*E përqafon*)

NËNA — U, qorrja e bibës, s'të njoha dot, të këqen gjyshja! Më janë thyer xérxallat, prandaj..

STASI — (*Ja jep dorën ftohtë.*) Ama shaka e buktur kjo! Të vësh në lojë një plakë!

MARIANA — (*Me humor*) Po kravata? È? (*Ia zgjidh*)
STASI — Lëre, kur të them!

NËNA — Ulu, ulu pa nuk zemërohet gjyshja me ty!

MARIANA — Po zemërohet Stasi ama! Megjithëse unë, nga makina drejt e këtu!

NËNA — Dhe pa bukë do jesh, e di unë! Dale të të bëj ndonjë gjë gjyshja.

Hyn në dhomën tjetër. Pauzë

MARIANA — Nuk po më pyet gjë, o dajo?

STASI — E çfarë?

MARIANA — Po edhe mund të më pyesje ndonjë gjë se unë vij nga Lajthiza.

STASI — Ohu.. edhe ti! Si e si të ngacmosh e ke mendjen, njëlloj si yt' atë.

MARIANA — Nuk të ka marrë malli a?

STASI — Shiko, mos përfito ngaqë të kam trajtuar si shoqe. Faktikisht, je mbesa ime.

MARIANA — Edhe unë si shoqe të kam folur e të flas.

STASI — S'kemi ç'të flasim, faktikisht, kjo fejesë është vendosur.

MARIANA — Nuk u trembe pak kur të tha gjyshja se të kërkon një fshatare? Thuaj të drejtën ama!

STASI — Hm... ja le ta zëmë se u hutova pak. Ç'del nga kjo?

MARIANA — Del se këtë hutim ke për ta provuar kushedi sa herë. Dy njerëz kaq të panjohur si ju të dy, si do të kuptohen vallë? Ja, këtë ti nuk e di.

STASI — Kjo do të kalojë një ditë, s'jam i pari që martohet kështu.

MARIANA — Për fat të keq...

STASI — A nuk më the që është e mirë, e urtë, e ndershme?

MARIANA — Dhe nja pesëmbëdhjetë vjet më e vogël nga ty.

STASI — As këtu nuk jam i pari. Ti e di, mua më duhej pikërisht një grua e tillë që të kem

mundësi ta mësoj me jetën dhe zakonet e mirja.

MARIANA — Dhe je i bindur se ajo do t'i plotësojë të gjitha këto kushte?

STASI — Hm... le të shpresojmë. Thonë se fejesave në moshën time duhet t'u bësh nja njëzet e pesë për qind firo legale. Besoj të jem benda.

MARIANA — Llogari e hidhur kjo, dajo. Sikur të ishe martuar me ndonjë tjeter që e njihje, nuk do të kishe nevojë ta bëje.

STASI — Me... me një tjeter?

MARIANA — Mirëpo ti e braktjise atë dashuri.

STASI — S'është e vërtetë. Unë nuk i kam thënë asgjë Shpresës. Faktikisht unë nuk i kam shprehur kurrë asnijë ndjenjë përveç ndoshta njëfarë simpatie.

MARIANA — Që ishte e dyanëshme dhe fare pranë dashurisë.

STASI — Jo, kjo ka qenë vetëm një miqësi dhe unë do ta ruaj atë. Shpresa më uroi.

MARIANA — Tani ty do të të pëlqejë ta gënjesht veten përditë nga pak, dajo. Edhe ndryshimi i moshiës, edhe mënyra se si u rregullua kjo fejesë po fillojnë të të duken se s'kanë asgjë të keqe, se janë të zakonshme e normale. Po s'është kështu, më fal që po ta them. Kush ju bashkoi? Një i huaj, një xhambaz nusesh e dhëndurësh.

STASI — Ohu, po të jetë për të bërë moral, di edhe unë të bëj. Pojeta, mbesë, është ndryshe, aty gjërat nuk janë bardh e zi. Po ti do t'i kup-

tosh këto vetë ndonjë ditë të bukur kur ja ai, xhambazi, siç e quan padrejtësish, të të njoë me ndonjë inxhinier këtu në qytet dhe pastaj...

MARIANA — A, jo, me mua kjo s'ka për të ndodhur kurrë.

STASI — Këtu të jemi! Ca projekte janë bërë që tani. (*Te dritarja.*) E lëmë këtë bisedë me mirë! (*Mariana hyn në kuzhinë.*)

KRISA (*Duke hyrë*) Uh, plasa! (*Lëshon trastet përdhe. Stasi mundohet ta ndihmojë.*) Na, me kujdes se mos thyhesh gjësind.

STASI — Ç'ka aty? Vezë?

KRISA — Vazo me ullinj, me turshi. Kujdes, ka një pjatë me majonezë përsipër.

STASI — Do të hamë darkë bashkë?

KRISA — Po vjen Sofoja me nëndrejtorin tënd, Elmazin. Sikur kishte ca salcë kosi në frigorifer.

STASI — E hëngri Tushka.

KRISA — E hëngërt murtaja! S'lë gjë pa përlarë.

STASI — Ka ardhur Mariana. Është në kuzhinë.

KRISA — (*Te dera*) Marianë, hajde më ndihmo të shtrojmë tryezën. (*Mariana del, e përqafon.*)

MARIANA — S'më lë as të ha një kafshore as të të puth..

KRISA — E, ë, i kam zët këto përkëdhelje unë. Nxito se presim miq. (*Fillojnë të shtrojnë tryezën.*) Jo ashtu, vër picetat e reja, sille atë servisin e mirë. Hë moj, ç'u shastise? Do të vijë nëndrejtori i Stasit.

MARIANA — Po punë e madhe. Mirë janë edhe këto.

KRISA — Atë e di unë. Miku është mik, ashtu siç është e djela e djelë. Vetëm në një shtëpi i kanë ditët njëlloj të gjithë, te këta Poçarët.

MARIANA — Po ti s'ke qenë kurrë në shtëpinë e tyre.

KRISA — S'kam qenë, por e di. Ato janë «ku rafsha mos u vrafsha». Posa e pashë atë Shpresën e tyre të pispillosur si kokonë. Me siguri vinte në sinema.

STASI — (*Duke qeshur.*) Mos prisje që të mbante zi për mua?

KRISA — Jo po që të kam llafin, se edhe ty sikur të hanin hundët për të. Në vend që të jetë e mërzitur se i iku edhe një fat nga dora, pispilloset dhe tralala! Sonte të gjithë lajnë kokën kurse ajo...

NËNA — Mos e merr nëpër gojë vajzën e shkretë, Krisë, se është gjynah.

KRISA — Ua, sikur më mori malli për të!

STASI — (*I nervozuar*) S'keni muhabet tjetër sot te ju?

MARIANA — Nuk të duron njeri kur flet si ato gratë llafazane, mama, ta dish!

KRISA — U? Na, moj, na! S'na duroke ti! Nënën nuk e duroke ti? Mëso kalamajtë atë bëj dhe jo nënën që të ka bërë kokën.

STASI — (*Duke qëshur.*) Ehu, nuk ta mban shumë ajo, Krisë, ta pëlcet mu në sy. Ajo edhe fejesën time nuk e pëlqen, e kritikon.

KRISA — Si?

MARIANA — Pse çudidesh, mama, unë e kundërshtova që sa po mora vesh, ti e di.

KRISA — Po ne si të porositëm, moj të rëntë një pikë e të pikoftë? Nuk të thamë: sakën se ia zë në gojë këtë llaf dajo Stasit? E do dajën ti apo s'e do?

MARIANA — Se e dua pa s'mund të rri indiferente.

KRISA — ...ferente, pos! Dini llafe të mëdha ju, të lidhni e të zgjidhni me to, megjithatë dy para mend nuk keni! Fyçka jeni!

STASI — Mjaft, s'dua grindje këtu.

KRISA — Më prishi gjakun, ju prishtë mendja.

STASI — Mos u mërzit, motër. Stasi me zor e jep fjalën, po kur e jep nuk ka burrë që t'ia kthejë mendjen.

Hyjnë Tushka, Sofoja dhe Elmazi, me zhurmë.

ELMAZI — Mirëmbërmani, shokë!

STASI — Urdhéroni, shoku Elmaz, urdhéroni...

ELMAZI — (Ulet) Po qysh u ngrysët njéherë? Si e ndien veten pas fejesës, shoku Stas? Në qielin e shtatë, apo jo?

SOFOJA — (I puth dorën nënës.) Mirë qenke, mëmëzë, si bukë me qiqra.

NËNA — M'u rehatua shpirti.

SOFOJA — Sepse e nxore jashtë të keqen e brendshme.

TUSHKA — (Te tryesa) Urdhéroni, shoku Elmaz, si në shtëpinë tuaj.

ELMAZI — Qysh s'më ra rasti të të vija më parë

në shtëpi, shoku Stas! E shoh që qenke rrëgulluar bulkur fort.

STASI — U munduam... ç'ka...

ELMAZI — Paske edhe kolltukë modernë! Ke nisur të burgjezohesh, qerrata!

STASI — Gjëra të vogla.

ELMAZI — Mos u vrenjt ashtu se bëra shaka.

TUSHKA — Hi.. hi.. hi.. je shakaxhi i madh zotrote.

ELMAZI — Ah, ç'na bëre, more Stas! Ne mburreshim me ty.

TUSHKA — Mburremi posa, sado kudo.

ELMAZI — Ja, ne për vete, thoshim, e hëngrëm atë... koqe ulliri dhe u martuam, po kemi Stasin kolonë që na nderon. Kurse ti...

Pauzë

KRISA — U.. u.. po ç'është kjo, shoku Elmaz? Si do mbetej Stasi pa nuse.

ELMAZI — Po shaka, moj shoqe, shaka

TUSHKA — Shalka, tamam, ma more nga goja.

STASI — (Me humor) Epo, shoku Elmaz, faktikisht, në këtë situatë thashë edhe unë ta vë interferisin e përgjithshëm mbi atë personal. Ku vuajnë shokët e martuar, thashë, le të vuaj edhe unë!

Qeshje, i rrakin supet Stasit

ELMAZI — Të lumtë! Shiko, sa u fejove dhe të erdhi goja. Në të vërtetë, shoku Stas, ti ke gjëzuar gjithë kolektivin e ndërmarrjes. Po qysh ore, e kishim të gjithë si gozhë marresën tënde.

KRISA — Gozhdë e kishim, po faleminderit Sofos,
tani na doli.

TUSHKA — Prandaj, ta festojmë! Ngrije gotën, shoku Elma!

ELMAZI — (Pi) Me trashëgime! (*E troket me Sofon.*)
Paske qënë dorëmbarë ti! A e di që një herë
më pat shkuar mendja edhe mua që t'i gjej
Stasit një nuse?

KRISA — (*E llastuar*) U... u... faleminderit shumë
për kujdesin.

ELMAZI — Për ideal, ju them. Kishte një mbesë
Maksamuti në Vlorë dhe m'u pat lutur për një
burrë.

SOFOJA — Po ne ia gjetëm thëllëzën. Në esfel
të vejë mbesa e Maksutit.

NËNA — Paska qenë myslymane...

ELMAZI — E, plakë; s'kemi tani myslimanë e të
krishterë. Fesë ia vumë kazmën!

MARIANA (*Pa pritur*) Sikur t'u vinim kazmën
edhe këtyre mblesërive, lere sa mirë do të
qe...

ELMAZI — (*Kollitet, i habitur*) Km... po kjo?

TUSHKA — (*Kollitet edhe ai.*) Është... është vaj-
za ime.

KRISA — (*Mënjanë*) Pusho, moj ta çapalofsha atë
gojë!

ELMAZI — Çdo gjë ka radhën e vet. Për atë që
thua ti, nuk ka ardhur akoma dita, them
unë.

MARIANA — Pse? Apo mos doni të thoni se është
e pamundur të martohen të gjithë me njohjen e
njëri-tjetrit në punë, në jetë, me dashuri.

Pauzë.

TUSHKA — Leri, moj, konferencat! (*Elmazit*) Mos ia vini re, e kam mësuese me Universitet.

ELMAZI — Natyrisht. Rinia ikën përpara! Çan!

TUSHKA — Ç'pret, o kunat, që nuk e ngre gotën?

ELMAZI — Le t'i harrojmë të shkuarat! Edhe mbesa e Maksutit, në esfel të gomerëve le të vejë, mirë e the! (*Cohet*) Në emër të kolektivit punonjës të ndërmarrjes, shoku Stas, të uroj të trashëgohesh! Urime edhe juve, tej e tej.

STASI — (*Belbëzon*) Nga zemra... nga zemra...

Pauzë — Hanë e pijnë

TUSHKA — Merrni nga kjo majonezë, shoku Elmaz. E kam bërë vetë.

ELMAZI — E shijshme! Po ju gratë, pse nuk ulein me ne? Po mësuesja? A, jo kështu! Nuk ulesh në tryezë me burrat! Ç'është kjo? Të zura, ë? Se, qëparë më zure ti!

MARIANA — Epo, unë jam ngarkuar t'u shërbëj... burrave.

TUSHKA — (*Që mundohet të kapërcejë situatat që krijon e bija.*) Shoku Elmaz, di të bëj edhe një majonezë tjetër unë, me një formulë spanjolle që të lëpish thonjtë! Do t'ju ftoj ndonjë mbrëmje.

ELMAZI — Do të vij me kënaqësi.

TUSHKA — Kam edhe një verë të vjetër. Do t'ia shtrojtmë!

KRISA — Tushkën e kam shumë merak pas të ngrënët.

ELMAZI — Duket.

TUSHKA — Po ç'kënaqësi tjetër më të madhe ka njeriu? Ka pasur një muzikant në Itali, se Rushani, se Rushini, nuk ia di tamam, që kur ulej të hante nuk ngrihej po të mos e bënte tryezën sikur të kishte rënë karkaleci. Mirëpo kur nuk punonte, e mbyllnin në dhomë dhe e linin pa ngrënë!

ELMAZI — Ç'pret prej tyre? Borgjezë!

TUSHKA — E tmerrshme, ë? Të të mbyllin që të vuash nga uria!

MARIANA — Sikur ta lije babanë pa ngrënë, fluturonin tjequllat.

TUSHKA — E shoku Elmaz? E dëgjon si bën çupa shaka me babanë?

ELMAZI — S'i gjë, rinia çan përpara. (*Stasit*) More shoku Stas, qysh më doli nga mendja, a e di ç'vepër të madhe ke bërë duke sjellë një nuse nga fshati? Është thyerje koncepti kjo!

SOFOJA (*Stasit*) Ta thashë unë!

STASI — (*I turbulluar*) Po... po...

ELMAZI — Se, për ideal, ne shqiptarët, në thelb, të gjithë fshatarë jemi. Pse të mos japim e të mos marrim me fshatin? Ti, shoku Stas, ke thyer një koncept dhe ke shkulur nga mendja jote një gjemb, një... një rrënëtë vjetër! Gëzuar!

MARIANA — Po mblesëria, meqë erdhi fjala, si ju duket, shoku Elmaz? A nuk është dhe ajo një nga ato rrënjet, siç i quani ju?

ELMAZI — Hë... si të them xhanëm, tashti edhe unë

vetë me mblesëri jam martuar dhe s'kam parë ndonjë të keqe po dreqi e di, është çështje fort e ngatërruar kjo.

SOFOJA — Përkundrazi, është e thjeshtë fare!
Ja, le t'i rrjmë hallit këmbë kryq. A martothen dot të gjithë me dashuri?

TUSHKA — Martohen... (*Shenja të Krisës*) Se më shpëtoi goja, desha të them nuk martoherdot!

SOFOJA — Derisa nuk martoheren ashtu, me njëfarë mënyrë duhet të martoheren!

ELMAZI — Unë them, s'ka ndonjë gjë të keqe kur ndërhyjn njeriu të afrojë dy njerëz që njihen mirë midis tyre...

MARIANA — Po kur nuk njihen? Po kur kanë ndryshime të mëdha midis tyre?

ELMAZI — A, jo, jo! Duhet të njihen, të njihen!

SOFOJA — Kështu është kurdisur kjo qerrata botë! Sikur mos ishim ne njerëzit e dhemshur e gojëmjaltë, gjysma e saj mbetej pa martuar. Të bësh dy njerëz të lumtur! Po ka gjë më fisnike se kjo, mor aman?

TUSHKA — S'ka! Dhe, ta dini nga unë, këtë nuk e bën dot kushdo.

MARIANA — Pse nuk e thua emrin tamam, Sofio! Ne mblesët, thuaj!

SOFOJA — Dale, dale, q'ne ky emër? A, edhe mblesë ka pasur, pos! Doli dhe një film, e mbani mend apo jo, kishte një mbles me kobure që ndiqte nusen, se ajo nuk desh të martohej, Andej nga malësia, kjo. S'di q'mund të ndodhë andej, xhan i vëllait, po

këtej nga në nuk gjen njerëz të atillë. Kurrë!
TUSHKA — Kurrë! Ja, merrni Sofon. Ka kobure
ai? S'ka kobure!

SOFOJA — S'është çudi, çupë, edhe ti nesër mund
të martohesh me një... ndërhyrje të mirë.
MARIANA — A, jo, unë do të përpinqem ta gjej
vetë! Po ç'ti bësh atyre që të vrashin pa ko-
bure, atyre nuk u duket gjurma shumë...

Pauzë

KRISA — (Tushkës) Do t'i flasësh sat bije, apo
jo?

TUSHKA — Moj ti... si e ke hallin që na prish
atmosferën festive të darkës? Léri kë-
to filosofira, se nuk u kanë lezet femrave
ato.

ELMAZI — I lemë filosofirat! Dollinë në dasmë,
Stas. Dhe në kokën e mbësës.

SOFOJA — Me ndonjë doktor!

KRISA — Ishalla!

MARIANA — I gjori doktor, do të plaket po të
më presë mua. Unë e dua burrin mësues,
si vetja.

ELMAZI — Coke këtu! Mësues merreni!

SOFOJA — Qesh edhe një herë, moj çupë, pa le
të jetë edhe me pahir, se na zbutë, kurri-
zin me kritika sonte!

TUSHKA — Na preu oreksin, dreqi! Po e ka të
mirë babai, të mirë more! (*Çohet dhe e
puth. Atmosfera duket e rregulluar.*)

SOFOJA — Dhe tani, lajmin më të fundit, Stas!

Të dielën që vjen, bëhuni gati se do të shkë-mbejmë nishanet!

KRISA — Ne jemi gati prej kohe!

NËNA — Të më trashëgohesh, o bir!

Urime, përqafime.

SOFOJA — T'i zbririm kupat me fund dhe të ikim tani, se edhe Stasi ka nevojë të qetësohet. Si thua, shoku Maze?

ELMAZI — I zbririm! Edhe njëherë, shoku Stas, me trashëgim.

SOFOJA — Zbraze në gurmaz
me sulm e me gaz!
Ty të ardhshim pas,
O shoku Elmaz! (E pi)

ELMAZI — Un' o Sofo, po e zbraz!
për shëndetin e shokut Stas
se në dasmë kur t'i vijmë
do t'ia djegim shtëpinë!
Me bejte më fole, me bejte të fola!

TUSHKA — O! Do ta djegim, domosdo që do ta djegim! Ah, ju lumtë goja! Si goja dhe zemra! Unë i gjori, nuk ia them për bejte! (E pi)

Dalin Tushka, Elmazi, Sofoja. Nëna e Krisa hyjnë në dhomë.

STASI — (Në verandë, pasi i ka përcjellë.) Ah, ç'natë e mrekullueshme. Më vjen mendja rrotull. E çuditshme! Si qenka lumturia. Në fillim të duket e pakuptueshme, e largët, e pakapshme, si ai zogu që flutu-

-~~Bida~~ ron. Pastaj zgjat dorën dhe fap... e kap, e mbërthen dhe e shtrëngon në dorë.

MARIANA — (Që ka dalë pa u vënë re.) Mos e hap, dajo Stasi!

STASI — (I hutuar nga prania e saj.) Çfarë mos tē hap?

MARIANA — Grushtin. Se mos tē fluturojë zogu! (Stasi e ndjek nëpër shkallë por nuk e zë dot.)

STASI — (I lodhur) Thuaj ç'të duash! Sonte nuk mund tē zemërohem me asnjeri!

PJESA E DYTË

TABLOJA E PARË

Paraskenë, pastaj dhomë fshati në shtëpinë e Ristos. Hyjnë Krisa, Tushka, Sofoja, Stasi, Zhurmë makine. Hyn shoferi.

KRISA — (Shoferit) Ç'është kjo pikë e zezë? Na le në mes të rrugës, për turp të dynjasë.

SHOFERI — Rruga është supermalore, kurse unë e kam motorin të rënë.

KRISA — Tani u kujtua të bjerë?

STASI — Nuk e kupton dot ti, Krisë, kjo është fjalë teknike.

KRISA — Ç'më duhet mua se ç'është! Unë dua të vele me taksi deri në vend.

SHOFERI — Epo mirë, përvishni krahët ta shtyjmë atëherë.

TUSHKA — Sado kudo, për këtë nuk kemi borxh t'ju paguajmë. (Përvesh krahët)

KRISA — (E ndalon) Allasëndëk! Edhe kjo na

duhej, të nisemi krushq e të sosim hamenj.
STASI — Faktikisht... pse të mos bëjmë nja dhjetë minuta më këmbë? Përbledhim edhe mendimet. (Shoferit) Urdhëro paratë.
TUSHKA — Mos e paguaj tamam, Stas, se e kishim akaparosur deri në fshat.
STASI — Sot nuk vihen re këto vogëlsira, kunat.
SHOFERI — Hajde — rrofsh dhe me trashëgime. (Kthehet) Ore, se s'të pyeta, ku e njohe këtë vajzë fshati ti, apo në hekurudhë?
TUSHKA — Jo, në plazhin e Roskovecit.
KRISA — Pastaj, ç'të hyn ty në qese?
SHOFERI — Kot, sa për kuriozitet.
KRISA — O, korrozitet i bukur ky!
SOFOJA — (Me mburrje) Ia gjeti kodka këtu!
SHOFERI — Ama ti ia paske gjetur? (Stasit) Ki kujdes, byrazer, se mos e pësosh si ai që u nis për lesh dhe u kthyesh i qethur.
TUSHKA — Hy, gremisu andej, mos na hidh piper në ëmbëlsirë!

Shoferi largohet.

KRISA — Ç'është ky tersllék? Flasin njerëzit si pa gjë të keq.
SOFOJA — Merren me thashetheme, po hë.
TUSHKA — (E ndjek pas) Thashethemexhi!
STASI — Do të nisemi?
SOFOJA — Dale të çlodhemi pak. Ty të zien gjaku, o byrazer, po mua m'i trazoi zorrët makina.

TUSIKA — Na i skuqi nervat dhe ai dreqi...
shoferi!

KRISA — Nderi na e deshte të vinim me taksi
deri te porta e krushkut.

SOFOJA — Dhe t'ia buçisnim borijes bububu!
Hajde, or hajde! (Këndon) «Dilni hapni
penxheretë! Po vjen Stasi vet'i tretë» (Be-
fas) Ore Stas! Ç'djall e ke vënë atë kasketë
në kokë?

STASI — Që të mos më bëhen flokët pisë nga
pluhuri.

SOFOJA — Tani kasketat s'janë fare në modë.

KRISA — Mosha e tij mbajnë republika. Stasit i
ka hije shumë republika.

STASI — (Që do t'u shmanget këtyre bisedave.)
C'lajthi paska ky pyll!

KRISA — Pse s'blen një republikë, Stas?

STASI — Të jenë pjekur vallë?

KRISA — Të blesh! Mos u bëj i shtrenjtë në
krunde dhe i lirë në miell.

Hyn Dhosi, djale fshati rreth të tridhjetave.

DHOSI — (Sulet drejt Stasit.) Stasi! Më vdektë
im atë që ti je Stasi!

STASI — (I hutuar) Unë i téri, pse si është puna?

DHOSI — Sa të pashë, më vajti mendja, ky ësh-
të dhëndri thashë. Më vdektë im atë, po.

SOFOJA — Po ai do të jetë, domosdo, s'jam unë
që...

KRISA — Po juve... kush...

DHOSI — Dhosi, kushëriri i parë i Klodit nga në-

na. (*Pérqafon Stasin.*) A ore Stasore. Stas, ç'më kënaqe! (*E pérqafon prapë.*)

TUSHKA — (*Si i kujtuar*) O! Domethënë krushku!
Po si je, krushk, si vete, krushk? (*E shkund paq.*)

DHOSI — Unë, që thua ti, thashë po dal t'i pres te e përpjeta e madhe se këtu me siguri do t'u mbetet makina. Më vdektë im atë. po.

KRISA — Këtu na mbeti që i rëntë një pikë.
Dhe ta shikoje ç'makinë ishte! Si prej dhiplomati.

SOFOJA — Më falni, më përzihet ca... (*Largohet*)

DHOSI — Po rrini ca, çlodhuni, merrni veten.

STASI — Ama lajthi, jo llaf! Të lenë të mbledhësh?

DHOSI — Me mua mos çaj kokën! (*Dalin*)

KRISA — (*Thërret*) Stasi! Ki kujdes mos grisësh kostumin nëpër ferraaa!

SOFOJA — (*Hyn*). Dhe thuaji Stasit ta heqë atë kasketë se nuk i shkon fare.

TUSHKA — Ç'të mbeti goja te kasketa ty?

SOFOJA — Dëgjomë mua. Nganjëherë këto gjëra...

TUSHKA — Do t'i them. Derisa e thua ti, ashtu është, nuk i shkon.

KRISA — Thirri Stasit, të vijë tani.

SOFOJA — O dhëndër! Eja more, eja se po të pret nusja! (*Heshtje*) Dil, se ky pyll ka edhe arinj!

KRISA — Korba! Stasi, Stasiii..

SOFOJA — Pusho moj, se bëra shaka.

Hyn Stasi me Dhosin.

STASI — Ç'lajthi tē mira kishte!

KRISA — I paske bërë xhepat si torba. Hidhi nē çantë.

DHOSI — Derisa tē arrijmë, do t'i kemi kollofitur, po hë!

TUSHKA — Oj tē kollofitur! Me gjithë guaska bile!

SOFOJA — S'janë pér dhëmbët tonë ato. Tushkë.

DHOSI — Atëherë, rrugën e dini, unë po nxitoj që t'i lajmëroj. A, o Stasi, o Stasi! (*Largo-het ca, i përshëndet me dorë.*) Auu-u!

KRISA — Si karafil m'u duk ky krushku! (*Nisen*) Pu... pu, ç'udhë e ligë! Do tē më mbeten takat nëpër gurë.

SOFOJA — Zbathi se ecën më lehtë.

KRISA — Më vjen si turp pa. (*I zbath*)

TUSHKA — (*Stasit, mënjanë*) Hajde, or hajde! Ja, na erdhi dhe kjo ditë me nishan pér ty, Staskë! Pa kur tē na dalë kjo nuse pérpara, e bardhë, e bardhë si ajkë qumështi!

SOFOJA — Më ke borxh një palë këpucë, Stas! Pér ty i grisa!

TUSHKA — (*Vazhdon përsytyrimet e tij.*) Me ato gërshteta tē gjata përmbi gjoks, si... femrat që na shfaqen në ëndërr...

KRIŠA — (*Me inat*) E nxore më në fund! S'të mban gjë barku ty!

TUSHKA — Në ëndërr them dhe unë... po në ato

ëndërrat e vjetra të djalërisë, moj Krisë, siç thoshte dhe kënga (*Këndon*) «Fle, dhe nëën-dërr të shikoj dhe s'të harroj /Mos më mundo, o xhan, o shpirt, o zemër-o.»

KRISA — Mjaft, se na zure veshët! (*Urdhëruese.*) Stas, përvishi pantallonat, vër një shami nën jakën e këmishës. Unë përpara, ju pas meje! Në dhomën e pritjes së Ristos. Me krushqit e qytetit është bashkuar edhe Mariana. Në dhomë janë Ristoja, një çift, kushërinj të tij, e shoqja, Dhosi.

RISTOJA — Krushq, mirëseerdhët! Çifti të na trashëgohet! Ja kështu!

KRISA — (*Cohet*) Krushq, mirëse ju gjetëm! Si motër e madhe, më këmbë të mamasë, faleminderit për pritjen nga thelbi i zemrës. Të na trashëgohen një herë e me jetë!

DHOSI — (*Kushëririt*) Deli djalë është, më vdek-të im atë!

KUSHËRIRI — Hë më i lumtë, ja.

KUSHËRIRA — C'punë bën thanë?

DHOSI — Ekonomist i thënka, merret me hesape.

KUSHËRIRA — Llogaritar si Xhikja ynë, pse s'thua?

DHOSI — Llogaritar xhanëm, po jo në kooperativë. Alamet rroge!

KUSHËRIRI — Hë më i lumtë, ja.

KUSHËRIRA — I lumtë, pos! (*Kukuris me vete*) Më therrshin mua po të mos i ketë rrumbullakosur të dyzetat!

KUSHËRIRI — Pun e madhe, se mos do t'i ziejë mishin!

Biseda zhvendoset në anën tjetër

SOFOJA — Po si u mban shëndeti, o të dashur
krushq?

RISTOJA — Mirë jemi, shyqyr, mirë.

SULLA — Më këmbë erdhët? Kush e di sa jeni
lodhur!

KRISA — Ç'është ajo? Si do të vinim më këmbë?
Erdhëm me taksinë më të mirë të qytetit.

SOFOJA — Mirëpo, do ti sa arritëm te pylli i laj-
thive, sec i krisi brenda dhe na mbeti??!

KRISA — Thashë, më mirë ta hamë turpin me bu-
kë e të shkojmë më këmbë se sa të pësoj-
më ndonjë aksident.

SULLA — U, larg qoftë! Mirë bëtë!

TUSHKA — Nuk zemëroheni, ë?

RISTOJA — Ç'është ajo fjalë!

Pauzë

SOFOJA — (*Stasit*) Fol edhe ti ndonjë fjalë!

STASI — Po ç'të them?

SOFOJA — Pyet gjë, zëre se do të diskutosh në
mbledhje...

KRISA — (*Vazhdon bisedën me Sullën.*) Le gjithë
e gjithë, krushka Sullë, po ky vëllai im don-
te t'i jepte bakshish!

SULLA — Kujt?

KRISA — Atij de, shoferit! Apo jo, Stas?

STASI — (*I zënë në besasi*) E... po, po.

TUSHKA — Po unë nuk e lashë! S'bëhet kjo punë,
thashë unë!

RISTOJA — Ç'na thua ndonjë të re andej nga qy-
teti, Stasi?

STASI — Hic, faktikisht... punojnë. Ju, si dukeni
me bujqësinë?

KUSHËRIRI — Misrat i kemi të mbara sivjet.

TUSHKA — I pamë! Na kallëpi, sa krahu! (*Gjesti
i tij komik shkakton kukurisje të mbytura.
Krisa e nduk pas mënge.*)

STASI — Edhe pylli kishte kiamet lajthi.

DHOSI — C'i do? Janë pronë e shtetit, s'me-
rret vesh kush i mbledh ato.

RISTOJA — S'na ke ardhur më për peshk, So-
fo!

SOFOJA — Kam qenë i zënë. Mbeta dhe ca ditë
dëshmitar në një gjyq.

KUSHËRIRI — Hö më të lumtë, ja! Unë i kam
shumë qejf gjyqet, po s'më ka rënë rasti
të vete.

KUSHRIRA — E c'punë kemi ne me gjyqet?

SOFOJA — Që të ngas muhabetin, një çift që
ndahej pardje, ishte martuar duke e rrë-
mbyer njëri-tjetrin. Në fillim, ne, lagjia,
habiteshim me tërë atë dashuri.

RISTOJA — Ja kështu!

SOFOJA — Ore, e di si e shikonin njëri-tjetrin?
Në gojë, sikur u rridhete mjaltë. «Ja c'ësh-
të familja me sevda» — rrihnin gjoksin
ca nga ata rinokët e panjekur të lagjes.

KUSHËRIRI — Hö më u lumtë... (*E shoqja e
nduk për xhakete.*) Po pastaj?

SOFOJA — Pastaj, o byrazer, tërë ajo dashuri,
u kthye në një sherr që të ikje e të merr-
je sytë. (*Imiton*) «Ky, zotërinj gjyqtarë,
është i poshtër, kthehet çdo natë kur mby-

llet biraria e fundit». «Mos ia vini re ësh-të budallaqe, s'më bëri kurrë një drekë a një darkë!»

DHOSI — Kështu e kanë martesat pa pëlqimin e prindërve.

SOFOJA — Apapa, ç'villnin pér njëri-tjetrin! Vrer, vrer të gjallë!

MARIANA — E ke fjalën pér atë Manushaqen, Sofo?

SOFOJA — Hë, tamam pér atë!

MARIANA — Ashtu ndodhi, vërtet...

SOFOJA — (I kënaqur) S'ju thashë unë?

MARIANA — Vetëm se ti nuk e dikërke mirë se si janë martuar. Ata jo vetëm që nuk dashuroheshin, po as që e kishin parë njëri-tjetrin me sy përpara fejesës.

SOFOJA — A... jo, kjo do të jetë ndonjë Manushaqe tjetër! Ehu, sa Manushaqe ka!

TUSHKA — Ehu, sa Manushaqe ka! Sado kudo...

Hyn Klodi, e fejuara, me një dhisk pér të qerasur. Drejtohet nga Krisa.

SOFOJA — (Stasit) Prapë e vure kasketën? Hiqe! Bëju pak guximtar, të shkretën. Je burrë apo s'je burrë?

STASI — Kollaj e di ti?

KRISA — Krushq, çifti të na trashëgohet, me jetë të lumtur! Edhe në shtëpitë tuaja! (I var nuses një varëse në qafë.) T'u bëftë motra kurban ty! (E puth me zhurmë.)

TUSHKA — (Stasit, ulët) Apapa, yll me bisht, Staskë! Për e bardhë... s'qënka dhe aq, po më

mirë. Ç'i do fare ato bardhoshet? S'kanë pikë lezeti, si të lara me dhallë!

SOFAJA — (*Merr gotën*) Me trashëgime, heqtë këmbën zvarrë edhe pér martesa të tjera.

TUSHKA — (*Stasit, po ashtu*) Ç'fat që pate, qerratuc! Mirë thonë, «i duruari i fituari» (*Huthet se Klodi është para tij.*) Pér hair na qoftë!

SOFOJA — (*Stasit*) Dhuratat pér nusen!

STASI — (*Shtyn me këmbë kasketën që i ka rënë para këmbëve.*) Me... me trashëgime! (I vë një orë dere *Klodit, hedh ca kartëmonedha në dhisk.*)

SOFOJA — Ngrije atë kasketë nga dyshemeja!

TUSHKA — Apapa! Dhe ta dish, Staskë, tërë meritat i ka Sofoja. A mjaftojnë një palë këpucë sipas zakonit?

SOFOJA — (*I pëshpërit Stasit.*) Të mos më kesh mua, s'je pér asgjë. (*Me zë të lartë.*) Krushku Risto, brromp! Gazi t'ju trashëgohet e në fëmijët e tjerë. Mua këtu më keni.

RISTOJA — Me shëndet nga zemra e ta paça hua. Të gjeta, kushëri, në dasmë të vajzës!

KUSHËRIRI — Të prita, kusho! Hë më të lumtë, ja! Brromp dhëndrit!

SOFOJA — Mos ma ngisni dhëndrin, s'është i rakisë ai ja ku e keni Tushkën që t'ju përgjigjet si burrat.

KUSHËRIRI — Të gjeta, Tushkë!

TUSHKA — Të prita! Të prita mu në lule të ballit!
Me fund!

KUSHËRIRI — Me fund!

SOFOJA — Andej nga Shkodra nuk thonë të gje-
ta po «t'u turrça!»

DHOSI — Bukur thënkan, më vdektë im atë, po!

KUSHËRIRI — Edhe me shkodranë ke bërë mble-
sëri?

MARIANA — Jo mblesëri, jo!

SOFOJA — Miqësi, po! Ia marrim njëherë? (Kënd-
don)

Trëndëlinë, moj, si të thashë, moj,
zhvish fustanë, moj, vish dollomanë, moj!

Disa trokitje në derë. Kënga ndërpritet. Shikime të habitura.

RISTOJA — Do të kenë ardhur njerëz për urim.
Shko hape, Dhosi!

Hyn Dhosi, Ariani dhe dy vajza.

KUSHËRIRI — O! Qënka rinia e fshatit! Hë më
ju lumtë, ja!

RISTOJA — Urdhëroni, rini, urdhëroni! Në kokën
tuaj!

VAJZA E PARË — Pse, u fejove ti, Klodi? Ne ta-
ni, po e marrim vesh!

RISTOJA — Paçka, sonte do ta shpallnim, ja kështu!

ARIANI — Epo, urjme! (Vete pranë Marianës.)

VAJZA E DYTË — Qënka një çikë si fejesë sekre-
te...

RISTOJA — (I befasuar) Km... ja kështu...

SOFOJA — (Merr situatën në dorë.) Epo aty është
lezeti i fejesave, te fshehtësia.

MARIANA — Mama, ky është Ariani, ai mësuesi
që të kam folur, jemi bashkë.

KRISA — (Pa qejf) Gëzohemi! Ti i solle ato pipi-ruqet?

ARIANI — (Mundohet ta rregullojë atmosferën.) Ne erdhëm së na dërgoi kryetari i kooperativës. Ai siç duket dinte diçka. Shkoni dhe ftojini në mbrëmjen që kemi për festën e korrjeve, tha...

RISTOJA — Faleminderit, i thuaj, po sonte nuk do të vijmë. Kemi gazin tonë.

VAJZA E PARË — Mirë, xhaxha Risto, po kam frikë se kur të hapet fjala e fejesës, ka rrezik t'ju vijë gjithë fshati këtu. Janë që janë të mbledhur dhe...

RISTOJA — Hm... ashtu xhanëm, festa e korrjeve është festë e madhe, por...

KRISA — Krushq, mos t'ju vijë rëndë nga ne...

MARIANA — Ndoshta do të qe mirë sikur të venim, krushku Risto!

KRISA — Posi, të veni! Nishanet i shkëmbyem, s'kemi ç'të bëjmë më! Ne po shkojmë në hotelin e fshatit.

ARIANI — Mirëpo, kam frikë se kryetarit do t'i mbetej merak po të mos vinin edhe miqtë.

TUSHKA — Bravo kryetari! Unë jam i pari që do të vij! Si thotë dhe ajo kënga «ku ka zjarr e ku del tym/ ku ia bën daullja bym!»

KRISA — (Sofos, ulët) Sikur s'më pëlqen kjo gjë. Nuk na ka hije!

SOFOJA — Edhe mua s'më pëlqen, po kam frikë se mund të thonë që nuk i sajdisëm.

RISTOJA — Në vajçim, krushq, do të vemi të gji-

thë bashkë dhe do t'ia bëjmë «brromp» gjithë
thë fshatit me gazin tonë!
DHOSI — Hajde, o burra, gazi na u trashëgoftë!
Të nisemi!

Dalin.

TABLOJA E DYTË

Paraskenë, pastaj salsa e mbrëmjes. Në paraskenë kalon një grup ku është Krisa, Sofoja, Tushka, kushëriri dhe e shoqja. Sofoja, pak çakërqejf, murmurit këngë.

SOFOJA — E...e...e... mirë ia bëmë krushkësë, që i morëm çupënë..

KRISA — Sa të errëta këto rrugët tuaja, krushku Risto!

RISTOJA — Kujdes mos pengoheni gjékundi!

SOFOJA — Jepja krahun Sofos, moj xhan, mbështetu pa frikë.

TUSHKA — Le të ta japë, për besë, nuk çoj kokë fare!

KRISA — Ju zuri rakia dhe s'dini ç'flisni! Ku e latë Stasin?

SOFOJA — Mbeti prapa me nusen.

RISTOJA — Ishte edhe vajza juaj me ta, ishte dhe mësuesi, Arianë.

KRISA — Sa mirë!

KUSHËRIRA — (Të shoqit, ulët) Si t'u duk dhëndri ty?

KUSHËRIRI — Hë më të hëngërt mortja, ja! Burrë moj, si gjithë burrat m'u duk.

KUSHËRIRA — Burrë, burrë, po i madh për Kladin!

KUSHËRIRI — Ku t'i gjeja edhe Rinës një burrë si ky! I themi Sofos?

KUSHËRIRA — Lëri budallaqet.

KRISA — Ku mbeti jot bijë?

TUSHKA — Pse pishën do t'i mbaj unë?

KRISA — Baba të thënçin!

TUSHKA — Qënkeni fshat i zhvilluar, krushku Risto!

RISTOJA — Nukë keq!

TUSHKA — E dija që Lajthiza është fshat i mirë, po s'ma merrte mendja të ishte kaq i zhvilluar.

SOFOJA — Fshat modern, me kafene, me vallëzime, me çupa të bukura! Qytet fare.

KRISA. — Eh..

SOFOJA — Ç'pate?

KRISA — S'më pëlqejnë këto gjëra, me mbrëmje, me vallëzime. Ne na duhej një nuse e urtë.

SOFOJA — Hajde, moj Salushe, të keqen e mendjes! Dhe duam t'ju emancipojmë!

Dalin. Hyjnë Stasi e Klodi.

STASI — Ku mbeti ajo?

KLODI — Kush?

STASI — Mariana

KLODI — Nuk e di.

STASI — Sa e errët qenka rruga!

KLODI — ?!

STASI — Kurse rruga e shtëpisë sonë është gjithë dritë.

KLODI — ?!

STASI — Llamba e shtyllës është karshi dritareve të dhomës së gjumit. Po të duash ti, unë mund të vë për natën një llambë të vogël me dhjetë qirinj, me transformator.

KLODI — Do ta presim Marianën?

STASI — Si të duash ti!

KLODI — E presim. Pse na la vetëm?

STASI — Mbeti me atë mësuesin. Si e ka emrin ai?

KLODI — Arian.

STASI — Më duket se ata.

KLODI — Çfarë?

STASI — E kanë... e kanë... mullukrepsur.

KLODI — Çfarë?

STASI — E... e kanë ujdisur.

KLODI — Mundet.

STASI — Po ti?

KLODI — Çfarë unë?

STASI — Hiç... desha të të pyesja diçka.

KLODI — Pyet!

STASI — Jo, u pendova . Do të ishte mungesë tak-ti nga ana ime.

KLODI — Çfarë?

STASI — Mungesë takti!

KLODI — (Bën sikur kupton.) Aha...

STASI — Domethënë... si të ta shpjegoj...

KLODI — E kuptova!

STASI — Shkojmë apo presim?

KLODI — Presim!

STASI — Më mirë të presim, sepse e di, mund të na shohë njeri dhe thotë pastaj «ja këta, që posa u fejuan dhe rrinë në errësirë.»

KLODI — Po ata ç'bëjnë? Pse u vonuan? Unë do t'i thérres...

STASI — Jo, s'është edukatë.

KLODI — Çfarë?

STASI — Ja de... të bërtasësh, ashtu siç deshe të bëje ti.

KLODI — Unë s'thashë se do të bërtas.

STASI — The!

KLODI — Jo!

STASI — Mirë, nuk the! (*Heshtje*) Shkojmë pak më tej, në dritë?

KLODI — Shkojmë.

STASI — Mund... të të zë përkrahu?

KLODI — (*E trembur*) Jo... pse?

STASI — Si të duash... (*Dalin. Pas tyre hyjnë Mariana dhe Ariani.*)

MARIANA — Mos u vonuam?

ARIANI — Le t'i lemë edhe pak të fejuarit.

MARIANA — Të fejuarit! I shkreti Stasi! Është i mençur, po këtu e ka humbur torruan fare.

ARIANI — Në situata të tilla, qdo njeri mund të bëhet qesharak. Janë vetë këto fejesa qesharake...

MARIANA — Nuk e kuptoj, si po rrrokulliset kjo fejesë kështu? Bëra ç'mos t'ia ktheja men-

djen Stasit, po ishte e pamundur. C'mund
të bëja më?

ARIANI — Nuk e di. Shpesh këto fejesa i pranoj-
më të gjithë në heshtje....

MARIANA — Ishte e kotë, Stasit nuk i kthehej
mendja!

ARIANIT — Hm... pse t'i kthehet? Ai vjen këtu
dhe e këput kumbullën nga dega.

MARIANA — Arian!
ARIANI — Në u prishtë kjo fejesë, këtë mund ta
bëjë vetëm Klodi!. Ne me të duhej të kishim
folur....

MARIANA — Ti beson se ajo do të prishet?

ARIANI — Unë pothuajse jam i sigurt. Po më i si-
gurt jam për një gjë tjetër.

MARIANA — Për çfarë?

ARIANI — Që mamaja jote do të zemërohet shumë
me ty dhe me mua!

Dalin.

Në mbrëmjen e vallëzimit. Sofoja dhe të tje-
rët kanë ardhur vonë dhe u ka mbetur një
tryezë e veçuar, në qoshe. Prapa një perdeje
tyli, duken çifte që vallëzojnë. Dëgjohet mu-
zikë vallëzimi.

KUSHËRIRI — Hë më na hëngërt mortja, ja! U von-
nuam! Kryetari e ka mbaruar fjalimin.

SOFOJA — E ç'prishi? Ne erdhëm për qejf, jo për
mbledhje.

KUSHËRIRI — Do të shpalleshin të dalluarit e fu-
shatës.

RISTOJA — Nuk u vonuam nga qejfi, ata e dinë.

SOFOJA — Për mua, më mirë se shpëtova nga dhembja e kokës.

STASI — Pse?

SOFOJA — Se kur dëgjoj fjalime, më ze koka!

STASI — Po ne, pse s'na zë koka kur dëgjojmë fjalimet e tua?

SOFOJA — Ore dhëndër... këtë gjuhë si brisk ta kishe vënë në punë aty ku duhej, jo më rrige si gërxhel, që as të ngroh as të ftoh!

Rregullohen në tryezë. Dëgjohet muzikë

TUSHKA — (Stasit, ulët) Ç'fat që pate, ore qerratuc! Shikoje! nuskën, shikoje!

MARIANA — Gëzuar, dajo Stasi!

STASI — (Si i zgjuar nga gjumi.) Gëzuar!

MARIANA — Nuk do të vallëzojmë?

STASI — Jo, se më shtrëngojnë këpucët.

MARIANA — (Ngrihet) Po marri Arianin atëherë.

KRISA — S'të durohet ty! Nuk pret të vijnë djemtë, po hidhesh vetë si....

MARIANA — Ç'rëndësi ka kjo, mama? (Largojet)

KUSHËRIRI — Çudi xhanëm, pse nuk vjen kryetari i kooperativës të urojë?

SOFOJA — Ç'na duhet ne?

DHOSI — Puna ia do të vijë, po atij nuk i pëlqejnë këto lloj fejesa.

SOFOJA — More! Nuk i pëlqekan!

RISTOJA — S'janë llafe këto! Ai e ka lënë të vijë në shtëpi, prandaj!

KUSHËRIRI — Me të dalluarit e fushatës ishte shpallur edhe Klodi.

TUSHKA — Bravo, nuse!

STASI — (Klodit, ulët) Kryetari të paska lëvduar shumë! Kaq shumë punon?

KLODI — Si gjithë shoqet.

STASI — Atje, tek unë... nuk do të punosh kaq. Do të çlodhesh!

KLODI — ?!

STASI — C'laajthi të mira që kishte pylli se!

KLODI — Ehë!

STASI — Të lënë të mbledhësh?

KLODI — Nuk e di.

STASI — E di sa vete kilja e lajthive dimrit?

KLODI — Ku ta di unë?

STASI — Tetë lekë!

KRISA — (Si papritur) Krushq të dashur, caktimi i datës së martesës, për palën tonë ka rëndësi të madhe!

RISTOJA — A? Pse ashtu?

KRISA — Nëna e ka taksur të bëjë dasmë të madhe, si qëmoti!

TUSHKA — E ka gjëzimin e parë që kur jemi martuar ne me Krisën.

KUSHËRIRA — Ka të drejtë! Kushedi sa vjet ka që pret dasmën e djalit.

KRISA (E prekur nga ironia e saj) U... se mos i iku mosha Stasit!

TUSHKA Është në lulen e moshës!

KRISA — Mund të priste edhe ca vjet, mirëpo nëna ka rënë shumë nga shëndeti dhe ne iu vumë: martohu, martohu...

TUSHKA — Do ta presim datën, krushku Risto?

RISTOJA — Më vonë! Ta bisedojmë me rrëthim familjar. Apo jo, kushëri?

SOFOJA — Duhet ta caktoni shpejt, them unë!
Dasmë e madhe kjo! Dy palë saze.
DHOSI — Pse nuk flet edhe dhëndri?
STASI — Si të vendosë familja!
KUSHËRIRI — Hë më të lumtë, ja!
DHOSI — Njeri me sedër tjetri!
KRISA — M'a bëre zemrën mal, Stas i motrës!
SOFOJA — Ngrejini gotat për këtë çift të zgjedhur dhe familjet e tyre!

Urime

STASI — (Klodit, ulët) Pse s'pini?
KLODI — Nuk dua!
STASI — Dukeni pa qejf...
KLODI — Më dhemb koka!
STASI — Do një aspirinë?
KLODI — Jo.
ZËRA — (Nga tryezat e tjera) Ej, Risto! Me trashëgim ore!
ZË TJETËR — Do të vijmë në shtëpi, se këtu mund të thuash e shkova radhën!
RISTOJA — Urdhëroni, hapur e kam! Falemin-derit, nga zemra!
ZË TJETËR — Orkestra! Merre vallen e nuses se do të kërcejë dhëndri i ri i fshatit!
STASI — (Sofos) Për mua thotë?
SOFOJA — Për ty, po, pér mua?
KUSHËRIRI — (Stasit) Do të ngrihem i në valle?
STASI — Jo, jo...
KRISA — Stasi, nuk i lot vallet popullore.
KUSHËRIRA — Gjynah!
ZËRA — Dhëndri, dhëndri!

SOFOJA — Do na falni, të dashur krushq, dhën-drit i është bërë një kallo nga këpuca. Po ja ku më keni mua! Ja kù po vij t'ia dredh një devollitçe bashkë me nusen! (Térheq Klodin me vete. Mbetet Stasi, Dhosi, Krisa dhe kushërrira.)

KUSHËRIRA — (Krisës) Vajza juaj s'paska hyrë në valle.

KRISA — Vërtet?

KUSHËRIRA — Ja ku po troket gotën me bërë me atë mësuesin.

KRISA — Domosdo! Janë shokë pune.

KUSHËRIRA — Kur do ta fejoni?

KRISA — Na ka hyrë Sofja për një doktor, por nuk po vendosim akoma.

KUSHËRIRA — Aha! Nuk të martohet me mble-séri ajo.

KRISA — E, krushkë e dashur, në fillim të gjitha ashtu bëjnë, sikur nuk duan mirëpo systë u lëshojnë xixa ama!

KUSHËRIRA — Jo, se këtu thonë sikur do të fe-johet me atë mësuesin.

KRISA — Bah! Ç'është ajo? Ata i lidh vetëm detyra.

KUSHËRIRA — Mundet, llafe janë këto.

KRISA — Bëjnë ca xhestë të papjekura këto, krushkë, prandaj hapan llafe.

(Pauzë) Të dijë gjë zlusja valle?

KUSHËRIRA — Përse?

KRISA — Për atë qështjen me mësuesin.

KUSHËRIRA — Kur të vijë, merre mënjanë dhe pyete.

-KRISA — Mirë më thua.
Në anën tjetër të tryezës

DHOSI — Ore Stasi! Ma 'rregullon një punë an-dej nga ndërmarrja jote?

STASI — Po ç'ne? Ti banon në fshat.

DHOSI — E kam hedhur grepin për në qytet edhe unë.

STASI — E si?

DHOSI — Sëfoja! Gojëmjalti! Më vdektë im atë po.

STASI — Nuk ju kuptoj.

DHOSI — E o derëbârdhë, do të më gjejë një nusse qytetarë. Si të jetë, s'kam shumë prendime, sa të fut këmbët në qytet.

STASI — Po dale se... Faktikisht kjo nuk më duket e drejtë.

DHOSI — Çfarë nuk të duket e drejtë?

STASI — (I zënë ngushtë) Ajo de, martesa që kërkon të bësh ti.

DHOSI — Jo more! Po kjo që bën ti, e drejtë të duket?

STASI — Faktikisht....

DHOSI — Ama, mendje që më paske! Na, gudulim-më pak që të qesh. Zotërinë tënde përsë po e merr Klodi? Mos kujton se i pëlqeu kjo tulla jote?

STASI — (I prekur) Të lutemi!

DHOSI — Për qytetin të merr ta dish; kurse ti faktikisht nuk është e drejtë». Ahu! (Ikën nga tryeza)

Vallëzimi mbaron. Kthehen të tjerët.

SOFOJA — (*Arianit, që ka ardhur bashkë me tifl.*)

Të lumshin këmbët! Paske qenë i yetmi për këtë valle. Do të të gjej një nuse të mirë.

ARIANI — I paske hyrë zanatit me gjoks!

MARIANA — Ohu! Po të mundej, do të martonte edhe papén e Romës!

SOFOJA — Sevap do të bëja! (*Qeshin*)

Fillon sërisht muzika e vallëzimit.

ARIANI — Vallëzojmë, Marianë?

MARIANA — Po! (*Cohen. Krisa i vështron e shqetësuar dhes e pakënaqur.*)

KUSHËRIRI — Po këto vallet bark më bark, a i lot dot, Sofo?

SOFOJA — A, jo! Janë me zarar për ne pleqtë ato! Jemi pleh i vjetër ne dhe, që ta dish, plehu i vjetër ndizet shpejt!

Ngrihet kushëriri e kushërirë.

RISTOJA — Nuk do të pimë edhe nga një birë, krushku Tushkë?

TUSHKA — Miku është budalla, krushk. Mua m'u tha gryka, prandaj sado kudo, mirë është të pimë edhe nga një. Dhe të falëminderit shumë.

RISTOJA — Të lutem! Për këtë gëzim që kemi sonte, kush kursen? Do t'i ve nën çezmë që të ftohen. (*Del*)

STASI — Këtu qenka bira e ngrohtë. (*Klodit*) Në «Turizmi» është akull!

KLODI — E di!

STASI — Ke qenë?

KLODI — Ehë! Vajtëm në maj, kur dhamë shfati qjen e festivalit folkloristik.

STASI — Vërtet? Dhe ç'bënët?

KLODI — Kënduam e lojtëm valle në podium, pastaj u kthyem në «Turizmi» dhe kërcyem.

STASI — Ah! (Pauzë) Ti... i paske qejf vallëzimet.

KLODI — I kam.

STASI — Unë jo dhe aq. Vërtiten aty si kali në lëmë e grisin këpucët!

KLODI — Nuk kërceni kurrë?

STASI — Jo... kërcej, po sëntë më ka vrarë këpuca. Por, që ta dish, unë edhe s'jam marrë me këto gjëra edhe aq qejf nuk i kam. Pse s'flet?

KLODI — È? Nuk e di...

Afröhët një djalë i ri.

DJALI — Me lejë, shoku dhëndër? Meqë nuk vallëzoni vetë, mund ta marr Klodin unë?

STASI — (I hutuar) Ta... ta merrni?

SOFOJA — (Ndërhyn) Natyrisht, mor i dashur, natyrisht! Vallëzoni!

STASI — Ju lutem, pos!

*Në tryezë mbeten Stasi, Sofoja, Tushka
dhe Krisa.*

STASI — (Tushkës) E dëgjove? Pëska kërcyer në podium e në «Turizmi»...

TUSHKA — Po, është e bukur, amë! Ëngjëllushkë!

STASI — Ehë!

SOFOJA — Vërtet të ka vrarë këpuca apo i ke dëngla? Kërce një herë me nusen.

STASI — Pse, paradë mode do të bëj unë? Të gjithë te unë do t'i mbajnë sytë.

KRISA — Mos kërce! Ç'na duhen këto kërcime ne?

TUSHKA — Të keqen e moshës, o Stas! Ah, të kisha qenë nga dhjetë vjet më i ri unë i ziu!

KRISA — (Stasit) Ç'të thoshte Dhosi ashtu?

STASI — Hic, ca budallallëqe!

KRISA — Mos ia var shumë, duket ai ç'karafil është.

STASI — Nuk ia vara.

KRISA — Po nuses, çfarë po i thoshe?

STASI — Asgjë, bisedojmë.

KRISA — Mos bësh ndonjë xhest të pamatur!

STASI — Pse, kalama jam unë?

SOFOJA — Dhe merre ndonjëherë fjalën në tryezë! Ti je dhe me shkollë, duhet të të përsë gjuha hekur.

STASI — Mirëpo këtu më është trashur dhe mezi e vërtit nëpër gojë.

TUSHKA — Ke të drejtë, të trashet pos! E ke nga mociioni i madh,

STASI — Nga emocioni, thuaj!

TUSHKA — Njëloj është. A e more vesh? E morre!

KRISA — Tregoji nuses për shtëpinë, për rehatin që do të ketë.

STASI — Kjo vete si mburje.

SOFOJA — E shesin lëkurën e gomarit për ari ca që janë byk fare, jo ti që je si do perëndia! Foli, ore foli!

STASI — E di sa e zorshme më duket qdo gjë,

Tushkë? Slikur po bëjmë teatro 'dhe ja... do të mbylljet perdja.

TUSHKA — Po lezeti aty është, prapa perdes, në errësirë, ku gudulisesh dhe këmbë e duar pleksen me dashuri!

KRISA — Leri këto zagarllëqe!

SOFOJA — Mirë që ka Tushka, nën trapezë, aty është bukuria e fejesave.

KRISA — Edhe ti, Stas, mos u huto kështu! Kë mbi kokë llogarinë e një ndërmarrjeje dhe nuk e humbet toruan. Këtu ç'pate?

STASI — Kollaj e dini ju?

SOFOJA — Thuaji që shpëtoi nga këzma, nga... (*Shikon Stasin që ka vënë kasketën*) More! Prapë e paske vënë atë drejt kaskete?

STASI — Ç'të ka hipur me kasketën time?

SOFOJA — Hiq menjëherë, hiq se jemi në balllo këtu! Hiq, se na more më qafë!

Stasi e hëq, e lëshon në karrigen e Klodit. Në planin e afërt duket Klodi duke vallëzuar me djalin.

STASI — (Tushkës, ulët). Sa afër paskan qëndruar!

TUSHKA — (Që është duke ngrënë) E? Kush?

STASI — Ata! (*Ia tregon me shenjë*)

TUSHKA — Aha! Epo, dans hesapi.

STASI — Dhe bisedojnë! Ç'thonë vallë?

TUSHKA — Pesë me hiç! Xhelozia, Staskë, të çartallos trurin! Mos u bëj mërak, se xhelozia e burrit për gruan vazhdon vetëm një vit. Ajo e gruas për burrin, po, ajo vazhdon tërë jetën.

KRISA — Mbylle!

SOFOJA — ...se, ta dish nga unë, disa gjëra të vogla nganjëherë bëhen sebep për prishjen e punëve.

STASI — Ti... përse?

SOFOJA — Për kasketën.

STASI — Aha! (*Thyhen lajthi dhe i hedh guas-kat në xhep.*)

KRISA — Mjaft me ato lajthi! Edhe qëparë të pashë që thyёje e i hidhje në xhep! Tu bë xhepi si torbë.

STASI — Shumë zgjati ky vallëzim!

SOFOJA — Në do që mës të djegë miza, ngrahu e kërce vetë.

STASI — (*I brengosur*) Sófo, si thua ti? Kaq djem të mirë ky fshat, pse pranoi ajo të fejohet me mua? Mos i kanë dalë gjë fjalë?

SOFOJA — Dëgjojeni tutkunin, dëgjojeni! Ti s'je në këtë botë, o derëzi! Këto të gjitha janë gati të martohen në qytet...

STASI — (*E ndërpret*) Ma ke thënë nja dhjetë herë këtë.

SOFOJA — Se dhjetë herë më ke pyetur!

Vallëzimi mbaron. Kthehet Klodi.

STASI — U lodhe?

KLODI — Jo.

STASI — Shumë e zgjatën këtë herë.

KLODI — Nuk e vura re.

STASI — I pasjellshëm ai djali! Pse nuk erdhi të falënderonte?

KLODI — Nuk e kemi zakon këtej.

Pauzë

STASI — Ama, kushedi sa të kanë zili shoqet ty!

KLODI — Pse?

STASI — Që do të martohesh në qytet. Faktikisht, shpëtove nga kazma.

KLODI — Jemi mësuar me punë, nuk na rëndon as kazma, as shata.

STASI — Epo... Faktikisht ka ndryshim të madh. Ta dish ti c'jetë do bësh aty të unë! Shtë-pia është e rehatshme, me ujë brënda. Instalova edhe banjë me vaskë e me dush. Dorezën e ka si telefon. Ke parë?

KLODI — Jo!

STASI — Le që ku do të shihje? Vetëm «Turizmi» ka të tillë. Pse s'flet?

KLODI — Se më dhemb koka! (Pauzë.)

KRISA — Nuse, xhan, eja dalim pak se kam një fjale.

STASI — Ç'e do?

SOFOJA — (Pëshpërit) Rri urtë, se nuk ta marrin. (Dalin Kriza e Klodi.) Ama për i shastisur që je, o, Stas!

STASI — Pse? Mos dukem për të qeshur?

SOFOJA — Me atë kasketë! Zhduke more në fund të dheut, të thashë!

STASI — Po kjo është e re fare! (E heq. Nuk di ku ta verë. E vë prapë në kokë.)

Kriza e Klodi, mënjanë.

KLODI — C'do të më thoni?

KRISA — Nuse, xhan! Mua më ke kuniten e loma-

dhe, më ke përditë të bardhë e të zezë se
u bëmë një familje tan!

KLODI — Këtë do të më thoshit?

KRISA — Mos u bëj e paduruar! Desha të të pye-
sja për... përvajzën time. Ajo kushëritai juaj
më hodhi ca miza për atë Arlanin, demede
kanë zënë dashuri me njëri-tjetrin. Të jetë
e vërtetë vallë?

KLODI — Nuk më kanë thënë gjë.

KRISA — Domosdo që s'të kanë thënë se dashu-
ritë nuk tregohen, po ti vetë nuk ke nuha-
tur gjësendi?

KLODI — Jo, por...

KRISA — Hë!

KLODI — Edhe sikur të dashurohen, ata e meri-
tojnë njëri-tjetrin,

KRISA — E meritojnë, a s'e meritojnë, atë e di
unë! (Pshérëtin) Ç'bombë më plasi mbi kō-
kë! Eja të ulemi!

STASI — (Kludit) Ç'të tha Krisa?

KLODI — Pse pyesni kaq shumë?

STASI — Si? Unë pse pyes? Po a nuk jemi të fe-
juar?

KLODI — (Pshérëtin) Po... të fejuar.

STASI — Atëherë?

KLODI — Më pyeti në dashurohen Mariana dhe
Ariani.

STASI — Po ti si i the?

KLODI — Nuk e di, i thashë.

STASI — Ama, ti e di!

KLODI — Edhe ju e dini, pse nuk ia thoni/vetë?

STASI — S'a them se ajo nuk do ta pëlqejë kë-

të dashuri. Ajo ka qejf doktorin e Sofos.
Do të mërzitet shumë.

KLODI — Çdo fejesë, disa i mërzit, disa i gjëzon.

STASI — Ç'deshët të thoshit me këtë?

KLODI — Asgjë! (Vjen një djalë tjetër dhe e merr për vallëzim)

STASI — (Tushkës) Hë... a nuk të thashë? Është më e djallëzuar sesa kujtoje ti.

TUSHKA — Po është e bukur, ama! Do të të kenë zili shokët! Toptan, të martuar e begarë.

Kthehet Ristoja me shishet dhe çifti i kushterinjve.

RISTOJA — Janë të ftohta këto, nga burimi! Kushteri, ngreje! Një ditë, dhëndri ma bëri kokën spathi me një raki të vjetër që kur e kujtoj, curg më venë jargët.

KUSHËRIRI — Hë më i lumtë, ja!

DHOSI — Bromp, dhëndër! Ahu si jam unë, o Stasi! Behar jam, s'mbaj inat fare, më vdekjtë im atë!

RISTOJA — Nuk ia dredhim edhe një valle, o Sozo? Ta porosit?

SOFOJA — Aman ore! Nga gazi i kësaj fejesë, mua më luajnë këmbët vetiu.

RISTOJA — Po ti, Stasi?

STASI — Mua... më shtrëngojnë këpucët!

KRISA — Stasi do të kërcejë në dasmë! (Muzika)

MARIANA — Këtë valle, sikur e ke qejf edhe ti, mama. Pse nuk ngrihesh?

KRISA — Se nuk më bën shpirti.

MARIANA — Dukesh e mërzitur.

KRISA — Nga fjalët e bukurat që dëgjoj për ty!

MARIANA — Njerëzit mund të flasin si të duan.

KRISA — Domethënë, nuk ke gjë me atë mëstuese sin?

MARIANA — Edhe sikur të kem, ç'të keqë ka?

KRISA — Ta dish, ditëshkurtër, dhëmbin kaq ta bësh, si të elefantit, ne me tët atë nuk do të pranojmë!

MARIANA — Pse flisni kur nuk e njihni fare?

KRISA — Sofoja të mbleséronte doktor Thimaqin që është specializuar për nervat.

MARIANA — Unë nuk vuaj nga nervat! Klodi, a dalim pak jashtë?

KLODI — Dalim! (Largohen)

STASI — S'ke ç'i bën kësaj pune, Krisë!

KRISA — Ku është Tushka? Hidhet në valle, i humbur, dhe m'i le mua të gjitha telashet. Duhet ta shkëputim prej tij, Stas!

Pëshpëritje, Errësim i sallës, Në paraskënë, Klodi e Mariana.

MARIANA — Klodi, pse je kështu? Ti, një vajzë kaq e gjallë, sonte s'flet fare!

KLODI — Nuk e di se si jam...

MARIANA — E kishe përfytyruar ndryshtë ditën e fejesës sate?

KLODI — Mundet.

MARIANA — Nuik kë dashuruuar kurrë, ndonjë djallë?

KLODI — (E trembur) Jo... Pse më pyet? Unë jam e vogël.

MARIANA — Si të duket Stasi?

KLODI — Nuk e di... Të gjithë për këtë fejesë po më flasin; shoqet, shokët.

MARIANA — Nuk ndien ndonjë çikë dashuri për të?

KLODI — Jol! Unë... nuk e kuptoj fare atë. Apo pëkështu u ndodh të gjithave?

MARIANA — Unë kam qënë kundër fejesës suaj. E di?

KLODI — Jo, pse?

MARIANA — Sepse ë dijë që do të mbeteshit të huaj për njëri-tjetrin.

KLODI — Ato kushërirat më thonin se të gjithave kështu u ndodh në fillim, pastaj mësohen. Kurse ti... ndryshe e ke ti. Ju dashuroheni!

MARIANA — Pse nuk dashurove edhe ti?

KLODI — Mua më fejuan pa filluar...

MARIANA — I doli së keqes përpara yt atë! Po ti vetë, pse pranove?

KLODI — Po ti, pse çuditesh, mësuese? Edhe mora ime kështu u martua. Babai tha «të kemi gjetur një djalë shumë të mirë, në qytet» dhe unë pranoja. Sa vajza janë martuar kështu, thashë më vete...

MARIANA — Po, ti ke të drejtë, s'duhet të çuditem. (Pauzë) Stasit ti i ke pëlqyer.

KLODI — E shoh! Po mua, pse më duket aq i huaj, vallë?

MARIANA — Sepse nuk të bëshkon asgjë më të. (Pauzë) Kurse ai... njihte një vajzë të mirë, ndoshita edhe e dashuronte atë.

KLODI — Pse nuk u fejua me të dhe të shpëtoja unë?

MARIANA — Nuk e lähë thashethemet. — IMA
KLODI — Marianë... ti je emirë. Thua jatiq të he-
që dorë nga unë!... At këtë shik. — IMA

Dalin, Po aty, Stasi dhe Arianë.

STASI — Pse më nxore jashtë? tu emir?

ARIANI — Të freskohemi. Brënda na u zuffryma?

STASI — Dëgjo! Unë i di të gjitha për ju.

ARIANI — Aq më mirë.

STASI — Mëtra nuk do të pranojë ta dinin.

ARIANI — Do ta bindni ju dhe ajo do të pranojë?

STASI — Unë?

ARIANI — Po, ju që e kuptioni dashurinë tonë, du-

het edhe ta bindni!

STASI — Këtë kërkonit nga unë?

ARIANI — Desha edhe t'ju largo, nga ajo tryezë

ku flitet vetëm për mblesëri të këqija.

STASI — Aha! Qënkeni edhe ju kundër fejesës si-

me! Nuk çuditem, xhanëm! Ata që dashuro-

hen kanë unitet mendimi.

ARIANI — Pse, ju vetë nuk keni dashuruar kurrrë?

STASI — Respektojeni pak distancën që na ndan,

djalosh. Faktikisht, do të martoheni me mbe-

sën time.

ARIANI — Pse i shëmangeni përgjigjet?

STASI — Sepse së shkuarës i vura kapakun?

ARIANI — Kaq i lumtur jeni?

STASI — S'thashë ashtu. Por jam i kënaqur. Nga

ajo, ngatë ardhmja e jone.

ARIANI — Po ajo, si është valle?

STASI — Gjare? Mos udini gjëserid?

ARIANI — Pse u shqetësuat?

STASI — Faktikisht... ju edhe mund t'ua them, më mundon një si brengë.

ARIANI — Këtë duhej ta prisje, përderisa nuk e njeh fare.

STASI — Mua më mundon pyetja, pse pranoj të mar-tohet me mua?

ARIANI — Pyeten Sofoni.

STASI — Sofoja në një vrimë i bie fyellit! Të shpëtojë nga kazma, thotë.

ARIANI — Kurse t'i e di që kjo s'është e vërtetë.

STASI — E di...

ARIANI — Këto vajza të marrin gjak në vetull për punë.

STASI — Po atëherë? Mos i kanë dalë gjë fjalë?

ARIANI — Jo,

STASI — Zakonisht këto nuk ia rrëfejnë atij që fe-johet, po ca gjëra të vogla, unë edhe mund t'i fal.

ARIANI — Pa u fejuar mirë dhe filluat të dyshoni e të bëheni xheloz?

STASI — Thonë se kur bën dashuri gruaja, i fun-dit që e merr vesh është burri.

ARIANI — Ti dyshon sepse nuk e njeh. Ajo s'ka asgjë të keqe. E keqe është vetëm mënyra sesi po bashkoheni ju të dy nga një njeri i tretë.

STASI — Kjo është e keqja më e vogël. Baraz me zero, mund të them. Më lehtësuat shpirtin. Ju falem ndërkit!

ARIANI — Nga dyshimet nuk ju shpëtoj dot, ama!

STASI — Unë të besoj ty! Tani, së shkuarës, ka-

pakun. Jam i lumtur! (*Afrohen Klodi dhe Mariana*) Po ju?

MARIANA — Shëtitëm pak edhe ne, si ju.

KLODI — Më mirë të i knim në shtëpi.

STASI — Kur të ngrihen edhe njerëzit e familjes.

Nuk bën të ikim pa ta.

MARIANA — (*Arianit*) Eja pak!

STASI — Ku do të veni?

MARIANA — (*Tregon një qoshe të errët*) Aty!

STASI — Po e bëni fora! Nuk ka lezet!

MARIANA — Këmi një bisedë sekrete, pse mërit zitesh ti?

STASI — Puna juaj! Mua kjo s'më pëlqen!

Të dy çiftet mbeten në skaje të skenës.

STASI — Ç'të tha Mariana?

KLODI — Pse më pyesni gjithmonë, sikur jam në polici?

STASI — Polici? Ç'hyn policia këtu? Unë kam të drejtë të të pyes sepse jeni e fejuara ime. Pyesni po të doni. Le që femrat nuk e kanë zakon t'i pyesin burrat.

KLODI — Ashtu?

STASI — Kështu thonë. Ju jeni e parrahur me jetën, shumë gjëra nuk i dinid po do t'jua më soj unë. Ja për shembull...

KLODI — Filluat që tanë?

STASI — E kam për detyrë. Përndryshe, si mund t'u krijohet një bashkim i harmonishëm midis nesh? Ishte fat i madhi që ti je e re kur se unë, i pjekur.

KLODI — Prandaj erdhët ju deri në fshatin tonë?

STASI — (I alarmtar) Jo, jo... më keqkuptuat. Por...
bazat e vendosjes së mirëkuptimit dhe harmonisë bashkëshortore...

KLODI — Dëgjoni, flisni thjesht po, të mundni.
Unë s'ju njihja, as ju nuk më njihnit. Na
fejoi Sofoja. Pas kësaj, a nuk të duket sikur
sonte, me ne të dy po qesh tërë fshati?

STASI — Qesh? Pse qesh? O, nuk ju kuptoj fare!

KLODI — Nuk e kuptoni që çdo gjë mbaroi ashtu
siç nisi, edhe për të qeshur edhe për të qarë?

STASI — Jo, në asnjë mënyrë. Prit, mos u nxito.
Asgjë nuk ka mbaruar, përkundrazi, tani fillojnë tërë të mirat. Mendohu mirë sonte!

KLODI — Është e kotë!

STASI — Mos...

*Befas, dalin me zhurmë nga salla Sofoja dhe
të tjerët.*

SOFOJA — Ja ku qenkan, pëllumbat e Sofos! Pas
kan, nisur t'i gujtin njëri-tjetrit mu, në go-
gnë jë! Gugugu, moj gugufju!

TUSHKA — Gilivili, gilivili!

KRISA — Lerini këto budallallëqe!

SOFOJA — Mos u skuq ashtu, Stasi! As ti, nuskë-

zë, se kështu e kanë këto punë!

TUSHKA — A nuk të thashë që lezeti, është prapa
perdes?

KLODI — Por unë...

STASI — (Ulët) Jo, mës fol, të lutem! Mendohu

sonte! Nesër! Bisedo me babanë, me mama-
në... Nesër!

KRISA — Po Mariana ku vajti?

STASI — Këtu krotull është, me atë mësuesin.
KRISA — Tushkë! Më hëngri gjarpëri! —
TUSHKA — Gjarpëri? Ku u gjend natën, more i
ligu? (Del duke thirrur.) Doktori! Infermieri!
Veterineri!

TABLOJA E TRETE

Mëngjes. Paraskenë, para shtëpisë së Ristos.
Dëgjohen këmborët e kopesë që posa ka ka-
luar. Sofoja, gati përrugë, me një shkop
në dorë, Kriza, Tushka dhe Stasi e Mariana.

STASI — E kam kokën të rëndë. Pothuajse s'kam
fjetur fare.

SOFOJA — A e di pse s'fjete? Se ndërrove mëny-
rën e jetesës, hyre në sérën e burrave. Kur
të martohesh, sa po, të zgjohesh, në mëngjes,
në vend të murit që ke parë deri tam, do të
shohësh një fytyrë engjëllushke!

TUSHKA — Dhe në vend që të shtrëngosh jastë-
kun, do të shtrëngosh...

KRISA — Pusho!

STASI — Nuq e kam nga pagjumësia, jo! Ju nuq
dini asgjë! Unë jam si ai që pret vendimin

e gjyqit. (Jashtë) — Ky është tension nervor, dajo!

MARIANA — Ky është tension nervor? Ja ç'është! grama, Tu-
shkë!

TUSHKA — Seç mban një erë kjo udhë... pëh!...

SOFOJA — Mban erë cjac. Kopeja paska ikur me kohë, po ja, era e cjacit ka mbetur.

KRISA — Hyjmë të përshtëndetemi e të ndahemi tan?

SOFOJA — Hyjmë! (*Shtyn portën*.)

KRISA — Mbyllur?

TUSHKA — Ç'kanë? Nuk u ka dalë gjumi akoma?

SOFOJA — Ore krushq! Zgjohuni more, jemi ne!

Heshtje.

TUSHKA — Pse s'përgjigjen? S'më pëlqen kjo heshtje.

KRISA — Sofo, ç'po ngjet?

SOFOJA — Ku ta di unë?

STASI — Faktikisht... këtë e di vetëm unë!

SOFOJA — Ti? Ti s'di asgjë!

KRISA — Mos u zemëruan meqë nuk ndenjëm për të fjetur në shtëpinë e tyre?

SOFOJA — Jo mo, ç'ne! Muaj m'u lut Ristoja vëtë që t'ju irregullojë në hotel së janë ngushtë.

TUSHKA — (*Trokët*) S'dihet si mund ta kenë zakonin. Mund ta duan më të trokitur! (*Trokët prapë*) O krushq! Po jemi n'e more, hapeni!

Heshtje.

KRISA — Nuk përgjigjen! (*Nxehet*) Turp të keni!

SOFOJA — Shëet! Dëgjohen hapë në oborr! Po vijnë!

Hapet pak porta dhe del Sulla.

SULLA — Sofo! Eja pak, më tha Ristoja.

KRISA Pse?

SOFOJA — Mbani gjakftohtësinë. Dreqi e di ç'ka ndodhur këtu. Mos u shqetësoni, e zgjih unë lëmshin. (*Hyn brenda*)

MARIANA — Eja të ulëmi aty te ledhi, dajo!

TUSHKA — Sado kudo, paskan ca zakone që të trembin.

MARIANA — Dajo, mos u shqetëso, odo gjë do të imbarojë mirë.

KRISÄ — Po ai lajkaxhiu, Sofoja, pse po vonohet?

Zëra të mybytur nga brenda.

STASI — Shëët! Dëgjoni gjë ju? Ç'thonë?

KRISA — Shamatë bëjnë, po s'kuuptoj asgjë!

TUSHKA — Mbaj vesh te porta, ti Marianë!

MARIANA — A, baba! Që të më kapin duke përgjuar, thua ti?

TUSHKA — Au, èdhe ti...

KRISA — Kjo... kjo që na i bëri gjakun arme me fshehuriçkat e saj, si i ati!

TUSHKA — Sado kudo... të lutem shumë, domëthënë!

Del Sofoja, i përcjellë nga Sulla.

SOFOJA — (*Bërtet*) Këto janë turpe të padëgjuara, Risto, turpe!

SULLA — Nuk do, ditëshkurtra, nuk do! Ne jemi nxirë e thëngjillosur nga e keqja.

SOFOJA — Dhe dil këtu në shesh të burrave, Risto, mos dërgo gruan.

SULLA — Ka turp t'i dalë përparrë Stasit. U zhuravlit i ziu Risto!

STASI — Si është çështja më në fund? Fol!

SOFOJA — Akoma ti? Na qenka bërë pishman tjetra!

STASI — Këtë... e prisja.

KRISA — C'janë këto bomba që më bien njëra pas tjetrës? C'është ky fat i gremisur?

STASI — Ja, kjo ngjarje ishte me të vërtetë tragjike!

KRISA — Tragjike!

SOFOJA — Mos u nxitonni, xhanëm! Vetëm çupa nuk do, pa familja është dakord. Ja të shohim ç'përfundim do të japë presioni që u bëra.

STASI — Më mirë të mos kishtë nisur fare e 'gjitha kjo...

SOFOJA — Po ti, pse nuk na rrëfeve që mbrëmë për atë bisedë që ke bërë?

STASI — Ishte punë për mua. Do të bëj njëherë sipas kokës sime unë apo vetëm sipas suatjës?

SOFOJA — Sipas kokës sate! Zaten ajo koka jo te të mori në qafë, se të thashë njëqind herë për atë dreq kasketë, ta futje në fund të dheut. Kurse ti, ma ngjeshje në kokë dhe dukeshe si e premte e zezë.

MARIANA — Nuk e ka fajin kasketa, jo!

SOFOJA — A, edhe ti rol të bëkurr kë luajtûr! Atë që ne ndreqëm ditën, ti na i prishe natën!

MARIANA — Uhë as ndërtova, as prisha gjë. Të

... gjitha i bëtë ju që kurdisët këtë fejesë. Kurse tani na dërdëllit përkësketën! Kapeni si ai i mbyturi pas një fitje barishtë!

SOFOJA — Skupton gjë nga bota; ti çupësi! Në prishjen e kësaj fejese, rolin kryesor e lojtarit kasketa se ajo e trëgonte Stasin ftytyrë vrerosur. Surrat akshami e trëgonte!

STASI — Mjaft! S'dua të dëgjoj më asgjë! Të ikim!

SOFOJA — Prit sa, të mbarojë afati i ultimatumit!

STASI — Më lini të qetë, nuk dua të dëgjoj më asgjë!

KRISA — Prit, të keqen motra! Do zoti e ia kthej në mendjen! Këto të voglat nga mosha, kështu e kanë, shpejt kandisen, shpejt bëhen pishman.

SOFOJA — (Trokët në kanatin e dritares me stëpin e tij.) E moj? U mejtuat apo jo?

KRISA — C'thonë?

SOFOJA — Heshtin!

STASI — Ja si u bëka njeriu qesharak! Të ikimi! Faktikisht, edhe për mua kjo fejë ka mbaruar!

MARIANA — Mos u dëshpëro, dajo! Më mirë që mbaroi kështu. Ju ishit të huaj për njëri-tjetrin.

STASI — Po ai... djali, Ariani, ku 'eshtë?

MARIANA — Tani duhet të vijë.

SOFOJA — Qetësi! Po, dalin! (Del Ristoja e Sulës.)

RISTOJA — Na falni! Më tijen kaq rëndë, sa si-

kur kám çatinë mbi kokël! Po me pahir...
nułk u békérka gjë!

SULLA — U thëngjillosem!

SOFOJA — I ratë së mirës me shqelm! S'jeni
dhëndër si ky!

RISTOJA — E dimë! Na cërrit zemra, po hë?

SOFOJA — Nuk ju vjen më fat si ky në derë!
I vetëm, shef, shtëpi!

SULLA — Na thëngjillosi kjo çupë!

SOFOJA — Do t'ju mbetet në derë me njollën
«ndarë nga i fejuari».

KRISA — Do t'ju mbetet! E fejuar ka qenë
vërtet!

SOFOJA — Fejesën e dinë të gjithë, ajo ishte
fakt i kryer!

TUSHKA — More i kryer dhe prapa perdes po të
duash, po hë!

SOFOJA — Kush do t'jua zerë për bishti atë vaj-
zë të ndarë?

RISTOJA — Eh...

SULLA — Eh...

SOFOJA — Po sikur ta shtynim ca?

RISTOJA — Si?

SOFOJA — Domethënë, ta mbajmë të fshehtë
prishjen, derisa t'ia ktheni mendjen!

STASI — Mjaft më! Po flişni marrëzira! U iku
koha fejesave me pahir!

KRISA — Na sillni nishanet dhe dhuratat!

Ristoja, Sulla dhe Sofoja hyjnë brënda.

STASI — Faktikisht...

KRISA — Sa lekë e darovite nusen në dhisk?

STASI — Sa më zuri dora! Se tre, se katër mijë!

KRISA — I humbur! Mund të t'i bëjnë hasha ndonjë mijë lekë tan!

STASI — Le të bëjnë q'të duan! Unë dua vetëm të iki dhe të mos e shoh më kurrë këtë fshat!

TUSHKA — More... si u bë kështu, ë? A e dini që i doli?

KRISA — C' thua ti, more?

TUSHKA — I doli, dreqit, i doli!

KRISA — I doli... i doli! C' janë këto llomotitje? Nxirre!

TUSHKA — Atij deh, shoferit! Nuk na tha «do vini pér lesh dhe do të ktheheni të qethur?»

KRISA — Mbylle!

SOFOJA — (*Del me dhuratat.*) Zemrat të gëzuara! Merrini dhe ruajini! Nishanet do të na duhen prapë. Në krye të javës, të gjen vëllai ty, një më të mirë, jo si kjo që qe si arapshe!

MARIANA — Me Stasin nuk ke më punë ti! Peshko ndonjë dhëndër tjetër deri sa të të shkojë kali mbi urë, po ki mendjen se do thyesh qafën!

SOFOJA — Mjerë ai që do t'i zesh derën, çupë!... Ika unë! Ka të tjerë që më duan e më kujtonë! (*Largo het pa zhurmë*) Hyn Ariani, kur janë duke u nisur.

ARIANI — Po ikni?

STASI — Po... E morët vesh?

ARIANI — E prisja. Ishte e natyrshme dhe e drejtë.

KRISA — Ashtu? Po që t'i hapen fjalë çupës sime, e drejtë ju duket?

MARIANA — Mama!

STASI — Motëri, e kësot! Dashurisë nuk i vë dot frerë. Mblesëri, po!

KRISA — Kurrë! Nuk ju jap lejën kurrë! Fol, Tushkë.

TUSHKA — Ç'të them dhe ti, Krisë? Sado, kudo e tha Stasi atë të frerëve. Dhe ti, mor djalë, mos e zgjat! Duku andej nga shtëpia! Kemi shtëpi ne!

KRISA — Obobo! Të gjithë janë kundër meje!

Obobo! Po Sofoja? Ku është? Pse iku? Na, Sofo!

MARIANA — Në dreq të vejë, mama! Ai dhe gjithë soji i mblesëve.

KRISA — Ai nuk ishte mbles! Ai ishte njeri i mirë e i dhembshur, ai nuk pranonte ta thërrisje mbles!

ARIANI — Njëlloj janë, si qeni i bardhë si ai i murë, të dy bushtra e zezë i ka bërë!

Heshtje. Nisen.

KRISA — (E merr veten.) Përvish dy herë pantallonat, Stas! Vër një shami nën jalkën e këmishës! Dhe të ikim!

TUSHKA — Të ikim! Pas meje!

EPILOG

Paräskënë, para shtëpisë së Stasit. Në rrugicë,
Stasi dhe Shpresa.

STASI — Mirëmbrëma, Shpresa!

SHPRESA — O! Mirëmbrëma Stasi! Kaq vohë son-
te? E shtunë, dita kur lajnë kokën... - ja?

STASI — E prish dhe unë nganjëherë irregullin.

Vajta në teatër. Ishte ajo komëdia. E'de, ajo
për "nusen e..."

SHPRESA — Dhe s'i t'u duk?

STASI — Jo dha q keq xhanëm, mirëpo kam një
vërejtje serioze!

SHPRESA — Për kë?

STASI — Për autorin! Ja ta zëmë, ti thuash, mo-
re autor, se njeriu vajti aty afër të dyzetave,
të themi, a s'ka mundësi ky njeri, t'i thuash,
more autor, që të ketë një Shpresë?

SHPRESA — Një shpresë?

STASI — Që të gjejë një vajzë të mirë... aty rro-
tull të tridhetave dhe ta njohë, dhe ta da-
shurojë... Nuk kam të drejtë?

SHPRESA — Siç duket autori nuk e ka vrarë me-
ndjen për këtë derisa e lë në mes të rrugëve!

STASI — Do jetë martuar me kohë pér vete, qerra-
tai. Faktikisht, e ka vënë kasketën mbi sy! Po
jo, mör firaun, t'i thuash, se nuk e njeh
jetën siç duhet... domethënë realitetin objek-
tiv, dua të them. Ai personazhi yt mund të
ketë edhe një zgjidhje tjetër.

SHPRESA — Mund apo duhet?

STASI — Ai duhet të ketë një Shpresë. Vetëm një,
me Sh të madhe! (*I jep krahun.*)

SHPRESA — Pa shiko! Paska dalë nëna jote në
ballkon!

STASI — Edhe Tushka... o, dhe Krisa, Mariana,
Ariani! Qenkan të gjithë! Ç'presin vallë?

SHPRESA — Ku ta di unë?

STASI — Ta marrë e mira... Po, faktikisht, sikur nuk
ka lezet me kaq shumë spektatorë pa!...
(*Përqafohen.*)

F U N D

ТУНДАКОВАЯ

ТАКИЕ ВРЕМЯ

СЕНО КОХНО - магниты для танцев

ТАНДА - я сижу в краю

АНДЫ СИДИ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю
все сидят в последней части - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

СИДЯ В ПОСЛЕДНЕЙ ЧАСТИ - я сижу в краю

SHI NË PLAZH

komedi

диско в краю сидят сидят сидят сидят

BANDA - по МИЛУ, за ЛАЛО

P E R S O N A Z H E T

ZENO XHIXHOJA — mësues afër pensionit

LAJDJA — e motra, pak më e re

ALBERTI — i nipi, rrëth njëzet e shtatë vjeç

MILO TAFANI — mjeshtër mekanik, afër të pesëdhjetave

IZMINI — e shoqja, rrëth dyzet e pesë vjeç

JETA — vajza e tyre, njëzet vjeç

ÇOMJA — pensionist

SANDA — e shoqja

LILI — mbesa e Çomes

ibetorë

Ngjarjet ndodhin gjatë disa ditëve, në plazh.

TABLOJA E PARE

Dy kabina fqinjë, në plazh, me verandë pérpara. Në njérën verandë Sanda rregullon tryezën pér darkë. Çomja del nga kabina, duke ecur si i ngrirë, ngaqë është djegur në diell. Sanda e lëndon pa dashur.

ÇOMJA — Oo! Oo!

SANDA — Më rëntë një pikë, më rëntë. Të lëndova shumë?

ÇOMJA — (Ulet duke rënkuar.) Obobo! Mbarova!
Lavë! Vulkani gjallë.

SANDA — Më fal!

ÇOMJA — Ç'të të fal, ç'të të katranos!

SANDA — Sonte do të të lyej me kos.

ÇOMJA — Pëh, ç'mërzi! Më doli pér hundësh ky plazh. Mbushur kabinat me rini! Ftuja dhe ftujakë! Xhuxhuxhu këtej, xhuxhuxhu andej, më kë shpirt, të kam xhan! S'ke me kë të këmbesh dy fjalë. Si e kishte emrin ai burret? që lojtëm shah në rërë?

SANDA — Se Milo, se Lilo.

ÇOMJA — Shiko e ma gjej. Ftoje pér një vizitë
se u bëra derr.

SANDA — U, llaaf ky! Të ftoj burrin e botës pa
e njojur mirë!

ÇOMJA — O moj derdimene se s'bëhet njeri xhe-
loz pér ty, jo. (*Sanda lëviz dhe e lëndon
prapë.*) Aa! Shpirtkazmë! (*Zëri i shuhet se
para kabinave duken Zenoja, Lajdja dhe
Alberti me valixhe e çanta. Çomja e ndalon
Sandën duke e kapur pas mësalle.*) Shiko!
Komshinj më duket! Dhe me qitharë! O,
ç'fat!

ZENOJA — Mirëmbërëma! Kabina njëzet e tetë?

ÇOMJA — Njëzet e teta. Mirëmbërëma!

ZENOJA — Atëherë njëzet e shtata është kjo! S'e
luan topi. Lerini valixhet. (*Nga Çomja.*) Të
njihemi: Zeno Xhixho, pedagog, motra, nipi.

ÇOMJA — Gëzohem, jashtëzakonisht gëzohem.
Ah, ç'fat! Dy ditë kabinë bosh, mua atje
mendja. Ishalla vjen ndonjë moshatari im,
ishalla! Kur të mos kem njeri. Se këtu, ane-
mbanë rini, çifte të lumtura, dorë pér do-
re, xhuxhuxhu, pëshpëshpësh, më do, të dua...

ZENOJA — Me kë kam nderin?...

ÇOMJA — Thoma Çakshiri, shkurt Çome. Kasap
në pension.

ZENOJA — Të rrijë pak motra me ju. Ne me Al-
bertin po shkojmë të marrim çelësat, pajis-
jet. Albert, Albert! Ku vajti ky djalë?

ÇOMJA — Po u vjen vërdallë kabinave. Rini he-
sapi, e shpon elbi.

ZENOJA — Elbi? Pér ç'elb e keni fjalën?

ÇOMJA — Ajo de, xhuxhuxhuja, më do, të dua, profesor!

ZENOJA — (Si i fyter) Nipi im nuk është aventurer, sa për dijeni. (Del) Albert!

ÇOMJA — Qenka zevzek profesori! (Vëren Lajdjen)
Ah, zonjë, urdhëroni, uluni këtu! (Lëndohet pa dashur.) O, s'ka gjë! Djegie! E shkallës së dytë. Sandë! Dil moj, ku humbe! Njihu me komishnjëtë. Rrini, çani llaf tanë. Mua më ndjeni, do të shtrihem se më hipën ca si ethe. (Hyn në kabinë.)

Gratë mbeten disa çaste në heshtje.

SANDA — U, më rëntë pika! T'ju bëja një kafe.

LAJDJA — Faleminderit, ma ka ndaluar doktori.

SANDA — Atëherë një liko prej imoniku! (Çomja rënkon)

LAJDJA — Burri juaj rënkon ashtu?

SANDA — Thomai po kush! Rënkon sa të këput shpirtin. Është djegur e bërë lulekuqe. Llatharisi plazhin.

LAJDJA — Kaq shpejt? Siç duket e ka lëkurën të paregjur. Keni kohë që s'keni qenë në plazh?

SANDA — Ka, ahu, s'mbahet mend qëkur, (Ulët) Kishim vjehrën të dëmbllosur. Dhjetë vjet, kérçu! Të mirë të ligë, në krevat! Merre me mend! Ta kujtosh e të përzihet.

LAJDJA — Paskeni vuajtur!

SANDA — Lëre, lëre! Motmot, shpëtoi nga hallet, e gjora. I bëmë të ndarën sipas zakonit dhe i thashë Thomait: hajde, Thoma, të vemi në

plazh të na moskovolisë era e jodhjos, se zume myk! Hajde, grua, më tha dhe u nisëm ashtu, arramara. Po ju?

LAJDJA — Vëllai vjen për vit, unë jo se në diell më enjten këmbët. Mirëpo sivjet Zenoja m'u bë rrodhë: duhet të vemi familjarisht, thoshte, të mblidhemi aty dhe ta qajmë...

SANDA — Ta qani?...

LAJDJA — E... e kemi një hall ashtu.

SANDA — Ç'hall?

LAJDJA — Slikur po rënkon burri juaj.

SANDA — Le të rënkojë, po hë!

LAJDJA — (E zënë ngushtë.) Ja... kemi merakun e djaliit, të Albertit.

SANDA — U, plastë syri i lig! Djali si flori! Pse, ç'ka?

LAJDJA — Se mos e zë në gojë me njeri, të keqen!

SANDA — Llaf e ke? Të kam si motër.

LAJDJA — Zenoja thotë se duhet ta mbajmë të fshehtë!

SANDA — Ta mbani! Llafet e shtëpisë s'janë për në pazar!

LAJDJA — Na thanë se i ka lidhur telat me një... aktore teatri.

SANDA — Ka ndonjë cen çupa?

LAJDJA — S'dimë gjë. Zenoja s'do t'uadëgjojë emrin aktoreve. S'janë serioze thotë, teatro bëjnë në skenë, teatro dhe në jetë.

SANDA — Si ia thoshin emrin?

LAJDJA — As emrin i dimë, as familjen. Jemi larg.

SANDA — Po kështu nga kashta?

LAJDJA — Kush e pa? E bukur do të jetë, se ato pilkérëna të bukura i zgjedhin, po për ne s'bën...

Vjen Zenoja me Albertin. Zenoja ka një legen plastik që e pengon. Alberti e merr dhe e vë mbi kokë. Zenoja ia heq, duke e parë me qortim.

LAJDJA — Të keqen motra, se mos!

SANDA — Zëre se ke folur me vete!

Familja Xhixho hyn në kabinë. Del Çomja.

ÇOMJA — S'qëndroj dot, as shtrirë, as ndenjur, as më këmbë! Më vjen të sulem në det!

SANDA — Mos fol si axhami! Dëgjo, dëgjo ç'mora vesh?

ÇOMJA — Tutje, bëju def! Aa, ç'ke?

SANDA — (Bën shenja nga kabina fqinjë.) Ta them brenda, po hë!

ÇOMJA — Vër peshqit në tigan dhë mos më çukullit veshët, atë bëj!

Merr mandolinën. Fqinjët hyjnë e dalin duke rregulluar kabinën. Çomja këndon nën zë «Që më një të Kollozhekut. Ç'u formua shoqëria». Heton me cepin e syrit në se fqinjët e vënë re apo jo. Zenoja afrohet te parmaku midis verandave. Bubullimë e largët.

ZENOJA — Sirenë vatori kjo.

ÇOMJA — Ç'sirenë! Gjëmon moti!

ZENOJA — Prognoza qe për mot të mirë. Vra-nësira të lehta në kalim.

ÇOMJA — Atëherë prit shira.

ZENOJA — Nëse s'duam të na quajnë konservatorë, le të çmojmë shkencën.

ÇOMJA — Pa shiko si shkrepëtin? Pyet për shkencë ajo?

ZENOJA — Është fari që ndizet e shuhet...

ÇOMJA — (E shkund nga supi.) O profesor! (Zenoja kthehet.) Bëjmë një copkë?

ZENOJA — Co... copkë! Si copkë?

ÇOMJA — Një pjeskë... pjesë të vogël për mandolinë e qitharë. Një mazhurkë, ta zëmë. Ti e lot ca qitharën, apo jo?

ZENOJA — Dikur po, tani i bie nipi. Mua s'më ka hije.

ÇOMJA — S'ju ka hije? Po pse?

ZENOJA — Ç'do moshë ka të vetat. Nëse duam të dukemi seriozë, le të veprojmë seriozisht.

ÇOMJA — Seriozisht... (E lë mandolinën, pa e merr prapë vendosmërisht.) Seriozisht. Kori karakteristik, pleqtë e Krujës, të Beratit. Hm. Seriozisht!

Del Sanda me kafetë.

SANDA — Urdhëroni! Kafë pûrë.

ZENOJA — O! Faleminderit shumë, zonjë! (Kapercen parmakun.) Kafeja është dobësia ime.

ÇOMJA — (Me vete.) Parmakun ma hedh si pehlivan!... Hm... seriozisht! (Ulet duke rënkuar.) Asgjë... djegie e shkallës së dytë.

ALBERTI — (Del me kitarën.) Dajë Zeno! Ünë po dal nga brëgu. Kam ca shokë në «Tûrizmi».

ZENOJA — Mos u vono! Jemi të lodhur!

ÇOMJA — E, të lodhur! Lodhen ata?

ZENOJA — Të tjerët jo mbasë, por ai... ai lodhet!
Ai merret me shkencë!

ÇOMJA — Me shkencë! O!?

ZENOJA — Me fizikë! Profesor Morava thotë se Alberi është një nga yjet e reja të shkencës sonë. (Endërrues.) Ah!... I hapet shpirti një riut kur shikon filizin që e ka rritur vëtë!

ÇOMJA — Vetë, Domethënë si... vetë?

ZENOJA — I ati, i mjeri, vdiq shpejt. Motra nuk u martua më. (Ndërron bisedë.) Thua j si të duash, po në jetë ka disa profecira që përmbushen. Për shembull, unë ngula këmbë që djalit t'i vinim emrin Alber, për nder të Ajnshtajnit. Ti e ke dëgjuar Ajnshtajnin, apo jo?

ÇOMJA — Ai i bëmës!

ZENOJA — Jo tamam, po nejse, do të kem rast të të flas edhe pér Ajnshtajnin.

ÇOMJA — Tani që po na prishet koha...

ZENOJA — Burri i motrës ishte njeri i butë, prekej nga lotët. Burri që preket nga lotët, s'është burrë. Slikur të mos e kisha marrë vetë në dorë edukimin e këtij djali, s'di ç'do të bëhej me të.

ÇOMJA — I zoti del vetë mbi ujë, xhanëm...

ZENOJA — Gabim! Duhet nxjerrë! Rinia, i dashur Çakshiri, është... është e brishtë si ai lastari i hardhisë. Shtrak... dhe këputet. Në-

se duam që të dalë mbi ujë, duhet ta udhëheqim, ta mbajmë për dore hap pas hapi. Por këtë s'mund ta bëjë çdokush. Unë... i kushtova jetën time dhe ja, ai doli mbi ujë.

ÇOMJA — Epo, si lum ti. Xhanëm edhe unë vëtë... jo kaq shumë, po s'duhet të qahem. Djemtë i kam të mbarë, punëtorë... I fejuar arështë?

ZENOJA — (*Disi i alarmuar.*) I fejuar? Jo, kurrësesi.

ÇOMJA — Goxha djalë ky Alberti!

ZENOJA — Alber! Pa «t» si në frëngjisht. Ti, di frëngjisht?

ÇOMJA — È... Hëm... Pak çobançe. Kisha dëgjuar se këta shkencëtarët janë pak si humbamen. (*Protesta të Zenos.*) Jo, më ndje, përlafin profesor, se nipi yt, Alberti, ndryshe fare! Qitharën në krah dhe yha... në breg të detit.

ZENOJA — (*Si me vete.*) Ajo kitara... Ah, ajo kitara! I vetmi gabim imi!

ÇOMJA — Qithara gabim? Nuk e pranoj! Nuk e pranoj dhe pikë!

ZENOJA — Se nuk di gjë, prandaj...

ÇOMJA — Po, hë?

ZENOJA — Ah, lere...

ÇOMJA — Meqë ra llafi...

ZENOJA — (*Pas një hezitimi.*) Se mos i thua gjë gruas!

ÇOMJA — Bah! Zëre se po llafos me vete.

ZENOJA — Motra nuk do që të na dalë sekreti.

ÇOMJA — Nga unë s'del! Unë jam vetë si sekret...

ZENOJA — Ai po më rrëshqet nga dora.

ÇOMJA — Po si? Qysh? Tek?...

ZENOJA — Pandehja se u poq. Kurse tani, tani kur ai duhet të bëjë atë 'hapin e madh të jetës, hapin fatal...

Duket Miloja me kutinë e tavllës.

MILOJA — Mirëmbrëma! Mirë u ngrysët?

ÇOMJA — O! Lilo! Urdhëro, Lilo, urdhëro! Eja të të njoh me profesorin.

MILOJA — Milo...

ZENOJA — Zeno Xhixho, pedagog.

MILOJA — (Çomes.) Mora vesh që je djegur dhe erdha të bëjmë një tavllë.

ÇOMJA — Tavllë s'di...

MILOJA — Të mësoj unë për një orë. Mos din ni juve?

ZENOJA — Sigurisht që di! Pjetje është kjo?

ÇOMJA — Kemi kohë për tavillën, ulu njëherë të bëjmë cazë muhabbet. Shyqyr që u mblo-dhëm tre pleq, më falni tre burra në mes të këtyre ftujakëve. (Zenos) Ku e lamë? A, po! Te ai hapi fatal.

ZENOJA — (I pakënaqur) Të luajmë tavllë më mirë.

ÇOMJA — Po bisedonim për... martesën e...

ZENOJA — (E ndërpret duke e ndukur pak, Çomja rënkon.) Për martesën e njeriut në përgjithësi. Problem i madh, mik i dashur. Kyçi i jetës. Jeta e njeriut, tre momente të më-

dha. ka: lindja, martesa dhe vdekja. Lindja e vdekja s'janë në dorën tonë. Pra q'na mbetet? Mbetet të themi se jeta e vërtetë e njeriut është martesa. Një martesë e dështuar, është një dramë e pafund...

ÇOMJA — (Psherëtin) Ja për këtë po flisnim, Lillo! Gjëra fillozofike!

MILOJA — Eee, po ta vriste mendjen kaq thellë njeriu, nuk martohej kurrë. Këto i mendojmë kur na ikën mosha. Nisuni nga vetja juaj. A do të ishit martuar sikur të arsyeton si tani?

ZENOJA — (I turbulluar) Kush, unë?

MILOJA — E, ju!

ZENOJA — Hm... nejse, puma ime është pak ndryshe...

ÇOMJA — (Kureshtar si gjithnjë.) Si ndryshe? Pse ndryshe?

ZENOJA — Unë në përgjithësi... nuk jam martuar.

ÇOMJA — Domethënë... Si? Hiç? Hiç fare?

ZENOJA — (Pak i fyter) Kurre!

MILOJA — Na falni. Nuk e dinim.

ÇOMJA — Kur të mos kem njeri, nuk e dinim. (Pas një pauze) Po ne harruam tavllën more! Harruam ndeshjen! Profesor, do të luani?

ZENOJA — Me kënaqësi. (Fillojnë të luajnë, Kalon Jeta.)

JETA — Mirëmbërëma! (Zenoja e shikon me kureshtje.) Baba, darka është gati pas gjysmë ore,

MILOJA — Në rregull Mund tē vonohem pak.
Vazhdojnē tē luajnē. Zérat *dëgjohen herë pas here.*

* * *

*Qoshku i pijeve freskuese, nën strehë.
Pranë, një stol. Alberti e Jeta takohen.*

ALBERTI — Tē kërkova gjithandej. Trë herë i
rashë bregut nga «Iliria» te «Teuta».

JETA — Duke kënduar?

ALBERTI — Kitarën e mora që tē mos më ngatë-
rroje me ndonjë tjeter. (*I bie lehtas, këndon
dy vargje.*) «Ç'po thonë për ne ashtu /Dall-
gët e detit që vijnë këtu».

JETA — Sa tē kam pritur! Cdo gjysmë ore ngri-
hesha nga rëra dhe vrapi tek kabinë juaj.
Ajo, bosh...

ALBERTI — Na vónoi nëna. Mezi ia mbushëm
mendjen tē vinte.

JETA — Po daja?

ALBERTI — Tē varej prej tij, ne do ta çëlinim
plazhin cdo vit.

JETA — Kisha déshirë ta shihja nënën tënde, po
në verandë skishte njeri.

ALBERTI — Pse nuk i thirre që tē dilte?

JETA — (Lozanjare) Si? Me c'emer?

ALBERTI — O zonja Lajde! O kandidate për
vjetërr! (Këndon) «Dill, moj vjetërr, dil
ç'të sjell yt bir!. Një thëllëzë mali...».

JETA — Aktore teatri! (*Albertit*) Ti qesh, po mua
më dridhen gjunjët. Sikur të dilte dajë Zenoja e
të më shihte ashtu të hutuar para kabinës?

ALBERTI — Ai s'të njeh. As ti nuk e njeh.

JETA — Aty éshëtë e keqja, as më njeh e as më
do, unë e dua, ai s'më do!

ALBERTI — Diku rrrotull duhej të ishte. Ndoshata
te kabina fqinjë, te 28-ta.

JETA — Te 28-ta?

ALBERTI — Zuri muhabet me një burrë aty.

JETA — Mos pi duhan me llullë ky dajë Zenoja?

ALBERTI — Llulla éshëtë emblema e tij.

JETA — Obobo! E mjera unë! Ah, sa ters po na
shkon! Obobo!

ALBERTI — Ç'pate? Ishe mirë deri tani!

JETA — Ai... ai po loste tavillë me babanë.

ALBERTI — Mrekulli, nuk thua!

JETA — Mrekulli thotë! Po kjo na i përmbyt të
gjitha planet që bëmë. Shko shpejt, të lu-
tem, shko Albert. Gënjeje, tërhiqe me zor,
thuaji ç'të duash, vetëm ndaje nga, babai!
Ik!

ALBERTI — Nuk mundem.

JETA — Pse?

ALBERTI — Se tani kam ca gjëra më të rëndësi-
shme pér të bërë.

JETA — Çfarë?

ALBERTI — Të të përqafoj dhe...

JETA — Mos u gomende? (*Pauzë. Largo het*) Si shu-
më të lehtë e ke marrë kundërshtimin e
tyre.

ALBERTI — Duan s'duan, një ditë do të fejohemi ne të dy.

JETA — Me zemër të thyer ama. Mos kujton se është pér t'u lakmuar pozita e një të fejuarë që nëna e shikon shtrembër, kurse daja i vetëm s'do ta shohë fare me sy! (Pauzë) E shkreta unë: Po ç'kanë me mua xhanëm? Ç'ka ai kundër aktorëve?...

ALBERTI — Vetëm kundër aktorëve.

JETA — E de, kundër femrave.

ALBERTI — Ka atë plagën e vjetër. Ta kam treguar një herë.

JETA — (Nervoze) Posi! Gënjeshtra me bisht! Na paska dashuruar diikur një aktore dhe ajo e ka tradhtuar! Qenka një derr prapaniku ai daja yt që...

ALBERTI — Derr?!

JETA — Komplet! Me zile, po, të duash.

ALBERTI — Fyerje familjare kjo! Sé, sipas biologjisë, nipi i derrit është derrkuci.

JETA — E minë, më fal. E thashë ashtu kot, nga inati. Se ti i ke fajet. Të gjitha. Dinakërítë e tua! Kurthet e tua! Urdhëro, piju lëngun.

ALBERTI — Do t'ua pimë pas dy javëve në «Turizmi», Daja preferon raki rrushi, që ta dini familjarisht.

JETA — Po si s'e kuption se gjithgka u shkatërrua pa filluar? Gjoja do ta mbanim të fshehtë degën time të shkollës derisa t'u kisha hyrë në zemër! Ata e dinë që sonte.

ALBERTI — E dinë? Jo, s'besoj. Pse duhet ta dinë?

JETA — Sepse po luanin tavllë të dy, daja yt dhe
babai im. Merr vesh ti, apo jo?

ALBERTI — (*I shqetësuar*) Dreqi ta hajë. Më hu-
tove fare. C'mund të bëjmë.

JETA — Të nisesh me vrapi, t'i ndash nga një-
ri-tjetri. (*Duket Miloja*) E kotë... Babai po
vjen. Ik, kalo nga bregu.

ALBERTI — Në det më mirë... (*Ikën*)

MILOJA — Po ti?

JETA — Kërkoja një shoqe.

MILOJA — S'të sosi dita?

JETA — Në plazh jemi, baba.

MILOJA — E... e... nuk e kam aty. Po shiko, ve-
tëtin, bubullin, bien rrufe.

JETA — (*E zë për krahu.*) Baba... aty, me ata bu-
rrat... mos zutë ndonjë bisedë përmua?

MILOJA — Hajde mendje!

JETA — Ndoshta të pyetën kur kalova aty.

MILOJA — Ehu! S'e di tavllen ti! Kur luan, ko-
ka të bëhet zare.

JETA — Në qoftë se të pyesin, ti mos u trego që
studioj për aktore.

MILOJA — Bukur, çupë. Dashkë të bëhem faqe-
nxirë!

JETA — Jo për gjë, baba, po këtu afër është
shtëpia e pushimit. Del fjala që në filan
kabinë është një aktore dhe aq duan ata
masovikët e saj. Eja na recito një vjershë
sot, eja nesër. Ti vetë the se dukem e lo-
dhur nga provimet.

MILOJA — Kur qenka puna kështu... Po në na
pyetshin?

JETA — Sivjet presim t'i dalë e drejta e studimit, thuaj. Ë, se dy javë jemi me ta.

MILOJA — Ama çë! Se mos do të bëjmë krushqi!

JETA — Atë them dhe unë.

MILOJA — Duhet t'i themi satëme, se ajo fjalos shumë. Eja tani. (*Largohen*)

Te kabinet. Çomja është vetëm. Alberti vjen me vrap.

ÇOMJA — E mo ftujaku i xhaxhit? Mbante gjë erë andej?

ALBERTI — Erë?

ÇOMJA — Erë tjetërsoj them... erë femërore...

ALBERTI — Qenke sevdalli ti, xhaxha!

ÇOMJA — Unë ashtu... me shaka, ç'be të-zë! Mos ma vër re, se e kam huq. Kam qenë kasap dhe tërë djemve në moshën tënde jam mësuar t'u thërras «ftujakë». Ti e di kujt i thonë, ë?

ALBERTI — Kandidatit për cjak.

ÇOMJA — S'është fjalë e keqe, kur të mos kem njeri...

ALBERTI — Natën e mirë (*Ikën si i fyer.*)

ÇOMJA — Ç'be të të zë... Iku dhe ky! U fye! E paskan përfis. Jo për gjë, po kisha shpresë se mos bënëm ndonjë pjeskë me mandolinë e qitharë...

JETA — (*Me një pjatancë të mbuluar*) Xhaxha Thoma! Këtu rri ai burri që loste tavllë me babanë?

ÇOMJA — Ehë, Pse, si është puna?

JETA — Thirreni pak, ju lutem.

ÇOMJA — (*Te parmaku*) O shoku Zeno! O shoku, profesor! (*Zenoja del. Çomja i tregon vajzën pa folur.*)

JETA — Më dërgoi babai. Urdhëroni.

ZENOJA — Ç'ka aty?

JETA — Pak byrek. Ata s'kanë pasur kohë të gatujnë, tha babai.

ZENOJA — (*E hap.*) O! Byreku është dobësia ime! Nëna e ka bërë?

JETA — Unë..

ZENOJA — (*E shikon me interes.*) Një vajzë e re që di të tëhollë byrek! Dëgjon ti, Çome? (*Vajza bën të largohet.*) Prit, ndalu një çast! (*Thérret*) Alber, Alber!

ALBERTI — (*Nga brenda*) Urdhëro, dajë!

ZENOJA — Dil shpejt! Menjëherë!

ÇOMJA — Bobo! Ia krisi shiu! (*Jeta jutet nën strehët e kabinës.*)

ALBERTI — (*Del*) Ç'ka ndodhur, dajë?

ZENOJA — Kam nderin të të prezantoj me vajzën e miikut tim, Milos.

ÇOMJA — Lilos!

JETA — Milos, xħaxha Thoma. (*I jep dorën Alberti.*) Jeta.

ALBERTI — Albert.

ZENOJA — Fiziikant. Së shpejti jep provimet për gradë shkencore.

JETA — Gëzohem.

ZENOJA — Po ti?

JETA — Unë... pres të më dalë e drejta e studimit. Natën e mirë.

ZENOJA — Po prit, moj vajzë! Prit! Alber, merrë çadrën e përcille vajzën.

ALBERTI — Nuk e di rrugën vajza?

ZENOJA — Léri shakatë. Nuk e shikon shiu?

ALBERTI — Të them të drejtën, kjo s'më dûket dhe aq normale, dajë. Porsa prezantohet njeriu me një vajzë dhe ta përcjellë natën, nën një çadër...

ZENOJA — Po ajo është vajza e mikut tim, more derdimen!

ALBERTI — Pavârësish. Njerëzit mund të flasin...

ZENOJA — Sille çadrën! Ju të rinjtë e sotëm s'merrni erë fare nga xhentilesa. Po shkoj vetë! (*I jep krahun në mënyrë teatrale. Jetat mbështetet. Dalin të dy.*)

TABLOJA E DYTE

Veranda e kabinës 27. Nga dritarja e hapur duket Zenoja. Natë. Dëgjohet mandolina e Comes dhe kënga e tij «Kur më vjen burri nga stani /fërr, fërr, fërr më bën fustani».

ZENOJA — Filloi ky! Na çau veshët me atë «fërr-fërrfërr»...

ALBERTI — Nuk e këndon keq.

ZENOJA — Në qoftë se është fjala për të kënduar, kam kënduar vetë kur isha i ri.

LAJDJA — Epoo, pér qejf vijnë njerëzia në plazh,
vëlla, përsë tjetër? Të çlodhen, të gëzojnë.

ZENOJA — Ka që vijnë edhe nga halli, motër!
(*Shikon Albertin.*)

ALBERTI — Reumatizmi, nervi shiatik, anginat
kronike... Pér q'sémundje tjetër e rekoman-
dojnë plazhin, dajë?

ZENOJA — Pér vidhat!

ALBERTI — Si pér vidhat?

ZENOJA — Kur të lirohen, del nga binarët dhe
harbon pa fre, si mëz. Hyj, hyj ku rafsha
mos u vrafsha! Ja, atëherë familja e quan
të domosdoshme të mblidhet në një qoshe
larg veshëve të botës.

ALBERTI — Ama qoshe! Ku ka më shumë veshë
se në plazh?

Zenoja bën lëvizje nervoze.

LAJDJA — Daja po të flet seriozisht, Albert.

ALBERTI — Edhe unë seriozisht flas, nënë.

LAJDJA — Ah, sa ke ndryshuar, more bir! S'ja-
në mbushur tre vjet që kurse ke filluar pu-
nën dhe pa shiko si flet, daja një, ti dy!

ZENOJA — Jo, lëre të flasë, motër, lëre të shpre-
het. Nëse don ta kuptosh mendjen e nje-
riut, lëre të shprehet. Ne po të dëgjojmë. Al-
bert.

LAJDJA — Kemi hall, o bir! Aty na rri mendja
ditë e natë, s'na zë gjumi!

Pauzë.

ZENOJA — Nip, po pres!

ALBERTI — Unë duhet të flas?

LAJDJA — Ta qajmë një herë hallin siç duhet,
o bir, pastaj të vendosim.

ALBERTI — Atë dua dhe unë, mama. Vetëm se
s'është nevoja ta përdorim aq shpesh fja-
lën «hall».

LAJDJA — Merr mendjen dhe sytë tonë e shi-
koje.

ALBERTI — Unë më parë do të kisha parë vaj-
zën! (Daja çohet.) Jo në atë kuptim që e
merr ti, dajë. Ama, unë nuk do ta shaja pa
e njohur e pa i ditur as emrin!

ZENOJA — (Me vete) Duro, o njeri! (Albertit) Ti
së prapthi i ke lexuar letrat tonë? Kush
ta shau bukurinë e saj? Dhë e bukur do të
jetë, s'do mend, përderisa të ka hedhur tru-
të e gomarit. Bulkuria është sikarremi i
gripit që gënjen peshkun, nipi. I dimë këto
gjëra ne, nga përvoja i dimë. Mirëpër buku-
ria, Albert; ikën si era. Ikën dha ç'mbetet
pas saj?

ALBERTI — Njeriu, karakteri i tij.

ZENOJA — Pikerishfi! Karakteri. Virtytet dhe...
veset!

ALBERTI — Të cilat... ju nuk i dini fare.

ZENOJA — (Disi i nxehur.) I dimë, se na kanë fo-
lur njerëzia, dashamirët. (Më vete) Duro, o i
urtë! (E ul tonin) Daja yt, nuk është ndonjë
konservator i mykur, Albert. Uhë e bëra fli-
sedrën time dhe ta tregova atë ngjarjen dra-
matike të jetës sime. Është e vështirë, është
shumë e rëndë për një burrë të moshës si-
me t'ia hapë qoshet e fshehta të zemrës një të

riu, aq më tepër nippit që e ka si djalë. E bëra këtë që të të ruaj nga një dramë. Si-kur të mos kishe atë të ardhme që ke, ka mundësi të mos kundërshtoja kaq. Po ti je shkencëtar që sot...

ALBERTI — Jo de...

ZENOJA — Je!

LAJDJA — Mos ia pre fjalën dajës, Albert!

ZENOJA — Një martesë e keqe, e pagoditur të themi, ty do të të pengojë. Një njeri i shtru-ar, një studiues, një shkencëtar nuk mund të gjejë gjuhë të përbashkët me një femër që do s'do, do ta ketë mendjen tralala e tri-lili, te fustanet e frizurat e modës, tualetërat e ngallosjet siç ia do zanati. Makiazh në skenë, makiazh në jetë. Rol në skenë, rol në jetë. Edhe sikur besnikëria vë-të të jetë, prapë është një grua në mes të ciklonit të syrit mashkullor. Njerëzve, po edhe ty, do t'u vejë mendja për tradhtira të vogla. I kemi parë nëpër filma këto. Eh, jo Albert, ti nuk do ta duroje dot, të njoh unë. Ti je si unë, i urtë, i sjellshëm, me takt. Nuk i durojmë dot skandalet ne të dy. Atë-herë mua, mua do të më, vrasë ndërgjegjja që s'munda t'i vë fre pasionit tënd që do të të shkatërrojë pak nga pak duke të gërryer si ajo pika gurin.

ALBERTI — Sa me bindje që flet, o dajë! Dhe bukur besa, si në një libër.

ZENOJA — Ky ka qenë vetë libri i jetës sime. Një dramë e pashkruar kurrë...

ALBERTI — Më mirë që s'është shkruar, se nuk do ta besonte njeri.

ZENOJA — Ashtu? (Cohet.) E kam parandier, motër Lajde! Një ditë, unë do të quhesha i tepërt në këtë familje. Ajo ditë paska ardhur. (Me vete) Në qoftë se e ndien veten të tepërt, atëherë...

LAJDJA — Albert! Zeno! Po ç'bëni kështu? Doni që të qaj?

ALBERTI — Po bisedojmë si burrat, dajë. Ti mos u lëndo nga fjalët, se e di që as respekti, as dashuria për ty nuk më mungojnë.

ZENOJA — Ja, këtë nuk e dimë me siguri.

LAJDJA — Ashtu është, Zeno, ashtu. Alberti të do, të nderon...

ZENOJA — Në më do e më nderon, atëherë le të më dëgjojë e të bindet se për këtë dashur... dashu... për këtë marrëzi, unë gjykoj më mirë se ai.

ALBERTI — (Pak i nxehur edhe ai) S'ke si gjykon, kur nuk e njeh.

ZENOJA — Unë fola boll.

ALBERTI — Po dhe ju vetë e dini që arsyetimet tuaja nuk janë bindëse «Në mes të syrit të ciklonit mashkullor»... «Tradhtira të vogla»... I keni parë në filma... mirë e thatë. Një pikëpamje kaq arkake, kaq e prapambetur sa zot të besohet se mund të jetojë alkoma.

ZENOJA — Motër Lajde! Ndryshe kësaj i thonë: «O dajë, mjaft i re legenit.»

LAJDJA — Jo, ai nuk tha legen. Ai përmendi, nderimi, dashuria, mirën johja...

ZENOJA — Nuk e prisja që fjala ime të kishte kaq pak vlerë për nipin tim.

ALBERTI — Edhe unë nuk e prisja që dajë im i mirë të përpiquej të më shkatërronte dashurinë time vetëm nga antipatia që ka për aktoret.

ZENOJA — Këtë nuk e kam thënë kurrë!

ALBERTI — Atëherë, nga një dashuri e dështuar apo ndoshta, kushedi e imagjinuar.

ZENOJA — (Çohet) Kjo e mbush kupën!

ALBERTI — Rri dajë, më takon mua të largo hem. Kabinën e ke marrë ti.

(Del)

LAJDJA — Albert! (Në verandë) Albert!

ÇOMJA — Ç'ka ngjarë?

LAJDJA — Ai iku... Ndërruan dy fjalë me Zenon dhe ai... iku!

ÇOMJA — Mos u bëj merak së do të kthehet. (Del Zenoja) Kur e shpon elbi mëzin, hedh ca vickla, pastaj kthehet prapë në stallë. C'do të bëjë tjetër?

ZENOJA — Të lutem shumë, të lutem shumë, Çakshiri!

ÇOMJA — (Me naivitet) Urdhëroni, profesor!

ZENOJA — Në qoftë se keni sadopak respekt për në, atëherë tërhoqini mbraapsht ato fjalë.

ÇOMJA — Po ç'fjalë thashë, mor aman.

ZENOJA — Ato që the për mëza, për vickla, për stalla e ku ta di unë...

ÇOMJA — Unë ashtu, mor profesor, sa për të kujtuar një llaf, të vjetër... Pa, të keq, kur

të mos kem njeri të gjallë:: (*Duket Miloja.*)
MILOJA — Mirëmbëria! Mirë u ngrysët?

Zenoja e përshëndet nëpër dhëmbë.

ÇOMJA — Mirë se erdhe, Lilo, Sa mirë që erdhe!

MILOJA — (Zenos) Thashë t'i përplasnim njëherë. Profesori, bumbum, unë bum, bum — bum! Do t'i përplasim brirët?

ZENOJA — Brirët? Hm... edhe brirët kishim mangut...

ÇOMJA — E paskan zënë të gjithë me bëgëtinë sonte, profesor. Për zaret e ka llafin Lilua, pér tavllën.

MILOJA — Për kë tjetër?

ZENOJA — Luani ju të dy.

ÇOMJA — Ti e di që unë s'luaj.

MILOJA — Me ty e kam inatin, Zeno. S'më zinte gjumi. Si ore, unë të të kap të dyshi dhe ti të ma marrësh lojën, ë? Ama sonte, dëgëdëg!

ÇOMJA — Dëgëdëg, po nuk e mund dot se profesori është mjeshter i madh...

ZENOJA — Unë, s'luaj. Unë, në përgjithësi, s'di të luaj.

MILOJA — Po dje... ti dije!

ZENOJA — Dje dija, sot nuk di. (*Hyn brenda me rrëmbim.*)

MILOJA — C'pati ky kështu?

LAJDJA — Mos ia vini re. Urdhëroni t'ju bëj nga një kafe. Mos ia merrni pér ters, ashtu i vjen nganjëherë.

ÇOMJA — E mo fundja, pimë ato kafetë.

MILOJA — A, jo faleminderit shumë! Boll qe pér mua. Jua paça borxh. Mirupafshim, në u pafshim ndonjëherë. (*Ikën*)

LAJDJA — Bobo! U zemërua! Ah, more Zeno ç'na bëre!

ÇOMJA — I vjen dendur kjo dallgë?

LAJDJA — Rrallë. (*Del Sanda.*)

ÇOMJA — Kur e zë, sa e mban?

LAJDJA — (*E habitur*) Po jo... nuk desha të them atë. Ai s'vuan nga gjësendi, vetëm se nxehet ndonjëhrë.

SANDA — Po fol, se na thave gjakun. Thamë ndonjë ilet i mendjes, kushedi!

ÇOMJA — Sa pér të nxehur të gjithë nxehemi. Se tani m'u kujtua. (*Bërtet*) Kur më hipin xhindet mua, s'ka burrë që më mban! I thyej të tëra, me pjata, me gota, me filxhanë. Batërdi e bëj! (*Lajdja ikën*)

(*Pauzë*)

SANDA — Më erdhi një mendje, Thoma, më erdhi një mendje që... lere.

ÇOMJA — Një mendje? Përse?

SANDA — Pér atë Ylberin.

ÇOMJA — C'është ky Ylber, moj?

SANDA — E de nipi, ai i shkencës...

ÇOMJA — Atij i thonë Alber, moj tutkune. Pa «t».

SANDA — C'bëri ajo, Alber, Ylber... dëgjo këtu ti!

ÇOMJA — Që do ta kesh budallallëk e di si buka që ha, po hajt ta dëgjojmë.

SANDA — Ta ftojmë Lilin. E de, c'më shikon si buf, mbesën tènde.

ÇOMJA — Po ç'na duhet?

SANDA — Se mos kushedi, i mpleksim me atë Ylberin... (*Çomja proteston me gjeste*.) Prit, mos e merr revan. Këta, a duan t'ia shkulin nga zemra aktoren?

ÇOMJA — Duan. (*Sanda e prek*) Tutje... mos më prek. Def!

SANDA — Më fal. Ata ia shkulin aktoren ne i ngulim Lilin.

ÇOMJA — (*Mendohet*) Hm... siç i thonë llafit, gozhda del me gozhdë.

SANDA — (*Me bërryl*) Hënde, de!

ÇOMJA — A... shpirtkazmë!

Vjen Lajdja me kafetë. I shikon me habi.

ÇOMJA — Ia krisi shiu! Ah, c'bukuri! E di si më vjen, Të zhyishem e të futem në mes të rrëkesë. Gëzuar, pushime të mbara!

LAJDJA — Ju bëftë mirë! (*Psherëtin*)

ÇOMJA — A, jo, jo kështu! Zemra të gëzuara, pa s'ka gjë që s'rregullohet. Zemra të gëzuara!...

SANDA — Kështu e ka rinia e sotme, moj motër. Ne gratë s'ua mbledhimi dot rripat, s'jemi të zonjat.

LAJDJA — S'jemi jo, sidomos kur janë djem.

SANDA — Po shyqyr, djali ka dajën që i rri gëkan mbi kokë.

LAJDJA — Për të mirën e tij përpigjet i ziu Ze-no, po ja nxitohet dhe e prish punën.

SANDA — Zenoja kā shumë tē drejtë.

ÇOMJA — Edhe ka edhe s'ka!

SANDA — Do tē vuajë Ylberi me atë aktoren, do tē vuajë si një e një që bëjnë dy.

ÇOMJA — Edhe mund tē vuajë edhe mund tē mos vuajë...

LAJDJA — Po s'kjur djalit t'i jetë tiposur aq shumë sa tē mos i shqitet dot nga zemra? Duam, s'duam, ai mund ta marrë. Atéherë, ajo do tē më shohë shtrembër. Ti s'më ke dashur, do tē thotë me vete. Unë mund ta dua, por ajo...

ÇOMJA — Ke hak, ke hak, moj motër, po ç'dreinq ju ka hipur që e shani aq shumë atë vajzë xhanëm?

SANDA — (Me gjeste) S'i ç'u ka hipur? Ty ta shikoqiti vetë profesori. Ti u bindë.

ÇOMJA — Hiç s'u binda. Nuk shikon, paska dëgjuar ca fjalë. Gjepura! Llogje Kavaje. Qenka burrë i mykur ky profesori. I them burrë se s'dua t'i them plak.

SANDA — (E shpon) Thomaa.

ÇOMJA — Ah... shpirtkazmë! (Lajdes) Vëlla e ke, po unë ta them copë. Mirëmbetsh! (Hyn brenda)

SANDA — Mos ia vër re, e ka nga tē djegurat. (Me zë tē ulët.) Për mua do tē bënët mirë ta afronit me ndonjë vajzë tjetër.

LAJDJA — Mirë do tē qe.

SANDA — Sevdaja shërohet me sevda!

LAJDJA — Ajo vajza e Milos për shembull. Si ylli!

SANDA — S'është e keqe, po ka të mira mbi të mira.

LAJDJA — Dje i pashë të dy kur bisedonin. Fap-fap më bëri zemra. Natën e mirë.

SANDA — Natën e mirë dhe mos u bëj merak, se na ke këtu për çdo gjë.

ÇOMJA — (Nga dritarja) Shiko se mos gjen pjetë për. Pjepri bën më mirë se kosi për djegiet! Na, moj, dyqani është këtej! Ku vete?

SANDA — T'i bëj telegram Lilit!

Në paraskenë, Zenoja pret nën një strehë të pushojë shiu. Është i zymtë, i mërzitur. Jeta vjen me dy çanta të rënda me peri-me. Zenoja del nga streha, e ndihmon.

JETA — S'ka gjë, xhaxha Zeno, i mbaj vetë. Nuk janë të rënda.

ZENOJA — (Ia merr njëren) Oj, nuk janë të rënda thotë! Kjo sikur ka brenda gurë!

JETA — Ka patate.

ZENOJA — Hyr nën strehë sa të pushojë shiu.

JETA — Merrni një kokërr pjeshkë...

ZENOJA — Ky shiu na plasi buzën. Të vish në plazh e të bjerë shi.

JETA — Vërtet. S'di pse të fut një si trishtim në shpirt. Njëlloj siç i ndodh njeriut kur është në mes të lumburisë dhe diukush ndërhyjn që t'a prishë...

ZENOJA — O! Po kjo është ç'njerëzore!

JETA — Më shumë se ky shiu në plazh!...

ZENOJA — Pa dyshim. Ah, rinia e sotme, sa e mençur që është! Paqka se ne të vjetërve na duket sikur ajo nuk e vret mendjen shumë.

JETA — Po ju nuk jeni i vjetër si disa...

ZENOJA — (*Pak i llastuar*) Hm... e dini, nipi tim Alberit, ia kam përsëritur shpesh një kë-shillë: Kur të vish në moshën time, i them, mundohu të rrish me njerëz më të rinj se vetja. Në qoftë se s'duam të plakemi në mendime, atëherë duhet të përpinqemi ta kuptojmë rininë, i them. (*Kujtohet*) Po më fal, ju digka deshët të thoshit qëparë.

JETA — Unë, jo asgjë...

ZENOJA — E mbaj mend mirë, ju thatë: «Nuk jeni i vjetër si disa që...» dhe e pretë fjalën. Ose më mirë, ua preva unë.

JETA — M'u kujtua historia e një vajze që bannonte në pallatin tonë. Ajo dashuronte një pilot, mirëpo prindërit nuk e deshën pilotin. Është profesion me kokën në torbë, i thoshin, të kemi të vetme, s'duam të të zhuritet zemra.

ZENOJA — Po ta shikosh nga kjo anë...

JETA — Mblodhiën tërë fisin dhe ia mërzitën jetën me ato gjerr-mëret e tyre.

ZENOJA — Kur dalin për mirë, harrohen gjerr-mërret. U shkëput pastaj?

JETA — Përkundrazi. Dashuria nuk u këputka lehtë...

ZENOJA — Nuk këputet, jo... (*I interesuar*) Ju e dini... dua të them e kuptioni këtë gjë ashtu teorikisht apo?

JETA — Xhaxha Zeno!

ZENOJA — Më fal, e djallosa. Ju bëra një pyetje delikate.

JETA — E solli fjala ashtu.

ZENOJA — E dini që jeni një vajzë e mençur?

JETA — Mos më lavdëroni dhe kaq tani...

ZENOJA — Desha të them se jeni imjaft e mençur për moshën, që keni. Dhe ç'është më e çuditshmja ju i keni të dyja.

JETA — Të dyja? Si të dyja?

ZENOJA — Mençurinë, dhe bulkurinë.

JETA — Tani më vjen të iki nëpër shi. (*Qeshin*)

ZENOJA — Bernard Shou thoshte se këto dy cilësi nuk gjenden kurër së bashku te një grua. E keni dëgjuar Bernard Shoun?

JETA — Dramaturg anglez me origjinë irlandeze.

ZENOJA — Tamam! Unë jam shumë i dhënë pas teatrit.

JETA — Edhe unë. Në shkollë më thonë se kam prirje për aktore...

ZENOJA — Mos u bëj!

JETA — Pse, ka ndonjë të keqe?

ZENOJA — Ka disa.

JETA — Dhe këtë ma thoni ju që jeni aq i dhënë pas teatrit?

ZENOJA — Jo... Po e di si qëndron çështja? Në teatër, në art them, ose të jesh i parë, ose të mos jesh fare. Gjysmalkët janë fatkeqë...

JETA — Kështu ndryshon puna. Kujtova se mos

kishit ndonjë paragjykim.

ZENOJA — Ou! Shiu paska pushuar! U harruam pas muhabetit. M'i jepni trastat mua. M'i jepni kur ju them!

JETA — Këtë të rëndën, e kapim, bashkë.

Para kabinave.

ZENOJA — Dëgjo. Thuaji babait të na urdhërojë. Zenoja ishte paik me nerva qëparë, i thuaj, mos ia vër re.

JETA — Pse, ç'ndodhi midis jush?

ZENOJA — Asgjë, mos u shqetëso. Sot Zenoja u bë grindavec. Fajin e ka shiu, a nuk e thamë? Do të bisedojmë prapë bashkë. Nattën e mirë, Jeta! (*Jeta largo het.*) Ah! Të ka lezet shpirti! Punëtore e do, të zgjuar e do, të bukur e do gjithë të mirat mbledhur në një vend. Eh, more nip, more nip! Ç'vajza të mira ka bota! Kurse ti... (*Hyn në kabinë*).

LAJDJA — Qënke lagur, Zeno!

ZENOJA — Djali, Alberi, nuk ka ardhur alkoma?

LAJDJA — Erdhi një herë; pyeti për ty dhe doli. Me siguri po të kërkon.

ZENOJA — E ku do të humbja unë? (*Pauzë*) Qëparë e dreqosa ca, motër.

LAJDJA — E, s'ka gjë. Ti je kreu i shtëpisë, do të thuash një fjalë më tepër. Ai të ulë kokën, të dëgjojë.

ZENOJA — Nuk e kam hallin te Alberi. Ai më ngjet mua, s'mban inat. Me atë Milon e dreqosa. E ofendova. Turp e faqja e zezë. S'i dal dot përpara.

LAJDJA — Mos u bëj kaq merak dhe ti. Se mos do të bëjmë krushqi...

ZENOJA — Atë mos e thuaj.

LAJDJA — (E interesuar) Pse?!

ZENOJA — Ku i dihet jetës, motër!

LAJDJA — (Psherëtin) Ah, sikur!...

ZENOJA — Sikur?...

LAJDJA — Sikur ai të merrte sytë tonë e ta shikonte.

ZENOJA — Të pëlqen?

LAJDJA — Yll i këputur! Të merr në qafë.

ZENOJA — Dhe e sjellshme dhe e zgjuar dhe punëtore!

LAJDJA — Ç'e do? Kot...

ZENOJA — Dale, pse kot?

LAJDJA — Kot, e di unë! Ai e ka mendjen tek ajo tjetra.

ZENOJA — Po unë tani kam një projekt në kokë.

LAJDJA — Nu k do të bindet dhe do të grindeni prapë. (Pauzë) Zeno, po sikur të pyesnim pak pér atë çupën e teatrit?

ZENOJA — Hiç s'do të pyesim. Unë kam një projekt të shkëlqyer! O e bëj, o i bie këmbës. Ja, po vjen. Ti... shëët!... Mos fol fare, lerma mua. I duhet thënë më shumë marifet.

LAJDJA — Si të duash ti...

ZENOJA — Unë po hyj në kuzhinë. Po të pyeti, thuaji daja s'hëngri darkë fare. Është shumë i shqetësuar, thuaji. (Merr pjatën hyn në kabinë.)

ALBERTI — (Me një kartë me pjeshkë.) Mirë-

mbrëma! (Me zë të ulët.) Ç'bën ai? I zemëruar është? (Lajdja pohon) Darkë, hëngri?

LAJDJA — Ehë! (Dëgjohet kolla e Zenos nga brënda.) Jo, nuk vuri bukë në gojë. Po ti mos ia prish, ë, të keqen nëna!

ALBERTI — S'po marrim vesh kush ia prish njëri-tjetrit. Jam më i vogël, duhet të hap udhë. O dajë! Dil se kam sjellë ca pjeshkë të mira. (Heshtje) Nejse, ti si të duash. Unë desha të kërkoj edhe të falur.

ZENOJA — (Duke u kollitur.) Khë... hëm... nejse, ashtu nëpërmjet murit kërkohet lehta e falura. Vështirësia është sy ndër sy.

ALBERTI — Edhe në sy, o dajë. Unë s'jam frikacak. (Hap dritaren. Duket Zenoja duke ngrënë.) Gabimi qe imi. S'duhej të nxehsha e të ikja. Më fal!

ZENOJA — Falur qofsh. (Del)

ALBERTI — Merr një pjeshkë.

ZENOJA — Si paradhënie për të më zbutur kjo?

ALBERTI — Quaje si të duash, vetëm merre.

ZENOJA — Ama pjeshkë! Pjeshkë qenë ato që kishte marrë vajza e Milos!

ALBERTI — Në një dyqan i morëm. Vajzave ua japid më të mira, dihet ajo! Aq më tepër kur janë të bukura.

ZENOJA — Pse e bukur qenka, ë?

ALBERTI — Kështu thonë...

ZENOJA — Dhe të pëlqen?

ALBERTI — Për mua s'ka rëndësi.

ZENOJA — (E ndërpret) E, e. Më zuri shiu dhe

mibeta nén njé strehë me tē, Hajde, g'vaj-
zë! Ah, sikur tē isha tridhjetë vjet më i
ri, thashë!...

ALBERTI — Tridhjetë vjet më i ri jam unë,
dajë!

ZENOJA — Ti je, po s'di t'i shfrytëzosh vitet e
tua.

LAJDJA — Darka është gati, Albert!

ZENOJA — Dale dhe ti, mos na i pre fjalën në
mes. Ulu ta pleqërojmë tanë që jemi tē gjithë
gjakftohtë. (Ulen) Jemi aq gjakftohtë sa
duhet, Alber?

ALBERTI — Unë jam, dajë.

ZENOJA — Po ti, motër?

LAJDJA — C'të them e shkreta? Do tē mun-
dohëm:

ZENOJA — Mundohu. Le që ti s'nevrikosesh ku-
rrë. Alber, qëparë nië kuptove gabim. Ti
je në moshën e martesës dhe ke tē drejtë
tē zgjedhësh e tē krijosh familjen. E para-
kjo. Nga ato që thamë për aktoren, nuk
heqim dorë. E dyta, ne s'duam tē bëjmë
krushqira, po ja sikur tē tjetë rekombinjmë,
sikur ta drejtojmë vëmendjen tënde te një
vajzë. Ndoshta edhe ti, edhe ne... ë. Ku
dihet? Mund, tē përputhemi, në shijë. E
tretë, uif!

ALBERTI — Cila është kjo? E njoh unë?

ZENOJA — E njeh. Domethënë... e njeh pak, por
ne do tē krijojmë mundësinë që ta njohësh
më mirë. Hë, Lajde, fol ti tanë!

LAJDJA — (E paduruar.) Miloja, vajza e...
ZENOJA — Jeta, vajza e Milos. Vajzë e mreku-llueshme!

(Pauze)

ALBERTI — Nuk ka vend zemra për dy femra, dajë!

ZENOJA — Po ta shkulësh njërën, vendi mbetet bosh dhe hyn tjetra...

ALBERTI — Pse e shkul dot thua?

ZENOJA — E shkul, si jo! S'është ndonjë çudi e madhe!

ALBERTI — Po ti vetë... pse nuk e shkule?

ZENOJA — (Bërtet.) Po prandaj more, se e bëra unë atë gabim pa s'dua të të lë që ta bësh edhe ti! Prandaj! (Pauze.)

ALBERTI — (Pas një hezitimi.) S'di ç'të them. Ti të mbërthen me ca argumente që s'të lënë të lëvizësh hic fare.

ZENOJA — Logjika e atij që ka vuajtur, logjika e jetës, Alber!

ALBERTI — Dua të mendohem. Nesër do të të jap përgjigje. U pa puna, sonte do të rri pa gjumë.

ZENOJA — Ah, netët e tillë pa gjumë! Sa të bukura janë! (Çomja këndon.) Dëgjoni? A pa-pa, sa bukur këndon ky Çomja. Unë po dal pak. (Del. Merr kitarën e këndon me Comen «Kur më vjen burri nga stani...»)

TABLOJA E TRETE

Mëngjes herët. Alberti pret Jetën në pikëtakimin e zakonshëm.

ALBERTI — Mirëmëngjes!

JETA — Ç'është kjo pritë që menatë?

ALBERTI — Mos ta zuri syri mamanë nga tregu?

JETA — Jo. Pse, ç'ka ndodhur?

ALBERTI — S'dua që të na shohë. Lëmsh puna.
Ata, ose i kanë zbuluar të gjitha, ose...

JETA — Ose...

ALBERTI — Ose ti u ke hedhur trutë e gomarit.

JETA — Fyerje për fisin kjo. Një me zero.

ALBERTI — Leri shakatë, se mua më del tym nga
kokë.

JETA — Po hë pra, tregoma zjarrin tanë.

ALBERTI — U ka shkrepur që... të na afrojnë
të dyve.

JETA — Të na afrojnë! Si të na afrojnë?

ALBERTI — Po ja ktheji sytë nga çupa e Milos,
thonë. E bukur, e zgjuar, objekt për t'u da-
shuruar!

JETA — Po ky objekti, do të pranojë, thua?

ALBERTI — Kjo nuk diskutohet fare.

JETA — Epo mirë, afrohemi atëherë, ç'të bëjmë
tjetër!

ALBERTI — Po sikur tē jetë një kurth? Sikur ai tē dijë gjithçka dhe tē më provokojë pér tē më vënë në provë?

JETA — Nuk e besoj. Ai duket fare i padjallëzuar.

ALBERTI — Vetëm duket. Problem me njëqind tē panjohura.

JETA — Zgjidhe ti që je fizikan. (*Pauzë*) Si do tē vejë ky filli ynë kështu? Më duket sikur lozim teatër. Pse tē mos ua themi troç? Ç'do tē bëjnë?

ALBERTI — Do tē kundërshtojnë.

JETA — Atëherë, ne u kemi dalë nga borxhi.

ALBERTI — Po do tē mbetemi zëmërthyer pér një kohë tē gjatë. (*Pauzë*) Unë them tē kundërshtoj vetë më parë.

JETA — Si do tē kundërshtosh?

ALBERTI — S'dua tē afrohem me çupën e Milos. S'ka vend zemra pér dy femra...

JETA — Ua ke thënë një herë këtë.

ALBERTI — (*I mërzitur.*) Po, ua thashë... Po t'i kalo një herë andej nga kabina jonë.

JETA — Të bëj paradën e trastave që në mëngjes?

ALBERTI — Dajës i pëlqen shumë kur tē shikon ashtu nikooqire. Po e takove, matja pa k pulsin. Pastaj takohemi në det.

JETA — Po tē mos bjerë shi.

ALBERTI — Bie s'bje, aty tē pres. (*N da h e n*)

Para kabinave. Zenoja bën ushtrime gjim-nastikore. Kur shikon Jetën, sforcohet në lëvizje, bëhet më energjik.

ZENOJA — (Duke u ulur e ngritur.) O, Jetë! Mirëmengjes! Sa herët qenke ngritur, moj bijë!
JETA — Si për ditë.

ZENOJA — Si lumi mëmaja që të ka. (Jeta bën të ikë.) Unë, ja, siç e sheh, po bëj gjimnastikën e mengjesit. Nga pak, sa për të mos vënë bark. Ja, thatë të falat e mijë babait?

JETA Posi! Faleminderit, tha.

ZENOJA — I the dhe që isha pak me nerva?

JETA — Ehë. S'ka gjë, tha, njeriu s'duhet të zemërohet për një fletë presh.

ZENOJA — Për një fletë presh! Bulkur! Burrë i zgjuar yt atë! Thuaji se e pres për tavllë. Aha, ja po vjen ëdhe Alberi. (Me zë të ulët.) Fullet në det pa gdhinë dhe bën nga dy kilometra not. Brr...

JETA — Po pse?

ZENOJA — Don ta mbajë trupin në formë. Menç dje e shëndoshë, në trup të shëndoshë. (Vjen Alberti.) Ti... nuk je zemëruar me këtë nipi tim, hë?

ALBERTI — Në posa jemi njohur, dajë. Kur u njohëm, kur u zemëruam!

ZENOJA — E ngas fjalën përmbrëmë, kur, nuk desh të të përcillte.

JETA — Jo, aspak, Pastaj ai kishtë të drejtë. Ishte natë dhe njerëzit e kanë gjuhën të lagur.

ALBERTI — Aq më tepër që binte shi. Por, që kjo vajza ta marrë vesh mirë se ne jemi fis i edukuar, dajë, me lejën tënde, tanë unë po ia marr trastat dhë po e përcjell. Dakord?

ZENOJA — Bulkur, shumë bulkur. Mirë vafshi. Ah,

prisni, diçka desha t'ju them. Ikën, ta marrë e mira.

Ulet në shezlong i menduar.

ÇOMJA — (Që posa del.) Mirëmëngjes, komshi! Qenke futur në të thella.

ZENOJA — Duhet të mendohemi! Mosha jonë është mosha e mendimit të thellë.

ÇOMJA — (Afrohet te parmaku.) Edhe mua më pëlqen nganjëherë të mbyll sytë e të mendohem. Më vijnë turli mendimesh, ta zëmë pse rëra është kaq e nxeh të, kurse dheu jo... C'i thua ti kësaj?

ZENOJA — Ky quhet meditimi ose përsiatje.

ÇOMJA — Përc, përciatje!

ZENOJA — Domethënë mendim i thellë për diçka. Por nuk ia vlen të vrasësh mendjen për gjëra që i di edhe bufi, si ajo e rërës, apo ku ta di unë, pse e bën zogu folenë në pemë. Nëse duhet të përsiatim diçka, dhe duhet, atëherë të mendojmë për gjëra të vëçanta e të panjohura.

ÇOMJA — Për shembull?

ZENOJA — (I zënë në befasi.) Për shembull... për hundën.

ÇOMJA — (Lë revistën «Shkenca e Jeta» mënjanë.) Pilkërisht. Pse disa njerëz e kanë hundën të gjatë e disa të shkurtër. Nga rrjedh kjo?

ÇOMJA — Nga nëna e nga babai, dihet. Trashëgim.

ZENOJA — Trashëgimia, genet po se po, mirëpo është më e koklavitur. Njeriu i parë doli në

zonat, më klimë të ngrohtë e të lagët, në zemër të Afrikës. Nga majmuni, dihet. Një rëzit parahistorikë e kishin hundën shumë të shkurtër. Kjo si trashëgim nga majmuni po edhe pse ajri ishte shumë i lagët dhe me një të ndjellë njeriu duhej të thithë sa më shumë ajër. Më vonë, njeriu u shfaq edhe në veri, po hunda e tij tanë doli më e gjatë. Pse? Se ajri qe i ftohtë, pra hunda i duhej më e gjatë që ai të kalonte në një rrugë më të madhe e të ngrohej para se të vinte në mushkëri. Hundën më të gjatë e kanë eskimezët. Ky quhet evolucioni i hundës. Pastaj, thonë se çdo hundë ka fatkeqësinë e saj. Hundëgjatët, për shembull, mbeten më shpesh beqarë sesa hundëshkurtërit.

COMJA — Ti nuk e ke aq të gjatë, megjithatë.

ZENOJA — Ehù, unë! Ç'hyj unë këtu? Kjo ësh-të shkencë. (*Ndërron bisedë*) Do t'i ngremë cadrat sot?

COMJA — Kot që t'i ngremë, prapë do të bjerë shi.

ZENOJA — Po ti vetëm tersin ndjell?

COMJA — Ore do të bjerë, dëgjomë mua. Këtë pesëmbëdhjetëditësh këtu sikur ka shkundur brekët shejtani. Edhe vjet shi binte.

ZENOJA — Kur e dije, pse erdhe?

COMJA — Që t'i bëja, qejfin gruas! (*Hyn Lili me valixhe*.) Oo! Pa shiko, more Zeno, shiko, mor aman, kush na erdhi! Shiko, mor profesor, kush do të na e hapë kohën e do të na zbuluarojë plazhin. (*Sulet krahëhapur*) O të keqen xhaxhai ty!

LILI — Mirë se ju gjeta, xhaxha! (Zenos) Mirë
jeni ju?

ZENOJA — Ju faleminderit!

LILI — Mirë është teta Sanda?

ÇOMJA — Si pogaçë e lyer me mjaltë.

LILI — Me tensionin?

ÇOMJA — Në rregull.

LILI — Me dhembjet e kyçeve?

ÇOMJA — S'i ndjen më.

LILI — Me pagjumësinë?

ÇOMJA — Ia hoqi plazhi si me dorë.

LILI — Shyqyr! Mirë ju ka mbajtur koha?

ÇOMJA — Jo dhe aq. Vrenjtur, kthjellët...

LILI — Në Korçë u shpua qelli. Vuu shiu, me gjyma, për kokën e babait. Mamasë këtu i mbeti mendja; oi, si s'u mbajti një çikë koha që të nxihen, thoshte. (*Zenoja largohet*) Unë do të nisesh që dje, po prita sa ma qepën fustanin e ri. Po ai ç'pati?

ÇOMJA — A, profesori! Zotni burrë, me edukatë të lartë. Kujton se kemi muhabete familjare. Është këtu me motrën e me nipin, do të njihesh edhe me ta.

LILI — Meqë jemi komshinj...

ÇOMJA — (*Këndon ulët*) «Komshicë ti moj /Plagët e vjetra m'i lëndove!».

LILI — S'më durohet sa të shoh teto Sandën. (*Nxitojnë*.)

Vjen Alberti, Zenoja i del përpara.

ZENOJA — E?

ALBERTI — Hic, e përcolla, Më ftuan për kafe,
po unë s'pranova.

ZENOJA — Pse?

ALBERTI — Ti e di që unë s'e pi kafenë.
ZENOJA — A për, i humbur që je, or nip! Po
kafeja éshëtë sebepi, more, éshëtë krimbi, sic
thotë Çomja.

ALBERTI — (Sic i fyter) Unë s'jam peshk, dajë.

ZENOJA — Po sytë, nuk i ke në ballë. Nuk e
pe atë vajzë?

ALBERTI — Sot s'm'u duk gjë fare. E pakrehur,
sic që ngritur nga gjumi...

ZENOJA — O perëndi! Po gjendet në dynja vaj-
zë? tillë? / Kaq e blezegme, kaq e tëmbel;
kaq... Ah, djall i madh! Mos luaj komedi
me ne. E kuptova qëkur ia more trastat nga
dora, e kuptova.

ALBERTI — Çfarë kuptove, o dajë?

ZENOJA — Atë de, përgjigjen. Nuk e lamed që
të më përgjigjeshe sot?

ALBERTI — Aha! Shiko, më doli nga mendja. Po
jo, e ke kuptuar gabim. Umës nuk jam da-
kord. Parimi sh't s'jam. Shkul një e ngul një
tjetër, sikur zemra të jetë serë zarzavatesh.
Kjo më duket fyeze.

ZENOJA — Po për, ne nuk éshëtë fyeze që ti të
marto... mos qoftë e bëre se s'ma nxë goja,
po që ti të ngatërrrohesh me një që nuk
e meriton hic fare, me një që ne s'e duam
gjekundi, me një që do të të marrë në qafë.
Ahu! (Ikën i nervozuar. Hap radion në

qoshe të verandës. Çomja do t'i têrheqë ve-
mendjen.)

ÇOMJA — C'hotë profesori?

ALBERTI — Është ngritur pak përgjumshëm.

ÇOMJA — Hë, se ia heq unë mahmurlëkun.

(Merr mandolinën, kujton këngën që kanë
kënduar mbrëmjen e kaluar.)

ZENOJA — (Me vete, po lart.) Bobo! Katastrofa-
le! S'të lenë as të dëgjosh buletinin meteo-
rologjik! More interesohen këta njerëz për ko-
hën, apo jo? Bujkut atje në arë i mbeti pro-
dhimi pa mbledhur, kurse ata mendjen in-
gër-mingër...

ÇOMJA — (E lë mandolinën.) Aha, qenka me të
përjashtmit, profesori... (Del Sanda e Lili me
fustan të ri.) Albert, kjo është një mbesa
jonë.

LILI — Lili!

ALBERTI — ALBERT!

ÇOMJA — Merret me shkencë! Me ato bërthamat
e fizikës...

LILI — Ua, sa mirë.

ÇOMJA — Kokë e madhe! Yyy!

ALBERTI — (Si i prekur.) Pse, kaq të madhe e
kam, teto Sandë?

SANDA — U, i març pleshtat djalit. Mos ia vër
re se kështu e ka gjuhën ky. Nuk shikon ko-
kën e tij që e ka sa një shinik po...

ÇOMJA — Dale të merremi vesh... me tjetër kup-
tim e thashë... (Sanda i bën shenjë që të fto-
jë Zenon.) Lëre, mos më ngatérro me të!

(*Sanda ngulmon.*) O profesor Zeno! Nuk do t  na begenisni p k edhe ne?

SANDA — Zonja Lajde, irdh romi, p r nj  kafe. Na ka ardhur nj  mbes  e Comes.

Mblidhen te veranda e Comes.

COMJA — Profesor, kjo  sht  mbes  ime, Lili.

LILI — M  prezantove nj her ; xhaxha! (*Qeshin*)

COMJA — E humba, ta marr  djall . Ja k shtu hutohem kur m  zem rohet nj ri kot m  kot. E humbas d he b hem karagjoz.

ZENOJA — Po d gjoja parashikimin e motit, mi-repo radios i kan  r t  baterit  d he.

COMJA — C be t  t  z , nuk e kisha me q llim. (*Zenoja  lejt.*) Ashtu, rrofsh, profesor!

ALBERTI — Ti, xhaxha. Come, ke nj  virtyt t  madh. Ti nuk mban m ri kurre.

COMJA — Hi , kur t  mos kem njeri hi  fare! C do t  mbajm  mend nga kjo bote?

ZENOJA — Hii..., s m nd ta prarioj k te filozofi. Sejeta ka d he kontradikt , ka luft  klasash...

COMJA — Aman, profesor, mos na fut q  thelle se u mbyt m. Un  e kam llat m p r k to g meret e vogla, e lagu bishtim, s e lagu.

SANDA — Uluni, rrini, Lili, b na kafet . Profesori e ka dob si kafen . Ashtu si di ti ama! (*Lili hyn brenda.*) Ama kjo mbes  ion , zonja Lajde, jo se dua ta l vdoj, po b n ferk. P p p  hilkoqire q   sht  pik rena! E do p r q ndisma, e do p r triko, e do p r grep! Apo kur hyn n  avl mend! Dridhet vegla.

Lere, lere! Ç'i sheh syri, ia bën dora.

LAJDJA — Korçare, domosdo!

SANDA — Nami ka dalë nga ne të njëhershmet, se këto të sotshmet nuk e çajnë kokën shumë. Kurse Lili, ndryshe Lili.

Hyn Lili me kafetë dhe ua jep.

ZENOJA — Ö! Me ajkë, tamam siç më pëlqen mua. Ekstra.

SANDA — Përmbyse filxhanin, profesor. (Çomja kollitet) Hë, se s'është ndonjë gjë me zarrar, po hë! Të qeshim një cikë!

ZENOJA — Di t'i shohësh?

SANDA — Unë jo, po di Lili...

LILI — (E mërzitur) Teto Sandë!

SANDA — Hë, se tanët jemi, s'na del llafi.

ZENOJA — C'është e drejta, unë nuk iu kam bësuar kurrë këtyre filxhanëve, letrave e c'janë ato fallet e tjera, mirëpo njëherë, në një moment kritik të jetës sime një kurbatkë e ka párathënë se unë dhe... (Stepet) Domethënë, kurbatka e gjeti atë që më ndodhi më vonë. (Përbys filxhanin.)

ALBERTI — (Lilit) Vërtet dini t'i shikoni?

LLILI — Ehë! M'a ka lënë gjyshja me amanet.

ZENOJA — Përmbyse, Alber, përmbyse edhe ti!

ALBERTI — E pse? Unë e di fatin tim.

ÇOMJA — Nuk e bën ai. Ai është, i shkencës!

(E përbys filxhanin e Albertit. Ia merr këngës «Kur më vjen burri nga stani»)

SANDA — Lëre atë këngë se ua nxore veshët komshinjve. Lëre ta marrë çupa.

LILI — (E turpëruar). Ua, po s'vete, teto.
ZENOJA — Këndon me grupet artistike çupa?
ÇOMJA — O, të kënduar! Këndon që ç'ke me të.
(*Sanda e prek fort.*)

SANDA — Ka hequr dorë. Kështu në shtëpi nga-njëherë... Mos ki turp, të keqen, tetova se këtu jemi tanët.

LILI — (Qëron zërin.). Xhaxha «syqkën?» (Këndon)
«Syçka si ato të tuat»... (Duket Jëta. Alberti largohet me nxitim. Ata shohin njëri-tjetrin në sy. Zenoja shikon motrën. Fërkon durart nga kënaqësia dhe çohet.)

ÇOMJA — Po dale, çupa nuk i ka parë akoma...
ZENOJA — Mua më falni, duhet të shkoj tek shoku Milo. Dje ai u pezmatua ca prej meje.
LAJDJA — Po ngrihem edhe unë. Do të qëroj peshkun. Faleminderit dhe na urdhëroni ta pimë kafen nga ne.

Pauzë. Sanda, Çomja e Lili shohin njëri-tjetrin.

ÇOMJA — Ç'bëhet kështu?
SANDA — I kam parë nja dy herë bashkë, po s'më shkoi mendja për keg.
ÇOMJA — Ndofta s'kanë gjësendi.
SANDA — E, e në atë krah fli ti. Atij i ndritnin sytë si të maçokut.
ÇOMJA — Ata thonë se është pleksur me atë aktorkën.
SANDA — Një atje, një këtu. Një për dimër, një për behar.
ÇOMJA — Pusho, mos fol budallallëqe tanë!

SANDA — Më marrtë të keqen e mbesës. Bagabondi! Mos u mérzit, të keqen tetu Sanda. S'të lë unë të shkelësh në dërrasë të kalbur. Sefte na u duk i tapinosur, po paska qenë thëngjill i mbuluar. Bagabondi! (*Lili rrëmbeñ valixhen.*) Prit, ku vete të keqen tetua?

LILI — (Me lot në sy dhe me inat.) Mos më thërrisni kurri për mblesërira, kurri. (Ikën)

Sanda mbledh filxhanët.

COMJA — Ç'e djallosem! Hajt, hidhna fall me filxhanat e kafesë, tanj s'na mbeti gjë tjetër.

TABLOJA E KATERT

Drekë për familjen e Milos në verandën e Zenos.

ZENOJA — (Ngre gotën.) Ta pimë dhe nga një, Milo! Me eks, ja kështu, vëllazërisht. (I kap krahun.)

IZMINI — Jo me fund, aman se i bën keq përmëlcinë!

MILLOJA — Në djall të vejë mëlcia! Hajde, vëllazërisht! Kështu u mbledhshim!

ZENQJA — Keq bëjnë vetëm pijet me ngjyra, jo

rakia. Një shoku im tepër i ngushtë, që thua ti, u kurua në Vjenë nga një sëmundje e rëndë. Kur do të ikte i dha si dhuratë profesorit një qilloshe me ralki Muskat. Era trëndafil! Profesori po profesor. E çoi më parë në laborator. Të nesërmen i thotë: Ke me bollëk nga ky ilaç në Shqipëri? Kam, i kish thënë shoku im. Të pish nga dyqind gram çdo mëngjes për pastrimin e gjakut! Ja kështu!

MILOJA — Këtë rast të profesorit austriak e kam dëgjuar dhe unë nga një pedagog i Jetës në Institutin e Arteve. (*Jeta e sheh me ngulm.*) Domethënë... që ka dhënë më parë mësim në Institutin e Arteve.

ZENOJA — A të tha se kush e kishte nxjerrë atë raki?

MILOJO — Jo, këtë nuk e dintë.

ZENOJA — Unë! Unë ia kisha dhënë atë shishe, kur e përcolla. Pijeni pa merak! Gëzuar!

ALBERTI — Mirë që po mban kohë me shi, ndryshe kish burrë nënë të pinte raki në plazh!

ZENOJA — Po ju gratë? S'ka birë? Albert, or bir! Po birën ku e kemi?

ALBERTI — Qëparë s'kishte birë me shishe. Atë të fuçisë ti nuk e do.

ZENOJA — Me shishe a me fuçi, veç pa birë mos na lër!

IZMINI — (*Së bijës*) Shko dhe ti na i sill ato japrakët...

LAJDJA — Po ç'është kjo? Sot ju kemi ftuar ne për drekë! S'ka lezet!

IZMINI — Se mos prishen ... s'durojnë në vapë, sigurisht...

ZENOJA — Japrakët janë dobësia ime!

ALBERTI — Atëherë ne mund të shkojmë të dy? (Pauzë)

ZENOJA — Shkoni, bashkë e keni rrugën. (Largo-hen të përcjellë nga shikimet e prindërve. Pshërëtim.) Si çift pëllumbash!

LAJDJA — Janë në moshën më të bukur.

IZMINI — Veç të kenë mend në kokë, sigurisht...

ZENOJA — Përderisa kemi ne mend, do të kenë edhe ata. Çdo gjë nga ne varet!

MILOJA — Eh, jo vëlla Zeno, rinia i rregullon vetë punët e saj. S'të pyet shumë ajo.

ZENOJA — S'e pranoj! S'jam dakkord! E kemi bërrë edhe një herë këtë bisedë, bashkë me Çomen...

IZMINI — (Ndërhyn shpejt, si për të pajtuar gjendjen.) Çomja po, ai të shkrin, sigurisht...

LAJDJA — E ftuam, po qe pa qejf. I ka maisur një nga ato të djegurat...

ZENOJA — Ia katranosi e shoqja me ato lyerjet që shpijk. Njëherë me pjepër, njëherë me kastraveca turshi. (Zhurmë te kabina tjetër.)

Zëri i Sandës — Rri aty se lamë nam. Mos bëj budallallëqe!

Zëri i Çomes — O po do të dal sikur qeni qepën të hajë! (Del me rrobëdëshambër, zbatbur. Sanda pas tij.)

ZENOJA — Urdhëro, shoku Çome, urdhëro...

LAJDJA — Ne ju ftuam, por Sanda na tha që...

SANDA — Po ç'ne, ai nuk u nis pér te ju! Ai...
kérkon tē lahet nē det!

IZMINI — Nē kêtë kohë?

LAJDJA — Veson pakëz shi.

ZENOJA — Ka dhe dallgë!

ÇOMJA — S'duroj dot më! Gurë s'paskan rënë!
Kam ardhur nē plazh tē bëj banjë e jo tē
rri mbyllur.

MILOJA — Po lahuni! Uji i detit ju bën mirë edhe
pér plagët.

ÇOMJA — E më rrofsh! Dëgjo, Sanda, dëgjo! Ika.
Mirupafshim... nē det!

SANDA — Thomaaa! Thomaaa!

ÇOMJA — (Nga cepi i skenës) E, ç'ke?

SANDA — Kujdes mos tē humbasin dhëmbëët!
(Të tjerëve) I ka tē vëna, i lëvizin...

MILOJA — Mos u bëj merak, ai më ka thënë se
është notar i mirë.

SANDA — Ai s'di tē bëjë not fare! Pllaq-plluq,
nē breg...

ZENOJA — Ah, ç'qejf është tē lahesh nën shi!

IZMINI — Sigurisht!

ZENOJA — Pilkat puk-puk, tē ngrohta, tē èmbla!

IZMINI — Si nē dush!

MILOJA — Mund tē rrish sa tē duash nën shi dhe
tē mos lagesh fare!

ZENOJA — Sikur mos më ngiste reumatizma, do
ta ndiqja pas me gas!

LAJDJA — Po kemi mysafirë, Zeno! (Sandës)
Urdhëroni tē bëjmë muhabet.

SANDA — (Ftohtë) Faleminderit, po siç e shikoni

unë jam veshur se do vete pér një vizitë.
(*Largo het.*)

ZENOJA — Unë... i dashur Milo, jam pér dashurinë.

MILOJA — Domethënë, si pér dashurinë?

ZENOJA — Se dua të ngas më tej atë bisedë që na i ndërpreu Çomja. Jam pér dashurinë e të rinjve. Që ata ta ngrenë familjen në bazë të dashurisë.

IZMINI — Me kusht që dashuria të jetë e kontrolluar nga prindërit, sigurisht.

ZENOJA — Jam pér dashurinë e mirë, jo pér dashurinë pa fre:

LAJDJA — Jo pà frè; domosdo,

ZENOJA — Me arsy, me logjikë.

MILOJA — Ka logjikë rimia, ka...

ZENOJA — Që qdo gjë të bëhet e matur dhe e pjekur, më parë të hidhet themeli, pastaj të riqrihet pallati. (*Pauzë*)

IZMINI — Po këta, pse u vonuan kaq?

LAJDJA — Kushëdi, ndoshta s'po gjejnë birë.

ZENOJA — Gjejnë ata, mos u bëni merak. Pra, thashë, dashuria si bazë, por ç'duhet para saj? Para saj duhet njohja. Njohja familjare është më e sigurta. Njohja sjell miqësinë. Ja, si pér shembull nè, meqë fa fjala. Miqësia e familjeve sjell miqësinë e të rinjve, miqësia e të rinjve sjell dashurinë. Ky është zinxhiri i jetës, zinxhiri më hallka të pâkëputura.

IZMINI — Kështu, tamam kështu, sigurisht.

MILOJA — Na kënaqë, o Zénó!

ZENOJA — Njeriu duhet të bisedojë për gjëra serioze.

Kthehet Çomja plot entuziazëm, me mantonë veshur.

ÇOMJA — (Nga larg) Auuu! Thagmë! Gjynah që s'e provuat, kur të mos këm njeri!

ZENOJA — Plaq-plluq në breg, si zhabat, ë Çome?

ÇOMJA — Ma hodhe. Një me zero, mbaje mend profesor. (Hyn në kabinë.)

Vijnë Alberti dhe Jeta.

ZENOJA — Po hë të shkretën, një orë për një shishë birë!

ALBERTI — Kështë shumë njerëz.

ZENOJA — (Ngacmues.) Çudi! Kur vete unë, marr për dy minuta.

ALBERTI — Ty të japin pa radhë.

ZENOJA — Pse? Apo si plak njeri!

MILOJA — O! Ti plak?

ZENOJA — Nipi e thotë.

ALBERTI — Unë do të thosha tjetër gjë.

JETA — Juve ju japin pa radhë, sepse dëlkeni i rëndësishëm, xhaxha Zeno!

ZENOJA — (I llastuar) O!

ALBERTI — Këtë do të thosha edhe unë, po ti s'më le.

ZENOJA — Bukur! Rinia ia merr nga goja mendimet njéri-tjetrit. Ja këtij i them unë unitet! (Mbush gotën.) Për rininë!

MILOJA — I paçim dhe të na zbardhin faqen.

IZMINI — Me mend në kokë, sigurisht.

LAJDJA — Dhë me një fat të mirë, ishalla, që
të shkujdesemi për jetë edhe ne dhe ata.

ZENOJA — (Provon japrakët) Mm... të mrekullu-
eshëm këto japrakë.

IZMINI — Ju bëfshin mirë, i ka gatuar Jeta.

ZENOJA — Ah, kjo vajza juaj po më befason
përditë. Provoji, Alber.

ALBERTI — Unë nuk i ha japrakët.

ZENOJA — Po ti provoji një herë. I ka gatuar ajo,
Jeta!

ALBERTI — (Provon një.) Qenkan të shijshëm.
(Merr edhe një tjetër.)

LAJDJA — Nuk i kishte pëlqyer kurrë.

ZENOJA — I pëlqeu tani, këto të Jetës. Aj, aj,
ç'të gatuar, mor zot. Ja një kuzhinë e ti-
llë ia zgjat jetën njeriut.

ALBERTI — (Me shaka) Del se Jeta, po na zgjat
jetën...

ZENOJA — E kam seriozisht! Nëpërmjet artit të
kuzhinës, gruaja ose ia zgjat ose ia shkur-
ton jetën burrit të saj.

MILOJA — Kush e ka thënë?

ALBERTI — Daja im! (Qeshin)

IZMINI — Oj, ç'u kënaqëm sot! Nuk do ta harroj.
kurrë.

LAJDJA — Rrini dhe pak.

MILOJA — Faleminderit! Vërtet u kënaqëm.. Ta-
ni ë kemi radhën ne.

IZMINI — Sigurisht!

Ndahan. Dalin Miloja, Izmini e Jeta.

ALBERTI — Dajë! Unë jam dakord! E pranoj!

ZENOJA — (I befasuar) Si e pranon! Çfarë pranon?

ALBERTI — Atë që keni zgjedhur ju.

ZENOJA — (Pa frysme) Që e kam zgjedhur unë! Që do të thotë se ti... që do të thotë se... Fol se më mbeti zëmra! Fol, Alber!

ALBERTI — A nuk deshët ju të më afronit me një vajzë?

ZENOJA — Po, po, po!

ALBERTI — (Si me turp) Epo ja... unë dhe ajo... si të ta them...

ZENOJA — Po hë de! Hë, se na plase buzën! Motër! Motër!

ALBERTI — Prit, dajë, lermë të shpjegohem më parë...

ZENOJA — S'të le. S'dua. Mos fol më, se prishet. Motër, Lajde...

LAJDJA — (Del) Ç'është, Zeno? Ç'keni ju kështu?

ZENOJA — Motër... Ai e do!

LAJDJA — E do? Po cilën? Atë të parën apo...

ZENOJA — Këtë të dytën. Vajzën e Milos. Mos e ul kokën, Alber. Dashuria s'është turp.

LAJDJA — Albert! Zeno! Po flisni aman, se më iku mendja! Vërtet?

ALBERTI — Përderisa edhe ty të pëlqeu, mama...

LAJDJA — (E përqafon) O, më rrrofsh, o bir!

*Zenoja hyn në kabinë, ndërron këmishën,
lidh kravatën.*

ALBERTI — Ku vete, dajë?

ZENOJA — Ti arriji e tu kérkoj dorën zyrtarisht.

ALBERTI — (*I stepur*) — Tu kérkosh dorën? Po unë nuk desha tē them kêtë.

LAJDJA — Po si kështu, Zeno? Kaq shpejt! Kaq papritur?

ZENOJA — Hekuri trihet sa është i nxeh të.

ALBERTI — Më keqkuptove, dajë. Rri, ulu, dëgjomë njëherë. Nuk thashë ta mbarojmë që sot.

LAJDJA — Jemi dhe tē papërgatitur s'kemi as gjë këtu.

ZENOJA — Sot japim fjalën, fejesën e shpallim kur tē kthëhem i ngë plazhi.

LAJDJA — Sapo u njo hëm me ta...

ALBERTI — Mirë e kâ mëthajë, pse tē nxito hemi?

LAJDJA — Të pyesim njëherë ç'familje janë, ç'biografi kanë...

ZENOJA — Dukën atë.

ALBERTI — Shiko sâ mirë arsyetoni mamaja.

ZENOJA — O karavidhe, karavidhe! Me këtë pâvëndosmëri, do tē mbeteshi pa martuar.

ALBERTI — (*I shkël sýrin*) Nâ i heq dera.

ZENOJA — Kurre! Nuk lëjoj tē përsëritet dy herë i njëjtë gabim. Pse nxitohem tûnë? Përuju tē dy, që t'i kâloni si tē fejuar shtatë ditët e plazhit që n'a kânë mbetur. (*I vëndo sur*) O sot, o hiç! (*Lidh kravatën dhe e vë.*) Lëmtifia fitohet më sulim.

LAJDJA — Derisa ti je kaq i bi ndur, vëlla! Albert, tē keqen mamaja, mos ia prish!

ALBERTI — Unë s'ia prish, mama, por kam fri-
kë se mos e katranos fare.

LAJDJA — Derisa e merr ai përsipër!

ALBERTI — (Zenos) Jo kaq rrëmbyer, dajë, pér-
mblidhi mendimet.

ZENOJA — Hekurin... të nxeh të.

ALBERTI — Të nxeh të, por mund të ta kthejnë
nga myka dhe të rroftë vrulli që ke ma-
rrë pastaj.

ZENOJA — Si të ma kthejnë? Kujt t'ia kthejnë?

ALBERTI — Ty, mua. Mund të mos duan, mund
të mos u kem pëlqyer unë.

ZENOJA — Ah! Të mos u kesh pëlqyer ti! Bu-
dallaliëk më të madh, s'mund të thoshe. Të
mos u kesh pëlqyer ti! Trushkulur janë? Të
mos u kesh pëlqyer ti!...

ALBERTI — Megjithatë, biseda duhet sjellë rrro-
tull e rrrotull. Më parë t'u matët pulsi.

ZENOJA — Diplomacinë e kam zanat vetë.

ALBERTI — Po sikur të bën im një provë më
parë?

ZENOJA — (I habitur) Një provë?

ALBERTI — Jò për gjë, po që të mos ngatërrro-
hesh. Ja, unë jam Miloja. (Ulet) Ti, mama,
je Izmini. Ulu aty. Kurse ti, dajë, je vetë
Zenoja. Dil pak. Ti vjen nga jashtë. Trokit.
Trokit de! (Zenoja bën siç i thotë Alberti)
Urdhëro! (Çohet) O mirë se erdhe, Zeno!
Sä mirë bëre që erdhe, se mund të bëjmë
një dorë tavllë! Urdhëro, ulu! (Zenoja ulët.
Pauzë. Alberti kollitet.)

Fol, e ke ti radhën.

ZENOJA — Unë, po, po unë. (*Çohet hyn në rol.*)
Zoti Milo!

LAJDJA — Pupu! Miloja klasë punëtore, ky zotë
Milo.

ZENOJA — Më fal. Shoku Milo! Kam nderin t'ju
kërkoj dorën e vajzës suaj, Jetës, për nipi
tim Albertin, fiziikan, kandidat për gradë
shkencore. (*Zëri vjen duke iu ulur, turbu-
llohet.*)

ALBERTI — Po dale njëherë, shoku Zeno, ta ma-
rrim shtruar, si kështu menjëherë, papritur
e pa kujtuar?

ZENOJA — Hekuri rrighet sa... (*Kruan kokën.*) Hm...

ALBERTI — E shikon? Edhe kërkeshë sipas mo-
dës së vjetër, me stilin e shekullit të nën-
tëmbëdhjetë. Zoti Milo, ndërrojmë rolet një
herë?

ZENOJA — Po mirë...

ALBERTI — (*Vë kapelen e i merr llullen.*) Unë
jam Zenoja, ti Miloja. Ti, mama.

LAJDJA — Unë, po Izmini.

ALBERTI — Hm... vëlla Milo, — i thua ti — er-
dha se aty te ne, në sy të të gjithëve, s'ta
i hashë dot një shqetësim që kam. Nuk e
di në të ka rënë edhe ty në sy...

ZENOJA — Më ka rënë.

ALBERTI — (*Jashtë rolit*) Ja e djallose prapë!
Po ç'i ka rënë në sy Milos kur ne s'kemi
lënë asnjë shkak? Më ka rënë thotë.

ZENOJA — Pse, nuk më ka rënë?

ALBERTI — Jo. (*Në rol.*) Pra, s'di në të ka rënë
në sy.

ZENOJA — Jo, s'di gjë. Përse është fjala?

ALBERTI — Ata, domethënë nipi im, dhe vajza juaj, mos vallë po shoqërohen pak si tē pér?

ZENOJA — Të rinj janë ata edhe do të shoqërohen, edhe do të miqësohen. Rinia ka rrugën e saj, — thotë ai.

LAJDJA — (Përpjek duart) Të lumtë, Zeno! Tamam! Nafet e Milos! Tamam!

ALBERTI — Pusho, mama, ti je Izmini.

LAJDJA — Më fal.

ALBERTI — (Me rol.) Të rinj xhanëm, po ja them, kushedi sesi vjen puna se njerëzit e kanë gjuhën të gjatë.

ZENOJA — Thashethemet nuk duhet të na stepin. S'pyet rinia pér to. Thotë ai.

ALBERTI — E kam më shumë pér Jetën, se është vajzë dhe s'dihet si i del fati nesër. Që tē mos e prishim miqësinë që zumë.

LAJDJA — Përkundrazi, ta shtojmë, sigurisht!

ALBERTI — Bukur, mama! (Në rol) Domethënë, shoku Milo, ju nuk e shikoni me sy të keq këtë afrim?

ZENOJA — S'do mend ikjo...

ALBERTI — Po sikur ky afrim tē bëhej edhe më i madh, domethënë sikur.

ZENOJA — (E ndërpert) Me trashëgime!

ALBERTI — (Heq llullën) Ja, prapë! Fjalën e fundit vete e thotë qysh tanë!

ZENOJA — Kjo më doli nga shpirti. Gabim është?

ALBERTI — Po domosdo! Se ai ta kthen ndryshe.

Më vjen keq, shoku Zeno thotë, por atë dje pôsa u njohën. Këto janë afîrme të pashkaktojnë drama. Je dhe profesor, pale!

(Pazë)

ZENOJA — E thotë edhe këtë?

ALBERTI — E thotë dhe të bllokoni fare.

ZENOJA — Më bëre kokën dhallë!

ALBERTI — E shikon që s'është e lehtë?

ZENOJA — S'je i zoti ta nxjerrësh qimen nga qulli dhe tani më lot mua si ariun.

ALBERTI — Deri dje më akuzoje se jam shthurur fare...

ZENOJA — Më atë tjetrën, po. Me këtë rri si hu gardhi. Kur kam qenë në moshen têndel... (Cohet me vrull.) Unë do t'i bëj gjérat sic di vetë! (Niset.)

LAJDJA — Zeno, aman, mos të keqen, se mos e prishim fare. Do të më mbetet pilkë për atë vajzë.

ZENOJA — Kalatë pushtohen me sulm. Do të fitoj unë!

ALBERTI — Të paktën shiko më vonë, dajë, sapo u ndamë!

ZENOJA — Këtë e kisha menduar edhe pa ty. Tani do të yete në «Turizmi»

(Del)

LAJDJA — Sa frikë që kam. Më përpëllet zemra si zog.

ALBERTI — Mos u shqetëso, mama, gjithçka do të vejë siç duhet.

(Del)

Në paraskenë. Sanda që kthehet nga vizita.

SANDA — (Më vete). Hë, m'u bëfshin kurban! Unë u jap ujë në bisht të lugës. Qëkur i pashë seftë kur llaforeshin gojë më gojë, gili-vili, më ra era! S'është mëmbyn thashë, që këtë të mos njihen që më parë, po ç'kanë që s'e rrëfejnë pa? (*Shikon Zenon që bën shëtitje*.) Uuu, Zeno ziu, shikoj si krekojet! Domosdo, është i kënaqur tjetri, një merak që kish e nxori. Nipi nuk e do aktoren. Nipi na u sevdallis pas çupës së Milos. Të keqen e mendjes, Zeno ziu! Deshe të shpëtoje nga shiu dhe re në breshër. Se nuk iu pëlqente mbesa jonë, që ishte si drita. I marci pleshtat Lilit! (*Niset duke murmuri-tur drejt Zenos*.)

ZENOJA — Sandë! Na moj, Sandë!

SANDA — U, më ndje, se s'të vura re.

ZENOJA — Ç'na solle ndonjë gjë të mirë?

SANDA — Hiç asgjë, vetëm ca melhem për plaqët e Thomait.

ZENOJA — A, të qe e mundur ta merrja tani me vete atë çakshirin tënd. Ajo kurajua e tij më duhej tani.

SANDA — U, po ta kishe marrë. Ai s'ka zënë shtratin që...

ZENOJA — Nuk bën. Duhet të shkoj i vetëm.

SANDA — Po ku kështu? Ndonjë hall, apo ndonjë hairllëk?

ZENOJA — Të dyja bashkë, motër Sandë, të dyja. Në fillim halli, pastaj hairi.

SANDA — Uuu!

ZENOJA — Hallin e kam vetëm unë. (*Me zë të ulët*) Ta them vetëm ty, sado që hiqem trim dhe i gojës, gjë që dhe jam për raste të tjera, për këto gjëra, s'ia them hiç fare. (*Pauzë. Sanda pret*) Hiç mos më pyet.

SANDA — Papagjene, ju e dini, sikur unë t'u lutat! (*Ikën si e fyer.*)

ZENOJA — Dale de... po ta them se mos të mbetet hatri.

SANDA — Nu k më mbetet, jo. Ne s'jemi nga ata që s'lënë vërë e vërushkë pa rrëmuar.

ZENOJA — Do ta them se e di që prej teje s'më del fjala.

SANDA — Sa për atë, zëre sikur e ke hedhur në pus.

ZENOJA — Do të kërkojmë vajzën e Milos për Alberin.

SANDA — Uuu!

ZENOJA — E papritur, ë?

SANDA — Çoç na kishte rënë era, por...

ZENOJA — Alamet vajze! E urtë, e bukur!...

SANDA — Sa për e bukur, po.

ZENOJA — Sikur pikoi nga qielli këtu në plazh për ne.

SANDA — E, e...

ZENOJA — Çift i mrekullueshëm. Gjithë të ardhmen përpëra. Të përpinqemi tanë që t'u

hyjë studimeve të larta në ndonjë degë të mirë. Farmaci, për shembull. Ose arkitekturë.

SANDA — S'ke gjë asaj ane, ajo i ka nisur studimet me kohë.

ZENOJA — I ka nisur? Jo, e ke gabim.

SANDA — Uuu! Mua sa po më tha kushërira e tyre e parë. Jetën e kemi në Institutin e Arteve, tha.

ZENOJA — Të Arteve? Po përse? Për muzikë, ndoshta?

SANDA — Jo...

ZENOJA — Për pikture?

SANDA — Për aktore teatri!

ZENOJA — Nuk është e mundur! Unë i pyeta vetë. Nuk është e mundur! Ti e ngatërron me ndonjë tjetër. I ati më tha se...

SANDA — E, e, ashtu e fshehën sefte që të mos vinin ta merrnin nëpër shfaqje ata të shtëpisë së pushimit. (*Zenoja ulet në ndenjëse*) S'u vë dot faj, do të çlodhet vajza. Me trashëgime, Zeno.

ZENOJA — (*Zë kokën me duar*) Ç'është ky fat i gremisur që po na ndjek? E para aktore, e dyta aktore! Sa teatro kemi? Sa aktore ka bota? Na janë qepur aktoret, familjarisht. (*I vendosur*) Jo, s'duhet ta lejoj. As këtë s'duhet ta lejoj! Duhet t'ia shkul nga zemra. T'ia shaj... (*Stepet*) Hm... ec e shaje po munde, pas gjithë atyre fjalëve që ke thënë. «Ti ma mbushe mendjen, vëlla... Zeno:

Ti ma ngrite në qiel, dajë». Deh, o bela, deh!

Në skajin tjetër Alberti e Jeta.

JETA — Daja!

ALBERTI — E shoh.

JETA — Po pse rri ashtu vallë?

ALBERTI — S'e kuptoj. Duket shumë i vrarë.

JETA — Të ketë vajtur thua? Ah, pa shiko! Më duket se i ka sytë me lot.

ALBERTI — Vërtet, duket shumë i prekur. (*Supozon.*) Pra, babai yt ka pranuar, fjala është dhënë dhe ai tanë është i mallëngjyer nga lumturia.

JETA — Mund të duket njeriu i lumtur ashtu??

ALBERTI — Ju aktorët i gjykonit njerëzit sipas skemave teatrale. Sipas teje, ai duhet të hedhë valle në rërë.

JETA — Ke të drejtë. Njerëzit e lumtur përlotën më shpejt se të tjérët.

ALBERTI — Të shkojmë e ta takojmë.

JETA — Do t'ia tregojmë të gjitha, të gjitha?

ALBERTI — Të gjitha.

JETA — Nuk do të na zemërohet? Se mos i duket sikur e kemi vënë në lojë?

ALBERTI — Përkundrazi, do t'i bëhet qejfi. Do t'i duket vetja personazh drame. Ai vdes për teatrin.

JETA — Vdes për teatrin, por mund të vrasë aktoret ama! Shiko vetë. Tamë porsa u bë dhe mua më vjen turp. Ika!

ALBERTI — Prit, Jeta. (*Ajo pret në një cep. Al-*

berti i afrohet Zenos gjithë gas.) Dajë!

ZENOJA — A! Qënike ti!

ALBERTI — (Stepet) Dajë! Ç'ka ndodhur?

ZENOJA — (I qetë) Asgjë e veçantë.

ALBERTI — Ti... sikur do të...

ZENOJA — (Indiferent) Nuk vajta. U pendova. Mamaja kishte të drejtë. Edhe ti kishe të drejtë kur thoshe që s'duhet të ngutemi. Unë e kisha marrë rrëmbyer, e pranoj gabimin...

ALBERTI — Po dale se ne me Jetën... Po tallesh me mua, dajë?

ZENOJA — Unë nuk tallem kurrë! Unë them se duhet të pyesim, të marrim informata sa më të plota, si studion, ku studion dhe... përse studion. Ti mos u bëj merak. Fundja, shoqërinë mbaje, por me takt e me kufi. Të tjerat, lermi mua.

ALBERTI — Unë s'jam karagjoz, dajë Zeno. (Del me vrull.)

TABLOJA E PESTË

Po ajo pamje. Mëngjes. Zenoja, Alberti, Lajdja në verandë. Ndihet zemërimi i dyanshëm dajë — nip në qëndrimet e secilit.

ZENOJA — Frykérka një erë sot që...
Heshtje.

LAJDJA — Albert! Daja po të flet.

ALBERTI — S'e kisha mendjen. Ç'thotë?

LAJDJA — Fryn erë thotë, je veshur hollë...

ALBERTI — Unë jam i djeguri, të tjerët dridhen nga ethet. Çudi!

ZENOJA — Nuk dridhet njeri. Masat i kemi marrë, presim sa të hapet koha.

ALBERTI — Kemi ditë që presim të hapet, mirëpo ajo pus që pus.

LAJDJA — Albert! Zeno! Aman se m'u ngrit tensioni. Hidh thumba njeri, kthe tjetri, llafet po degë më degë! Fjalosuni si njérëz, se aqjë s'po kuptoj.

ALBERTI — Ç'të kuptosh, nënë! Ja, rrojmë pranë detit, deti ka karavidhe, ne po mësojmë zakonet e tyre.

ZENOJA — Karavidhet s'na duhen se kemi urtësinë e përvojës sonë. Pyesim dashamirët, ata na përgjigjen, prapë pyesim...

ALBERTI — Nën rrogoz.

ZENOJA — Nuk do të vemë tellallin, familja jonë ka cipë.

ALBERTI — Unë s'kam më, më ra (*Ngre zërin.*) E kuptoni ç'po bëni, apo jo?

ZENOJA — Shëjt! Të lutem shumë. Zërin. Volumin. Apo s'i ka veshët bilbil ky Çomja.

ALBERTI — Siç ka veshët, ka dhe zemrën ai. S'dua të fsheh asgjë, le ta dinë të gjithë, ta shohin se si e dredhim ne këtu. Dje në orën dy thoshim: ja një vajzë e përsosur që na pikoi nga qielli. Në orën tre thoshim: ja një vajzë e sterosur që s'dihet nga na mbiu!

ZENOJA — Na e kishin me hile. Na e fshehën profesionin.

LAJDJA — Ah, ky profesioni, që na hëngri shpirtin! (*Pauzë*) Albert, ulu të hash mëngjesin. Ja, mjalti.

ALBERTI — (*Duke dalë*) Të kam thënë, mjaltin nuš e dua, le ta hanë ata që ngrihen nga gjumi me gojën farmak. (*Të parmaku*) O xhaxha Çome!

ÇOMJA — (*Nga brenda*) O, mor, o! (*Del*)

ALBERTI — Do të vish të lahem?

ÇOMJA — E bëra një herë atë budallallëk.

ALBERTI — Eja, se ne të dy jemi të djegur. Deti na bën mirë. (*Ikën me vrap*)

ÇOMJA — (*I habitur nga kjo ikje, Lajdes*) Ç'ka djali?

LAJDJA — (*Comes me shenja nga Zenoja për gridjen*) Sanda u kthye nga Durrësi?

ÇOMJA — Jo! Ia ka shtuar muhabetit me kushëri-rën. Ka bërë dhe telefon, i kripsha mendjen.

LAJDJA — Kushedi sa u mërzite.

ÇOMJA — Hiç, ikur të mos kem njeri! Apo s'fjeta si shqerrë. S'është keq të mbetesh beqar për ca kohë! (*Shikon Zenon që hiqet indiferent*) Vetëm për ca kohë se përgjithnjë të merr lumi. (*Lajdja hyn brenda. Heshtje. Çomja diçka kërkon nëpër xhepa*) Py, të çiftë ujku, o Çome! (*Zenos, i cili s'do t'i flasë*) Pra-pë paske hyrë në të thella, profesor!

ZENOJA — (*I bezdisur*) S'mund të jemi gjithnjë ku rafsha mos u vrafsha.

ÇOMJA — Mendohu, mirë bën. Po s'u mendua e di q'bën njeriu? Budallallëqe bën!

ZENOJA — A, jo, jo. Moshës sonë nuł i lejohen ato, ka pjekuri ajo.

ÇOMJA — Bën, ore, kur të them unë! Ja, edhe unë dora vetë, bëj budallallëqe. Hiç mos u çudit! Ta zemë, e di ti pse e sollëm atë mbesollkën, Lilin, ikëtu?

ZENOJA — E nga ta di unë?

ÇOMJA — Që ta njihnim me nipin tënd, me Alberin, pa «t». Se mos bëhej kësмет dhe i... ashtusnim...

ZENOJA — Ua! S'më vajti mendja fare.

ÇOMJA — Si do të të vente? Ti ia kishe vënë syrin asaj tjetrës.

ZENOJA — Ia kisha vënë, po q'e do...

ÇOMJA — U bëre pishman? (*Zenoja pohon me krye,*) E ke galbim. Goxha çupë është! Për të pirë në kupë!

ZENOJA — E mire është qenia...

ÇOMJA — Qenia? Pse qenia?

ZENOJA — Se më pëlqen. Po q'e do? Po si mall: aktore!

ÇOMJA — Studente pér aktore.

ZENOJA — Njëlloj është, si një qepë e prerë më dysh që djeg e përvëlon.

ÇOMJA — (*Me djallëzi*) Po sikur ta lërë shkollën? Thuaji, e do nipin?

ZENOJA (*Vetvetiu*) E dua.

ÇOMJA — Veri ferrën shkollës.

ZENOJA — S'besoj ta bëjë. I ka bërë dy vjet, (*Pauzë*) Lëmsh i ngaterruar...

ÇOMJA — Ama po të duan ata, ta çdredhın sa të
thuash pesë.

ZENOJA — Si?

ÇOMJA — Një të futur krahun, dy dëshmitarë në
gjendjen civile dhe hajde me trashëgime një
herë e me jetë.

ZENOJA — (I sigurt) A, jo, jo! Në ka gjë për të
cilen jam i bindur si buka që ha, kjo është
se Alberti nuk ndahet kurrë nga ne.

ÇOMJA — (I ngrysur) Ashtu?

ZENOJA — Kurrë!

ÇOMJA — Ia paske futur këmbët në një këpuçë
djalit. Djalli vetë paske qenë, ia ditke edhe
zorrët e barkut. (Pa pritur) Ti qenke shpirt-
kazmë, more!

ZENOJA — (I befasuar) Çfarë?

ÇOMJA — Po e sjell djalin vërdallë si atë cjanin
kur e nxjerrin në pazar. Katil paske qenë!

ZENOJA — Të lutem shumë!

ÇOMJA — Hiç mos m'u lut. Ti qenke si ky shiu
që na është qepur në plazh. Lëre, rinimë! Ajo
do diell, ti vuuu... shi! Ja mirëmbetsh! (Lar-
gohet)

ZENOJA — Na, shoku Çakshiri! Çalkshiri/ (Del Laj-
dja nga kabina.) Unë shpirtkazmë! Unë katil!
Dhe ma thotë ky, që s'ka lënë cjac pa the-
rrur! (Vëren Lajden.)

LAJDJA — Ta thotë... (Pauzë) Po e marrim në
qafë djalin, Zeno!

ZENOJA — Për të mirën e tij po përpinqemi, mo-
tër.

LAJDJA — Mua vajza më pëlqen. Aq më pëlqen

sa kur e mendoj që po prishet, më vjen të qaj.

ZENOJA — Unë po mbledh informata. Ja, një lëtër ma dérguan. (*E nxjerr*)

LAJDJA — (*Pa e parë*) Gënjesħtra!

ZENOJA — Mirë flasin. Njeréz tē ndershëm, biografi e mirë. Miloja mjeshtér i zanatit, e shoqja rrobaqepëse, pak llafazane thotë...

LAJDJA — (*Ia merr letrën, e përpin me sy*) Epo atëherë...

ZENOJA — Tani pres lajmet për vajzën, sepse...

LAJDJA — Sikur mos ishte aktore, nuk do tē kishe pritur fare! (*E vendosur*) Ta dīsh, vëlla, mos tē mbetet hatri, tani unë jam me Albertin. (*Del me çantat*)

ZENOJA — Po dale! (*Me vete*) Tē gjithë bamp dhe... ikin. Po tē dridhen gjunjet, Zeno! Dallgë tē mëdha këto. (*Kalon Jeta, kokulur*.) Jeta! (*Ajo nuk ndalon*.) Jeta! Si... si jeni andej?

JETA — Mirë. Unë, xhaxha Zeno, kam një shoqe te kabina dyzet dhe...

ZENOJA — Prit! Se... mos kujtosh që unë jam nga ata që e kthejnë fjalën.

JETA — Nuk e kuptoj përsë...

ZENOJA — Kam thënë që je një vajzë e bukur dhe e mençur dhe nuk heq dorë.

JETA — Ah, xhaxha Zeno! Siç duket këto nuk mjaftojnë për tē qenë e lumtur. Duhej tē kisha zgjedhur ndonjë degë tjetër, mirëpo ç'ti bësh, edhe unë sì ju, vdes për teatrin, (*Bën tē ikë*.)

ZENOJA — Ti mos u zeméro! Unë dua vetëm të mos nxitohemi. Bille, që ta kuptosh se s'kam gjë kundër teje, po të tregoj edhe një sekret që ai nuk besoj të ta ketë thënë. E dimë nga përvoja, këto gjëra janë të vësh-tira për t'u treguar. Që ta dish, Alberit ia kishte hedhur keq kthethrat një shtrigë atje. Se, është naiv djali, beson shpejt. Unë e mora vesh dhe thashë, ndal Zeno se vate jetë e djalit. E shkëputa, e solla këtu, ia shku-là, ai u njoh me ty... Mirë bëra që ta tregova?

JETA — Mirë, xhaxha Zeno, se kështu e kam më të lehtë të të tregoj edhe unë një sekret. Unë isha ajo!

ZENOJA — Ajo?! Cila ajo?!

JETA — Shtriga, që dō t'ia shkatërronte jetën shkencëtarit. Ajo me kthethra e me thonj...

ZENOJA — Jo, thonj s'kam thënë... (Pauzë) Po atëherë, ju paskeni kohë që...

JETA — Shumë kohë! Ju e kuptioni dhe vetë, dy njerëz nuk mund të dashurohen në kaq pak kohë sa kemi ne këtu...

ZENOJA — E kuptoj... tani po kuptoj gjithçka. (Jeta bën të iki.) Kur qenka kështu... ta marr prapë situatën në dorë. Tani unë votoj me të dyja duart... Ku vete?

JETA — Te Alberti... ju votoni me të dyja duart! (Del.)

ZENOJA — (Me vete) Si u bë kështu?

Vjen Lajdja, e shqetësuar dhe me nxitim.

LAJDJA — Bobo, Zeno, Po vijnë. Janë bërë tym.

ZENOJA — Kush moj?

LAJDJA — Miloja, Izmini. I pashë rrugës dhe bënë sikur s'më panë. Ja këtu po vijnë! Bobo, Zeno!

ZENOJA — Mos u tremb, jam unë këtu (*Hujnë Miloja e Izmini. Janë të shqetësuar.*) O i dashuri Milo! Mirë se na urdhëruat, motër Izmini! Sa mirë. I thosha motrës, duhet të vemi një vizitë te Miloja, kemi njëzet e katër orë pa i parë. Na mori malli!

MILOJA — (*I hutuar*) Ne, shoku Zeno, që ta merrni vesh...

ZENOJA — Po tavllën nuk e keni marrë?

IZMINI — Hallin e saj kemi ne tanë...

LAJDJA — Ta kishit marrë.

MILOJA — Ne, shoku profesor...

IZMINI — Na lëshon koka tym!

MILOJA — Na vjen shumë keq, por...

ZENOJA — Po dale, të kuptohemi.

IZMINI — Ç'të kuptohemi, mo, ç'të kuptohemi! Kini vënë tellallin e po pyesni andej-këtej për familjen tonë! Turp të keni!

ZENOJA — (*I zënë ngushtë.*) O! Turp!

MILOJA — Prit, Izmini. E keqja është, mor byrazer, se nga njëra anë, ata po shëtisin të dy bashkë dhe kjo ka rënë në sy...

ZENOJA — Rinia ka jetën e saj, vëlla Milo! E gjen vetë rrugën ajo, e gjen!

MILOJA — (*I befasuar.*) O! Kush më thotë!

ZENOJA — Rinia është e mençur, ka logjikë rinia!

MILOJA — (*I nxehur*) More, ta marrim vesh, flet

ti apo unë kështu? Se ja mirë që rinia e gjen vetë rrugën, po ju ç'dreqin keni që gérmoni me rrënje e me degë dhe s'na tho- ni asgjë, hë?

IZMINI — Kemi vajzë, s'duam të bëhet me fjalë kot së koti.

LAJDJA — (E shqetësuar) Kot së koti! Jo kot së koti, jo...

Hyn Çomja me Sandën. Grindja ndërprivitet. Sanda hyn brenda, Çomja sulet drejt tyre krahëhapur.

ÇOMJA — A, profesor. Mua që të kam si byra-zer të ma fshehësh ti! Nejse, urime nga shpirti! Urime, Milo, të trashëgohen! Lajde, nxirr ndonjë kupkë se nuk zë urimi më të thatë. (Ua shtrëngon duart që ia japin pa dashur të gjithë.)

(Pauzë)

MILOJA — Urdhëro! (Zenos) Piju lëngun llafeve të mëdha që the.

ZENOJA — Shoku Çakshiri! Je në terezi ti apo... Ti na paske përgjuar prapa derës!

ÇOMJA — O! Prapa derës thotë. Të lutem shumë, profesor! Fundja një flet kompensatoje na ndan!

ZENOJA — Epo atëhere ju merreni me thashe-theme!

ÇOMJA — Profesor, mbaj gojën. Mos më nga se as inati i qëparshëm s'më ka dalë! Ja brr... ma bën lëkura.

ZENOJA — Po ku e dini ju që ata u fejuan? Hë de, ku e dini, pse s'flisni?

ÇOMJA — Po... Sanda më tha, kush tjetër...

ZENOJA — Ja, ajo na i bën kaçamak të gjitha.

ÇOMJA — Jo po ta shohim këtë. Brr... U nxeha tani...

LAJDJA — Çome, po dale, ta marrim shtruar.

ÇOMJA — S'ka shtruar! Kur më hipën inati mua, i thyej të gjitha... (*Niset*)

LAJDJA — Jo, aman, ku vete?

ÇOMJA — Të ha kaçamakun! Të sjell Sandën!
(*Hyn në kabinë.*)

IZMINI — Hajt të ikim, Milo, se këtu u bëmë gazi i plazhit, sigurisht.

LAJDJA — (*I qetëson*) Jo, jo prisni. Ne do ta shpallim! Po fol, Zeno fol!...

ÇOMJA — (*Duke dalë me Sandën që e tërheq për dore.*) Fol ti, tani! Fol këtu!

SANDA — Hë, mo ç'kini! Ua! Latë nam, latë!

ÇOMJA — A të tha profesori se do ta kërkonte vajzën e Milos për Alberin?

SANDA — Më tha, për kokën tënde që më tha!

ÇOMJA — Dhe kur zë për kokën time kjo, topi s'e luan.

Pauzë.

ZENOJA — Një fjalë thashë unë dhe ti vajte mibushe dynjanë!

SANDA — Pse, kujt i thashë? E, mo, kujt i thashë?

ZENOJA — (*I zënë ngushtë.*) Ja, këtij...

ÇOMJA — Pse, dynjaja jam unë? Unë jam i shoqi, o tu mbylltë e mendjes! Dhe burrë e grua, mish e thua thotë llafi. Po ti s'ke si ta dish këtë se je... vetëm thua. (*Pauzë*)

MILOJA — O Zeno! E ke thënë atë fjalë apo...

ZENOJA — Shiko, e di si është puna, unë e thashë, mirëpo...

MILOJA — A jo kështu, jo kështu. Tani na i bëre mendjen dhallë. Kësaj i thonë puthu me Milon. Unë për vete, s'po kuptoja asgjë.

ZENOJA — Po si nuk e kuptioni? Si nuk e kuptoni, xhanëm? Ata... dashurohen.

MILOJA — Këtë e di unë, se fshati që duket s'do kallaуз, po këtë Zenon nuk po e marr vesh fare... Se ti vetë sikur thoshe ndryshe.

ZENOJA — Ehu, sa gjëra kam thënë unë! Sa gjëra i bëjmë gabim në jetë.

MILOJA — Ç'thua ti, Izmini?

IZMINI — Do të mendohemi, sigurisht...

Nga larg duket që po vijnë Jeta e Alberti.

ZENOJA — (*Merr pozë*) Zoti... shoku Milo! Vëlla Milo, do të them! Kam nderin t'ju kërkoj dorën e vajzës suaj. Jeta për nipin tim Alberin, me gradë shkencore në fizikë...

Hyjnë Jeta e Alberti të zënë për dore.

MILOJA — E kanë kënkuar vetë ata njëri-tjetrin, o Zeno! Ja shikoji! Se kur rinia dashuron...

ZENOJA — Nuk ka forcë që ta ndajë!

Përqafohen, urojnë njëri-tjetrin.

ÇOMJA — (Që ka mbetur pak mënjanë.) Ja, u
hap edhe koha e na doli dielli! Më therr-
shin mua në mos ishte tersi ky Zenoja!
(Zenoja është têrhequr pak mënjanë, i ma-
llëngjyer.) Mibahu, Zëno! Ti thoshe se bu-
rri që përlotet s'është burrë! (Merr këngën
«Kur më vjen burri nga stani».)

ZENOJA — (Përsërit vijën melodike «bum, bum —
bum...») S'jam ore, jo, e pranoj.

ÇOMJA — Shikoni, mor aman! Shikoni sa i lum-
tur duket! Sïkur po fejohet vetë. Profesor,
burrat e bëjnë bamp edhe në pleqëri! Në
kokën tënde!

F U N D

PËRMBAJTJA

NJË NUJE PËR STASIN	3
SHI NË PLAZH	95

SA MËN - JUQË TË QË DITË 61st
T. LUMORI I L. BESI është
0001 - dëshmi e tij.

A. 377

57.000 (57.000)
0.220.108 : (0.220)

1.3

et-kuqë shkodra - 27.000000.000000.000000
et-kuqë shkodra - 27.000000.000000.000000
et-kuqë shkodra - 27.000000.000000.000000
et-kuqë shkodra - 27.000000.000000.000000